



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në:

“Drejtësi”

ofruar nga

Universiteti i New York-ut në Tiranë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. As. Flutura Kola (Tafaj)

Dr. Bledar Mustafaraj

Tetor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË: “DREJTËSI”

1	IAL aplikues:	Universiteti i NewYork-ut Tiranë (UNYT)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Drejtësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program i Integruar i Studimeve të Ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Drejtësi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR nr. 219, datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	300 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2020 – 2021 8 PAE / 3 PAK; Viti akademik 2021 – 2022 11 PAE / 6 PAK; Viti akademik 2022 – 2023 12 PAE / 7 PAK; Viti akademik 2023 – 2024 13 PAE / 9 PAK; Viti akademik 2024– 2025 13 PAE / 7 PAK;
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2020 – 2021 . 7 studentë;




		Viti akademik 2021 – 2022 . 14 studentë; Viti akademik 2022 – 2023 . 4 studentë; Viti akademik 2023 – 2024 . 20 studentë; Viti akademik 2024 – 2025 . 13 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit objekt vlerësimi, program i integruar studimi Master i Shkencave në “Drejtësi”, ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë së Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, i institucionit jopublik të arsimit të lartë “University of New York-Tirana”, aktualisht Universiteti i New York-ut në Tiranë (i përmendur në vijim me inicialet UNYT).

Në mënyrë të përmbledhur, ky institucion është licencuar dhe ka nisur veprimtarinë e tij në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 15.8.2002 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “New York University-Tirana”. Duke nisur nga viti 2018, UNYT është bërë pjesë e fondacionit turk “Maarif” (TMF), i cili është fondacion arsimor jofitimprurës. UNYT ushtron aktivitetin e tij në Tiranë, në dy kampuse: kampusi qendror me adresë: Rruga e Kavajës, ish-Shkolla e Mesme Elektrike, pranë “21 Dhjetorit”, dhe kampusi lindor me adresë: Autostrada Tiranë - Elbasan Km 2, Sauk 1020.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion (*Evidenca 1.2.1 “Statuti dhe organigrama 2025”*), UNYT përbëhet nga tri njësi kryesore:

1. Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit;
2. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore;
3. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;

Ndërsa Instituti për Kërkime Europiane dhe Ballkanike, është ngritur dhe funksionon brenda Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore. UNYT është riakredituar institucionalisht me vendimin nr. 61, datë 18.12.2020 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Në bazë të këtij vendimi është vendosur akreditimi institucional i institucionit të arsimit të lartë, “Universiteti i New York-ut në Tiranë”, me kohëzgjatje 6 vite. Programi i integruar Master i Shkencave në “Drejtësi” është licencuar me UMASR nr. 219, datë 3.7.2020, duke reflektuar në përmbajtjen dhe organizimin e tij, ndryshimet që ka pësuar legjislacioni i aplikueshëm.

Programi realizohet në pesë vite akademike, në 300 ECTS, ofrohet kryesisht në gjuhën angleze (disa lëndë që lidhen specifikisht me të drejtën e brendshme ofrohen edhe në gjuhën shqipe, sikundër u referua gjatë vizitës në institucion), me formë studimi me kohë të plotë. Qëllimi i këtij programi është të përgatisë studentët në fushat e së drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme, me fokus të veçantë të drejtën e Bashkimit Evropian, si dhe të zhvillojë procesin e të menduarit kritik dhe aftësimin e studentëve në mënyrë që të përshtaten me tregun e punës. Programi i integruar i studimeve Master i Shkencave në “Drejtësi” i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe, sipas drejtuesve të UNYT, është konceptuar në përputhje me standardet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. UNYT ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin për herë të parë të programit të integruar të studimit Master i Shkencave në “Drejtësi”, ku me shkresën nr. 150 Prot., datë 1.4.2025 të kësaj Agjencie, ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer për qëllim akreditimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet GVJ) është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet RVJ) është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejt e në mënyrë objektive, performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht (www.ascal.al/standardet).

Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga **Prof. As. Flutura Kola (Tafaj)**, dhe **Dr. Bledar Mustafaraj**, të caktuar me urdhrin përkatës nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Gjatë gjithë këtij procesi, GVJ është asistuar nga znj. Majlinda Demirneli, përfaqësuese e ASCAL. Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu, informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në



Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore së UNYT, të zhvilluar në datat 30 qershor-1 Korrik 2025, sipas një agjende gjithëpërfshirëse. Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të paraqesë me korrektësi, objektivitet dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep **vlerësim pozitiv** të arritjeve të deritanishme të UNYT në ofrimin e një programi të mirë të integruar studimi Master i Shkencave në “Drejtësi”. Gjithashtu në këtë raport, GVJ jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do ta ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për t’u përmirësuar më tej dhe për të përmbushur ambiciet e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare, për të krijuar gjeneratën e ardhshme të juristëve.

Universiteti i New York-ut në Tiranë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 13.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 150/16 Prot, datë 13.10.2025. Universiteti i New York-ut në Tiranë, njofton më datë 17.10.2025, nëpërmjet shkresës me nr. 293, prot, datë 14.10.2025,” *Kthim përgjigje për draft raportin e akreditimit për herë të parë të programit të studimit të integruar Master i Shkencave në Drejtësi*”, komentet mbi draft raportin.

Grupi i ekspertëve, pasi u njoh me komentet e sjellë nga IAL, argumenton si më poshtë:

1. Për komentin që i përket stadardit III.5, kriteri 1: “GVJ sugjeron që Departamenti i Drejtësisë të miratojë një udhëzues të detajuar në lidhje me procedurën e diplomimit”, GVJ shprehet se nuk e merr në konsideratë, pasi institucioni duhej ta kishte dorëzuar dokumentin pranë ASCAL ose gjatë vizitës në institucion. Në kohën e përgatitjes së RVJ, ekspertët e jashtëm nuk e kanë pasur në dispozicion dhe në fazën aktuale të procesit, ai nuk mund të administrohet dhe të merret parasysh. Për këto arsye, **GVJ i qëndron sugjerimit që ka bërë.**
2. Për komentin që i përket standardit V.2, kriteri 1: “GVJ sugjeron që UNYT të marrë masat për hartimin dhe miratimin e një guide ose udhëzuesi për studentët, ku ata të gjejnë të përmbledhur të gjitha rregullat, procedurat dhe strukturat që ofrojnë shërbimet në funksion të tyre.”, institucioni ka sjellë koment duke parashtruar se UNYT ka marrë masat për hartimin e një Udhëzuesi për studentët, në fillim të vitit akademik 2025-2026. Sa i përket këtij komenti, GVJ shprehet se nuk e merr në konsideratë, pasi vizita në institucion u realizua në datat 30 qershor-1 Korrik 2025. Ky dokument, për të cilin është bërë sugjerimi, nuk ka qenë pjesë e dokumenteve të dërguar nga IAL pranë ASCAL, si dhe nuk rezultojnë as në dokumentet shtesë të dërguar. Vetë institucioni pranon se ka hartuar udhëzuesin në fillim të vitit akademik 2025-2026, pra në muajin tetor të vitit 2026. Në këto kushte, pasur parasysh gjendjen faktike të dokumentacionit në kohën e përgatitjes së RVJ-së si dhe fazën aktuale të procesit të akreditimit, ky dokument nuk mund të përfshihet në vlerësimin e bërë nga grupi i ekspertëve të jashtëm. **GVJ i qëndron sugjerimit të bërë.**



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë: Program i integruar i studimit Master i Shkencave në "Drejtësi"


I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 (fq. 90-111), qëllimi i politikës kombëtare është që arsimit të lartë të jetë gjithëpërfshirës dhe të plotësojë standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe të jetë promotor i zhvillimit ekonomik. Më konkretisht kjo strategji është zbërthyer në disa objektiva specifike që përmbledhtas janë: • Rritja e cilësisë së arsimit të lartë nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit; • Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor; • Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës; • Sigurimi i integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies; • Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë dhe integrimi në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) etj; UNYT ka hartuar një plan strategjik institucional që është tërësisht në përputhje me planin strategjik kombëtar dhe synon ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Në këtë plan parashikohet shprehimisht objektivi i programit që të jetë në përputhje me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë sipas specifikimeve në Ligjin për Arsimin e Lartë. Institucioni ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, njohuritë dhe aftësitë profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Në Rregulloren e Programit të Integruar 5-vjecar "Master i Shkencave në Drejtësi" (këtu e më poshtë referuar si PIND) PIND) (n.1(c) parashikohet shprehimisht organizimi i tij në

	përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, me aktet nënligjore dhe Statutin e UNYT-it.’ Referencë: <i>Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026</i> <i>Strategjia e Universitetit 2020-2025 (Aneksi 1.12 Evidenca 22)</i> <i>Strategjia e Universitetit 2026-2030 (Aneksi 1.12.1 Evidenca 23)</i> <i>Statuti i UNYT –s (Anexi 1.2.1 Evidenca 10)</i> <i>Rregullore e PIND (Anex 1.11 Evidenca 21)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni dhe qëllimi i UNYT është “Edukimi i Liderve të së Nesërme”, krijimi, zhvillimi dhe avancimi i dijes, si dhe përgatitja e profesionistëve të ardhshëm përmes mësimdhënies, të nxëniet dhe kërkimit shkencor. (neni 6 i Statutit të UNYT.) Programi i studimit është tërësisht në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. Në nenin 6 të Rregullores së PIND parshikohen shprehimisht objektivat e programit, të cilat janë qartazi në përputhje me objektivat dhe misionin e UNYT-s. Referencë: <i>Statuti (Anexi 1.2.1 Evidenca 10)</i> <i>Rregullore e PIND (Ankesi 1.11 Evidenca 21)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit.	Vizioni i UNYT është jo vetëm realizimi i mësimdhënies në një nivel të lartë, por edhe kërkim shkencor, nëpërmjet realizimit të katër shtyllave kryesore: 1. Përmirësimit të cilësisë institucionale përmes procedurave dhe infrastrukturës; 2. Integrimin e teknologjive dixhitale inovative dhe zhvillimeve teknike në të gjitha proceset e UNYT; 3. Rritjen e numrit të personelit akademik dhe studentëve ndërkombëtarë nga e gjithë bota; 4. Orientimit drejt kërkimit shkencor duke u fokusuar në kontributin e universitetit për shoqërinë përmes kërkimeve dhe inovacionit; (neni 8 i Statutit) Bazuar në Rregulloren e Programit të studimit, ky program studimi organizohet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë” të Republikës së Shqipërisë, akteve nënligjore



	dhe Statutit të Universitetit , në lidhje me studimet e ciklit të dytë. (neni 1 parag. c i Rregullores së programit) Po ashtu Rregullorja e PIND në <i>nenin 6</i> të saj parashikon objektivat kryesore të programit, të cilat mbështeten qartësisht në shtyllat kryesore të institucionit të referuara më lart. Sipas kësaj Rregulloreje (<i>neni 6</i>) PIND është konceptuar për të zhvilluar njohuri të përparuara në një fushë akademike ose profesionale dhe për të pajisur studentët me aftësi e kompetenca të avancuara. Struktura e programit nxit formimin e shprehive të veçanta për një gamë të gjerë profesioneve dhe specialitetesh, duke i ekspozuar studentët ndaj teorive dhe parimeve akademike përkatëse dhe duke i aftësuar për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme. Kjo demonstroi qartë përputhjen e tij me Misionin e UNYT-s. Referencë: <i>Statuti i UNYT-s (Anexi 1.2.1 Evidenca 10)</i> <i>Rregullore e PIND (Anexi 1.11 Evidenca 21)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prijet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Parimet e Universitetit përfshijnë (<i>por nuk kufizohen</i>) në: Lirinë akademike; Edukimin cilësor sipas standardeve ndërkombëtare; Inovacionin, kreativitetin dhe sipërmarrjen; Qëndrueshmërinë sociale dhe mjedisore; Standardet e larta etike dhe morale; Angazhimin profesional dhe publik; Kërkimin bashkëpunues dhe ndërdisiplinor; Komunikimin dhe ndërgjegjësimin global; Partneritete kombëtare dhe ndërkombëtare; Ofrimin e mundësive edukative gjithëpërfshirëse, të barabarta dhe të drejta (<i>neni 9 i Statutit</i>) UNYT respekton dhe garanton lirinë akademike në mësimdhënie, kërkim shkencor, inovacion dhe aktivitet krijues, në përputhje me ligjin nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, aktet normative të nxjerra në zbatim të tij dhe me misionin dhe objektivat strategjike të zhvillimit institucional. (<i>neni 10 Parag. 1 i Statutit</i>). Aktiviteti i universitetit bazohet në merita akademike që përjashtojnë diskriminimin mbi bazën e racës, ngjyrës, fesë, gjinisë, kombësisë, origjinës, statusit civil, aftësisë fizike apo mendore, dhe, në përgjithësi, çdo faktori tjetër




	diskriminues sipas koncepteve të ligjeve në fuqi dhe etikës akademike. (neni 10 parag. 2 i Statutit) Referencë: <i>Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026</i> <i>Strategjia e Universitetit 2020-2025 (Aneksi 1.12 Evidenca 22)</i> <i>Strategjia e Universitetit 2026-2030 (Aneksi 1.12.1 Evidenca 23)</i> <i>Statuti i UNYT-s (Anexi 1.2.1 Evidenca 10)</i> <i>Rregullore e PIND (Anex 1.11 Evidenca 21)</i>			
Konkluzione	<i>Programi i Integruar i Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" ofrohet në përputhje të plotë me parimet bazë të institucionit (të sanksionuara në statutin, rregulloren e përgjithshme (themelore) dhe në strategjinë bazë/kuadër të institucionit).</i> <i>Strategjia e institucionit ka të mirëpërcaktuara prioritet e zhvillimit institucional dhe programeve të studimit, duke synuar të ofrojë për tregun e punës të diplomuar të formuar me normat etike profesionale dhe në të njëjtën kohë në mbështetje të interesit kombëtar në fushën e arsimit dhe shkencës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UNYT është themeluar në vitin 2002 në përputhje me ligjin shqiptar për Arsimin e Lartë dhe legjislacionin në fuqi duke garantuar autonominë universitare dhe lirinë akademike. Statuti aktual i UNYT-s bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH" si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

	I themeluar 23 vite më parë, Institucioni ka një traditë të konsoliduar akademike dhe përvojë të gjatë në fushën përkatëse, e cila dëshmohet nga prania e stafit me kualifikime të larta shkencore dhe profesionale, përfshirë tituj akademikë dhe angazhime kërkimore të vazhdueshme. Kapacitetet infrastrukturore dhe logjistike, si auditorët, laboratorët dhe mjediset e tjera të specializuara, janë në funksion të programit të studimit dhe garantojnë zhvillimin cilësor të procesit mësimor. Po ashtu, biblioteka dhe burimet digjitale mbështesin procesin akademik dhe kërkimor, duke ofruar akses të gjerë në literaturën bashkëkohore. Këto elementë tregojnë qartë se institucioni ka të gjitha burimet e nevojshme për të ofruar një program studimi cilësor dhe konkurrues. Referencë <i>Statuti i UNYT-s (Anexi 1.2.1 Evidenca 10)</i> <i>Rregullore e PIND (Anex 1.11 Evidenca 21)</i> <i>Plani mësimor i PIND (Aneksi 1.5 Evidenca 14)</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore për zbatimin e PIND është Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (FDSHS) (neni 20 i Rregullores së PIND). FDSHS është njësia kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore në fushën e studimeve në drejtësi. Në vlerësimin e GVJ-së, programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë përgjegjëse, duke respektuar kornizat kombëtare të kualifikimeve dhe udhëzimet evropiane për klasifikimin e programeve të arsimit të lartë. Struktura e programit, përmbajtja e lëndëve dhe rezultatet e të nxëniet janë në harmoni me profilin akademik dhe kërkimor të njësisë përkatëse. Kjo tregon se ekziston një koherencë e plotë ndërmjet misionit të njësisë dhe orientimit të programit, duke siguruar standarde të larta akademike dhe përgatitje të studentëve sipas kërkesave të tregut të punës dhe atij akademik. Referencë: <i>Statuti i UNYT-s (Aneksi 1.2.1, Evidenca 10)</i> <i>Rregullore e Departamentit (Aneksi 1.9 Evidenca 19)</i> <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11, Evidenca 21)</i>

Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë (<i>njësia bazë</i>), në të cilin fusha e përgjithshme dhe specifike e studimeve është ajo e drejtësisë. Programi i studimit është i lidhur ngushtë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse, e cila ka kapacitetet e nevojshme për mbështetjen e tij. Në rastet kur programi ka karakter ndërdisiplinor, janë të përfshira edhe njësi të tjera akademike që kontribuojnë me ekspertizën e tyre, duke e bërë programin të pasur dhe gjithëpërfshirës. Ky bashkëpunim siguron që të gjitha aspektet teorike dhe praktike të mbulohen siç duhet, duke përmbushur standardet kombëtare dhe evropiane për arsimin e lartë. Për rrjedhojë, garantohej që studentët marrin një përgatitje të plotë dhe cilësore, si në nivelin akademik ashtu edhe në atë profesional. Referencë: <i>Rregulore e Departamentit (Aneksi 1.9 Evidenca 19)</i> <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11, Evidenca 10)</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	GVJ konstatoi se DVV nuk ofron materiale mbështetëse në zbatim të këtij kriteri, por nga vizita në institucion dhe diskutimi me stafin akademik u konfirmua që Institucioni mundëson për të diplomuarit trajnime të vazhdueshme, në formën e leksioneve të hapura me pedagogë vendas dhe të huaj. Referencë: <i>Vizita në institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ gjen përputhje të plotë mes fushës së përgjithshme dhe specifike të PIND dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe njësisë bazë, Departamentit të Drejtësisë. Mbështetja profesionale dhe</i>




	përfshirja e stafit akademik nga njësi bazë garanton cilësi dhe koherencë në ofrimin e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Dokumentacioni i vendosur në dispozicion të GVJ për këtë kriter ishte i plotë dhe gjithëpërfshirës duke përfshirë statutin dhe rregullore të të gjitha niveleve (<i>Institucionale, njësi kryesore, njësi bazë, program studimit</i>) që mbulonin pothuajse cdo aspekt të organizimit të detyrave dhe përgjegjësiwe në funksion të mbarëvajtjes së aktiviteteve të programit të studimit. Institucioni ka ngritur një kulturë të bashkëpunimit të brendshëm për të siguruar funksionimin sa më cilësor të programeve të studimit. Ndarja e qartë e përgjegjësiwe ndërmjet njësive kryesore dhe bazë, përfshirja aktive e stafit akademik dhe administrativ, si dhe procesi i rregullt i analizës së performancës së tyre, e bëjnë funksionimin e programit të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt cilësisë. Bashkëpunimi i brendshëm është i institucionalizuar përmes strukturave rregullatore dhe raporteve periodike që garantojnë koordinimin e veprimtarive. Referencë: <i>Statuti dhe organograma e UNYT-s (Aneksi 1.2.1 Evidenca 10)</i> <i>Rregullorja e FDSHS-s (Aneksi 1.8 Evidenca 18)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie	Neni 11 i Statutit të UNYT parashikon se “UNYT vendos ndërkombëtarizimin në qendër të aktiviteteve të tij akademike duke rritur numrin e personelit akademik dhe studentëve ndërkombëtarë nga e gjithë bota dhe duke krijuar bashkëpunimin me institucione akademike dhe jo-akademike në mbarë botën për

bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	ti mundësuar personelit dhe studentëve të përfitojnë nga aktivitetet e shkëmbimit. Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (IRO) e UNYT organizon dhe monitoron marrëveshjet bilaterale Erasmus + dhe programet e shkëmbimit.” UNYT shtyn përpara përpjekjet e tij për ndërkombëtarizimin duke nxitur bashkëpunimet globale në kërkime shkencore dhe projekte të përbashkëta me institucione ndërkombëtare. Qendra Studimore Ndërdisciplinore promovon ndarjen ndërkufitare të njohurive dhe zhvillimin përmes bashkëpunimit në projekte inovative. Referencë: <i>Strategjia e Universitetit 2020-2025 (Aneksi 1.12 Evidenca 22)</i> <i>Strategjia e Univeristetit 2026-2023 (Aneksi 1.12.1 Evidenca 23)</i> <i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit (Aneksi 1.13 Evidenca 24)</i> <i>Aktivitete në nivel institucioni (Aneksi 1.14 Evidenca 25)</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni ka vendosur një rrjet të gjerë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione akademike dhe kërkimore, si dhe me kompani dhe organizata profesionale, për të siguruar zhvillimin e praktikave të studentëve dhe përfshirjen e tyre në aktivitete konkrete pune. Disa nga marrëveshjet janë: • MoU UNYT dhe READ Albania (Aneksi 1.39 Evidenca 55) • MoU Halimi dhe UNYT (Aneksi 1.40 Evidenca 56) • MoU 2022 UNYT dhe Deloitte (Aneksi 1.41 Evidenca 57) • MoU AKSHI dhe UNYT (Aneksi 1.43 Evidenca 59) • Anëtarësimi në Shoqatën e Universiteteve Ballkanike (Aneksi 1.44 Evidenca 60) • MoU UNYT dhe Brunel (Aneksi 1.45 Evidenca 62) Këto marrëveshje mundësojnë që studentët të zhvillojnë praktika profesionale dhe të përfitojnë nga mentorimi i punëdhënësve, ndërkohë që stafi akademik angazhohet në projekte të përbashkëta kërkimore. Ky bashkëpunim i integruar siguron një lidhje të qëndrueshme midis akademisë dhe tregut të punës. Referencë:

	<i>Strategjia e Universitetit 2020-2025 (Aneksi 1.12 Evidenca 22)</i> <i>Straegjia e Univeristetit 2026-2023 (Aneksi 1.12.1 Evidenca 23)</i> <i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit (Aneksi 1.13 Evidenca 24)</i> <i>Aktivitete në nivel institucioni (Aneksi 1.14 Evidenca 25)</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Institucioni ka vendosur mekanizma të qartë monitorimi dhe raportimi për marrëveshjet e bashkëpunimit. Cdo vit, Përgjegjësi i i Departamentit i paraqet Dekanit të Fakultetit Raportin vjetor të monitorimit, i cili ndër të tjera ofron një pasqyrë analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Raportet analitike përditësohen rregullisht dhe përfshijnë vlerësimin e ndikimit të këtyre marrëveshjeve në cilësinë e programit, përfitimet për studentët, stafin akademik dhe institucionin në tërësi. Këto raporte shërbejnë si instrument për përmirësim të vazhdueshëm dhe si bazë për zgjerimin ose përshtatjen e bashkëpunimeve ekzistuese. Ky proces dëshmon se institucioni jo vetëm që vendos marrëveshje, por edhe i monitoron ato për të nxjerrë vlera të matshme. Referencë: <i>Raport vjetor i Monitorimit 2021-2022 (Aneksi 1.30 Evidenca 46)</i> <i>Raporti vjetor i monitorimit 2022-2023 (Aneksi 1.30.1 Evidenca 47)</i> <i>Raporti vjetor i UNYT 2023-2024 (Aneksi 1.35 Evidenca 51)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UNYT ka realizuar me sukses organizimin eficient të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi për të garantuar mbarëvajtjen e aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe shkencore në funksion të programit të studimit.</i> <i>FDSHS disponon një listë të pasur të marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë, IAL dhe shoqëri biznesi nëpërmjet të cilëve siguron zhvillimin e praktikave profesionale për studentët e programit të studimit objekt vlerësimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Në zbatim të VKM-s Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në vitin 2020 programi i studimit është strukturuar qartë dhe harmonizuar me kuadrin ligjor kombëtar dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Përmbajtja mësimore, ngarkesa në kredite dhe aktivitetet formuese janë të specifikuara në mënyrë të detajuar, duke garantuar transparencë dhe qartësi për studentët. Kjo tregon se institucioni e ka organizuar programin në përputhje të plotë me standardet evropiane dhe kombëtare, duke mundësuar krahasueshmërinë dhe transferueshmërinë e krediteve. Procesi mësimor organizohet në vite akademike. - Viti akademik ka 30 javë mësimore dhe është i ndarë në dy semestra. Sipas rastit (<i>në rast nevojë</i>) UNYT ofron edhe semestër të tretë, semestrin e verës. (<i>Rregullore e programit neni 3</i>); - Numri i krediteve për semestër është 30 ECTS (për një vit akademik është 60 ECTS); - Studimet e Ciklit të Dytë përmbajnë 300ECTS (<i>Neni 19 (b) dhe (c) të Rregullores së PIND dhe neni 9 (c) i Rregullores së FDSHS</i>); Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A - E, në përputhje me VKM nr. 41/2018 të ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021 (<i>neni i Rregullores së PIND</i>)

	Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen secila me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021, Tabela nr 1, për programet e Masterit Shkencor, në kategorinë A ku bëjnë pjesë lëndët bazë dhe disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturre të përgjithshme duhet të kenë 5 – 10% të krediteve; në kategorinë B, që janë lëndët karakterizuese, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe duhet të ketë 50 – 60% të krediteve; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore dhe integruese, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje dhe duhet të ketë 12 – 20% të krediteve; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale dhe duhet të ketë 10% të krediteve. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim dhe duhet të ketë 10 – 15% të krediteve.) Referuar RVB-s (fq 34), në këtë program studimi, lëndët bazë (A) zënë 20% të krediteve (60ECTS); Lëndët karakterizuese (B) zënë 54% të krediteve (162 ETCS); Lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 12% të krediteve (36 ECTS); Lëndët plotësuese (D) zënë 10 % të krediteve (12 ECTS) dhe Detyrimet përmbyllëse (E) zënë 4% të krediteve (12ECTS). Ndërsa, referuar Programit mësimor të riorganizuar në prill 2020, (tabela 2.1) të dhënat janë të ndryshme. Kështu, lëndët bazë (A) zënë 18.66% të krediteve (56 ECTS); Lëndët karakterizuese (B) zënë 55% të krediteve (165 ETCS); Lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 14.66% të krediteve (44 ECTS); Lëndët plotësuese (D) zënë 7.33 % të krediteve (22 ECTS) dhe Detyrimet përmbyllëse (E) zënë 4% të krediteve (12ECTS). <u>GVJ sugjeron të saktësohen dhe unifikohen kreditet për cdo grup lëndësh, pavarësisht se në të dyja rastet programi është në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018 (të ndryshuar)</u> Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneks 1.11 Evidenca 21)</i> <i>Plani mësimor i PIND (Aneksi 1.5 Evidenca 14)</i> <i>Rregullore e FDSHS (Aneksi 1.8 Evdiena 18)</i>
--	--

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit është konceptuar për të zhvilluar njohuri të përparuara në një fushë akademike ose profesionale dhe për të pajisur studentët me aftësi e kompetenca të avancuara. Struktura e programit nxit formimin e shprehive të veçanta për një gamë të gjerë profesionale dhe specialitetesh, duke i ekspozuar studentët ndaj teorive dhe parimeve akademike përkatëse dhe duke i aftësuar për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme. Kjo demonstroi qartë përputhjen e tij me kërkesat e ciklit të dytë të studimeve. (<i>neni 6 i Rregullores së PIND</i>) Për të gjykuar mbi shkallën e arritshmërisë së këtyre synimeve dhe objektivave të programit të studimit, GJV shqyrtoi Planin Mësimor dhe syllabuset përkatëse. GJV është e mendimit se tërësia e moduleve dhe lëndëve të organizuara në kurrikulën e këtij programi (<i>tabelat e RVB</i>), me larminë e tyre dhe me ngarkesën e parashikuar mundësojnë përmbushjen e synimeve dhe objektivave të përmendura në rregulloren e programit. PIND është i fokusuar në fushën e së drejtës në tërësi (publike, penale dhe private). Ky program studimi ka të përfshira lëndë të fokusuara në njohuri të mirëfillta teorike dhe praktike si dhe lëndë të formimit të përgjithshëm, të lidhura me fushën e së drejtës, p.sh: E Drejta Publike, Historia e institucioneve, E drejta Romake, Filozofia e së Drejtës, E Drejta Kushtetuese etj (lëndë që ofrojnë njohuri bazë teorike); E Drejta Civile, E drejta Penale, E Drejta e detyrimeve, E Drejta familjare etj (lëndë që ofrojnë njohuri teorike-praktike); Hyrje në Shkencat Politike, Shkrimi ligjor dhe metodat e arsyetimit, Hyrje në Ekonomi etj (lëndë që ofrojnë njohuri plotësuese mbështetëse në fushën e së drejtës) Njohuritë që ofrohen nga ky program krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Kurrikula e ofruar jo vetëm që optimizon njohuritë, por dhe krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me vecoritë që kërkon tregu specifik i juristëve. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneks 1.11 Evidenca 21)</i> <i>Plani mësimor i PIND (Aneksi 1.5 Evidenca 14)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara	Pjesë e kurrikulës së PIND është dhe praktika e punës e cila është e detyrueshme. Kjo lëndë, e kategorisë D, referuar

ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	programit mësimor duhet të ketë 22 ECTS. (<i>Rregullore e PIND-s neni 12</i>) Ndërkohë që në RVB (<i>faqe 21</i>) parashikohet që ndjekja e praktikës u jep studentëve 4 ECTS. Kjo mospërputhje është problematike në lidhje me totalin prej 300ECTS që duhet të marri një student në përfundim të këtij programi studimi, si kriter diplomimi (<i>neni 49 i Rregullores së PIND</i>). GVJ konsultoi Programin mësimor dhe Rregulloren e PIND dhe konstatoi se, bazuar në nenin 49 të Rregullores së PIND, “Për tu diplomuar në PIND, studenti duhet a. të fitojë 300 ECTS; b. të ketë GPA 2.0/4.0 (50/100) në tërë vitet akademike.” Në lidhje me detyrimet përmbyllëse, në RVB nuk sqarohet përmbyllja e këtij kriteri. Bazuar në Planin mësimor të PIND, GVJ konstatoi se, si detyrim përmbyllës, studentët e këtij programi i nënshtrohen mbrojtjes së diplomës (<i>Tema e Diplomës</i>) e cila është e vlerësuar me 12 ECTS. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneks 1.11 Evidenca 21)</i> <i>Plani mësimor i PIND (Aneksi 1.5 Evidenca 14)</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Ky kriter nuk zbatohet në këtë program studimi.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të	

përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Ky kriter nuk zbatohet në këtë program studimi.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Sipas dokumentit të propozimit për hapjen e programit të studimit dhe sipas rregullores së funksionit të programit të cilat u shqyrtuan nga GVI, ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015. KUB nuk gëzon status të veçantë, pra kjo pjesë e këtij kriteri nuk zbatohet për këtë institucion.




Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i PIND-s është i ngjashëm në masën 75 % me programet e tjera të të njëjtit cikël studimi të ofruara nga universitetet publike dhe private në vend. Megjithatë, në këtë përshtatje konstatojmë një problematikë në disa nga lëndët bazë. Kështu, Procedura Civile dhe Procedura Penale zhvillohen si lëndë të ndara në dy pjesë, duke marrë studentët vlerësim të vecantë për secilën pjesë. Një ndarje e tillë vështirëson kushtet e transferimit të një studenti nga UNYT në një Institucion tjetër të arsimit të lartë që nuk e ndan këtë lëndë në pjesë. Nëse një student i UNYT ka zhvilluar pjesën e parë të Procedurës Civile në UNYT dhe transferohet në një universitet tjetër, i cili e zhvillon lëndën të pandarë (<i>thuhet të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri [dhe jo vetëm] e zhvillojnë si lëndë të pandarë</i>), atij nuk do t'i njihet kjo pjesë e parë, por duhet të përsërisi lëndën nga fillimi. <i>GVJ sugjeron që lëndë të tilla si Procedura Civile, Procedura Penale të mos ndahen në 2 lëndë më vete, por të trajtohen si një lëndë e pandarë.</i> Referencë <i>Rregullore e PIND (Aneks 1.11 Evidenca 21)</i> <i>Plani mësimor i PIND (Aneksi 1.5 Evidenca 14)</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Referuar RVB kodi i këtij programi është 75M10421A, bazuar në evidencën 1.25. Nga verifikimi i kësaj evidence programi i studimit <i>nuk është në këtë listë.</i> <i>Kodifikimet Nr. Prot. 55.pdf (Aneksi 1.25)</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në	PIND nuk ofrohet në kuadrin e ndonjë bashkëpunimi midis dy ose me shumë institucioneve të arsimit të lartë.

përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>PIND është i organizuar dhe strukturuar në formën e krediteve ECTS, në 5 (pesë) vite akademike me 300 ECTS, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Lëndët janë të kategorizuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (kategorizimi A-E).</i> <i>GVJ sugjeron të saktësohen dhe unifikohen kreditet për çdo grup lëndësh, sepse në RVB janë raportuar në mënyrë të ndryshme nga si janë parashikuar në Planin mësimor (pavarësisht se në të dyja rastet programi është në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018 (të ndryshuar)</i> <i>GVJ sugjeron fort që lëndë të tilla si Procedura Civile, Procedura penale të mos ndahen në 2 lëndë më vete, por të trajtohen si një lëndë e pandarë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	UNTY është institucion i arsimit të lartë jopublik dhe është krijuar me VKM nr. 397, datë 15.08.2002. Me VKM nr. 448, datë 11.07.2012 fitoi statusin e Universitetit dhe ndryshoi emërimin në atë aktual Universiteti i New York-u Tiranë. GVJ analizoi shkallën e përmbushjes së kërkesave ligjore në fuqi që specifikojnë se “njësia kryesore duhet të organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente”, dhe konstaton se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e përmbush këtë kriter pasi ka në përbërjen e tij tre departamente (njësi bazë), që janë: 1. Departamenti i Drejtësisë; 2. Departamenti i Shkencave Politike/Marrëdhënieve Ndërkombëtare

3. Departamenti i Psikologjisë dhe Edukimit;

Departamenti është njësia bazë akademike për mësimdhënien. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. (neni 11 i Rregullores së UNYT-s dhe neni 14 i Statutit të UNYT-s)


Programet specifike të një Departamenti drejtohen nga personeli akademik. PIND integron studimet bachelor dhe master shkencor (të ciklit të parë dhe të dytë). Ky program është licencuar fillimisht me VKM nr. 939 datë 03.09.2009 dhe riorganizuar me Urdhërin e Minsitrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 919, datë 03.07.2020. PIND ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë, FDSHS në UNYT. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin me tituj akademikë e grada shkencore duke përmbushur kërkesat ligjore dhe pritshmëritë e cilësisë akademike.

Referuar dokumentacionit të kërkuar gjatë vizitës në institucion Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale në tre vite akademike përbëhet nga staf me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit akademik të	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale					
	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	1	-	3	-	3	-
Prof. Asoc.	4	2	4	3	4	6
Dr/Phd	13	10	14	10	15	5
Msc.	6	10	6	8	6	9
Gjithsej	24	22	27	21	28	20

Referuar të dhënave, GVJ konstaton se kjo njësi bazë përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm (PAE) dhe atë me kontratë (PAK). Kualifikimi i stafit të departamentit në tre vite akademike është si më poshtë:

	Kualifikimi i stafit akademik të	Departamenti i Drejtësisë					
		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr	-	-	-	-	-	-
	Prof. Asoc.	1	2	1	2	1	2
	Dr/Phd	3	5	3	5	3	3
	Msc.	3	4	3	3	3	3
	Gjithsej	7	11	7	10	7	8
<i>GVJ konstatoi se, Drejtuesi i Departamentit të Drejtësisë nuk kishte arsim të lartë juridik. Pavarësisht se ligji nuk parashikon shprehimisht si kërkesë ligjore arsimin e lartë juridik për këtë pozicion, në funksion të mbarëvajtjes së ushtrimit të të gjitha detyrave (ndër të tjera edhe mbikëqyrja e veprimtarive me karakter ngushtësisht juridik, pra që kërkojnë përvec kuptueshmërisë akademike edhe atë juridike) do të sugjerohet që përgjegjësi i Departamentit të Drejtësisë të kishte arsim të lartë juridik.</i> Referencë <i>Rregullore e UNYT-s (Ankesi 1.7 Evidenca 17)</i> <i>RVB Tabela 2.1</i> <i>CV e stafit akademik</i> <i>Statuti i UNYT-s (Aneksi 1.2.1 Evidenca 10)</i>							
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Rregullorja e FDSHS dhe Rregullorja e PIND nuk parashikojnë rolin dhe funksionin e personeli ndihmës akademik/administrativ. Po ashtu, edhe RVB nuk referon angazhimin e personelit ndihmës akademik/ administrativ në kuptim të ligjit për arsimin e lartë, por referon njësitë ndihmëse mbështetëse si zyrën e IT apo sekretarinë mësimore, që përmbushin pjesërisht kërkesat e ligjit. Megjithatë Statuti i UNYT-s parashikon qartazi si personelin ndihmës akademik, ashtu edhe atë administrativ (neni 47 & 48). Sipas këtyre dispozitave të Statutit, personeli ndihmës akademik ndahet në dy						




	kategori: personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ. - Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor. Ai bën pjesë në stafin e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Këtu përfshihen laborantët, teknikët etj, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit; - Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel të institucionit. Këtu përfshihet personeli i përcaktuar në aktet e brendshme të institucionit; Kategoritë e personelit administrativ miratohen nga Bordi i Administrimit të UNYT-s. Procedura për vlerësimin e punës së personelit administrativ, motivimi, shpërblimi, politikat e zhvillimit dhe trainimit, si dhe procedurat për masat disiplinore përcaktohen në rregulloret dhe aktet përkatëse (n. 48 Statuti i UNYT-s) Referenca: <i>Statuti i UNYT-s (Aneksi 1.2.1 Evidenca 10)</i> <i>Rregullore PIND (Aneksi 1.11 Evidenca 21)</i> <i>Rregullorja e FDSHS (Aneksi 1.8 Evidenca 18)</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	As Rregullorja e Departamentit dhe as Rregullorja e FDSHS-s nuk parashikojnë rolin e kordinatorit të programit të studimit. Po ashtu një funksion i tillë nuk parashikohet as në Statutin e UNYT-s. Megjithatë, referuar bisedave me stafin akademik, Departamenti i Drejtësisë cdo vit cakton një koordinitor për çdo program studimi. <u>GVJ sugjeron që roli dhe detyrat e koordinitorit të përfshihen në rregulloret përkatëse dhe të vërtetohet caktimi i tij me akte mbështetëse.</u> Referencë: <i>Statuti i UNYT-s (Aneksi 1.2.1 Evidenca 10)</i> <i>Rregullore PIND (Aneksi 1.11 Evidenca 21)</i>

	<i>Rregullorja e FDSHS (Aneksi 1.8 Evidenca 18)</i> <i>Rregullorja e Departamentit të Drejtësisë (Aneksi 1.9 Evidenca 19)</i>			
Konkluzione	<i>Sipas konstatimeve të GVJ, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe Departamenti i Drejtësisë janë njësitë përkatëse përgjegjëse për ndjekjen e programit të studimit PIND dhe përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sa i përket organizimit dhe strukturës akademike, numrit të stafëve akademike efektive dhe me kontratë dhe në lidhje me vlerësimin dhe akreditimin.</i> <i>GVJ sugjeron që roli dhe detyrat e koordinаторit të përfshihen në rregulloret përkatëse dhe të vërtetohet caktimi i tij me akte mbështetëse.</i> <i>GVJ sugjeron që Drejtuesi i Departamentit të Drejtësisë të ketë arsim të lartë juridik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3


Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentat kryesorë strategjik të njësive kryesore dhe të njësive bazë që ofrojnë këtë program studimi (<i>Statuti i UNYT-s; Rregullorja e FDSHS-s; Rregullorja e PIND</i>), dhe konstatoi se ato përmbajnë elementet e nevojshme në lidhje me programin si kohëzgjatjen e tij, organizimin në vite akademike dhe në semestra, në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e elementëve dhe lëndëve të programit. Informacioni i mësipërm mund të gjendet edhe në versionin digjital në faqen zyrtare të institucionit. Referencë: <i>Statuti i UNYT-s (Aneksi 1.2.1 Evidenca 10)</i>




	<i>Rregullore PIND (Aneksi 1.10 Evidenca 20)</i> <i>Rregullorja e FDSHS (Aneksi 1.8 Evidenca 18)</i> <i>Rregullorja e Departamentit të Drejtësisë (Aneksi 1.9 Evidenca 19)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ shqyrtoi planin mësimor të PIND dhe konfirmon se në të janë parashikuar lëndët që do të zhvillohen sipas semestrave dhe viteve akademike, së bashku me numrin e krediteve ECTS në total dhe për cdo veprimtari, si leksione në auditor, aktivitete të tjera mësimore, dhe orë studimi individual jashtë auditorit. Lëndët e programit të studimit janë të organizuara sipas veprimtarive formuese nga A – E në përputhje me VKM nr. 41/2018 të ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021 (neni i Rregullores së PIND) Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen secila me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021, Tabela nr 1, për programet e Masterit Shkencor, në kategorinë A ku bëjnë pjesë lëndët bazë dhe disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturore të përgjithshme duhet të kenë 5 – 10% të krediteve; në kategorinë B, që janë lëndët karakterizuese, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe duhet të ketë 50 – 60% të krediteve; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore dhe integruese, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje dhe duhet të ketë 12 – 20% të krediteve; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale dhe duhet të ketë 10% të krediteve. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim dhe duhet të ketë 10 – 15% të krediteve.) Referuar RVB-s (fq 34), në këtë program studimi, lëndët bazë (A) zënë 20% të krediteve (60ECTS); Lëndët karakterizuese (B) zënë 54% të krediteve (162 ECTS); Lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 12% të krediteve (36 ECTS); Lëndët plotësuese (D) zënë 10 % të krediteve (12 ECTS) dhe Detyrimet përmbyllëse (E) zënë 4% të krediteve (12ECTS). Ndërsa, referuar Programit mësimor të riorganizuar në prill 2020, (tabela 2.1) të dhënat janë të ndryshme. Kështu, lëndët bazë (A) zënë 18.66% të krediteve (56 ECTS); Lëndët karakterizuese

	(B) zënë 55% të krediteve (165 ECTS); Lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 14.66% të krediteve (44 ECTS); Lëndët plotësuese (D) zënë 7.33 % të krediteve (22 ECTS) dhe Detyrimet përmbyllëse (E) zënë 4% të krediteve (12ECTS). <u>GVJ sugjeron të saktësohen dhe unifikohen kreditet për cdo grup lëndësh, pavarësisht se në të dyja rastet programi është në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018 (të ndryshuar)</u> Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneks 1.11 Evidenca 21)</i> <i>Plani mësimor i PIND (Aneksi 1.5 Evidenca 14)</i> <i>Rregullore e FDSHS (Aneksi 1.8 Evidenca 18)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me të drejtën e pranimit, janë parashikuar në Statutin e UNYT-s (neni 71). në Ndërsa komisioni i pranimeve dhe transferimeve funksionon në nivel Departamenti (neni 70 i Rregullores së FDSHS-s) Departamenti propozon kriteret e pranimit të studentëve për cdo program studimi sipas dispozitave të ligjit për Arsimin e Lartë dhe akteve ligjore. Departamenti përzgjedh studentët e pranuar të cilët miratohen nga titullari i njësisë kryesore sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e UNYT-s. Kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve janë parashikuar në mënyrë të detajuar në Rregulloren e Departamentit të Drejtësisë (nenet 7 dhe 8). Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneks 1.11 Evidenca 21)</i> <i>Plani mësimor i PIND (Aneksi 1.5 Evidenca 14)</i> <i>Rregullore e FDSHS (Aneksi 1.8 Evidenca 18)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë	Plani mësimor i këtij programi studimi ofron informacionin e plotë mbi lëndët, orët akademike dhe formën e shpërndarjes së tyre në formën e leksioneve dhe seminareve si dhe orët e punës individuale nga ana e studentëve, numrin e krediteve ECTS, vitin/semestrin akademik ku zhvillohet. Informacioni është në dispozicion të studentëve që në momentin e regjistrimit të tyre dhe ofrohet në vijimësi nga struktura akademike dhe administrative e institucionit. Këshilluesi akademik mundëson




komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	për studentët informacionin e nevojshëm mbi lëndët dhe rregjistrimin e tyre në çdo semestër. Referencë: <i>Plani mësimor i PIND (Ankes 1.5 Evidenca 14)</i> <i>Syllabuset e lëndëve (Aneksi 1.6 Evidenca 15)</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	GVJ pasi verifikoi syllabus-et e lëndëve të PIND, konstatoi se në përgjithësi ato ishin të përditësuara (<i>me pak përjashtime</i>), si dhe në zbatim të VKM Nr 879 datë 18.12.2018, të Statutit të UNYT-s ato ishin të miratuara nga drejtuesi i Departamenti të Drejtësisë. Referencë: <i>Syllabus-et e PIND (Aneksi 1.6, Evidenca 15)</i> <i>Statuti i UNYT-s (Aneksi 1.2.1 Evidenca 10)</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit përmban Planin Mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</i> <i>Përmbajtja e programit është në përmirësim të vazhdueshëm sipas një procedure të përshkruar në mënyrë të qartë dhe transparente në dokumentat bazë strategjike të institucionit. Programi ka të dhëna jo të plota në lidhje me kriteret për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive,	GVJ ka shqyrtuar Planin mësimor të PIND, Rregulloren e programit të studimit, si edhe përmbajtjen e veprimtarive




shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	formuese dhe akademike të cdo lënde në kurrikul, sic gjenden në dosjen e syllabuseve të programit. GVJ konfirmon përfshirjen në këtë program studimi të lëndëve në fushën e së drejtës civile, tregtare, administrative dhe penale etj, që garantojnë aftësimin e tyre jo vetëm teorik, por edhe praktik, duke iu mundësuar atyre aftësimin profesional i përshtatshëm për tregun e punës. Organizimi i lëndëve në semestra ofron një balancim të arsyeshëm të njohurive të dhëna dhe progresion drejt rritjes graduale të njohurive dhe aftësive të studentëve, që kulmojnë me praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse në semestrin e fundit. Programi i studimit ofron edhe lëndën Intership-Praktika, e cila i përgatit në aspektin praktik dhe profesional. Për cdo lënë, është parashikuar përfshirja e studentëve në detyra kursi, projekte, raste praktike etj. Referencë: <i>Rregullorja e PIND (Aneks 1.21, Evidenca 21)</i> <i>Syllabuset e lëndëve (Aneks 1.6 Evidenca 15)</i> <i>Plani mësimor i PIND (Aneks 1.5, Evidenca 14)</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Në funksion të qëllimit dhe objektivave formues të synuar në program, studentëve u jepen njohuri në lëndë të ndryshme të së drejtës civile, tregtare, kushtetuese, bankare etj. përgjatë 5 viteve akademike (të ndarë në dhjetë semestrave) Referuar Programit mësimor të riorganizuar në prill 2020, (tabela 2.1) të dhënat janë të ndryshme kështu: - Lëndët bazë (A) zënë 18.66% të krediteve (56 ECTS); - Lëndët karakterizuese (B) zënë 55% të krediteve (165 ECTS); - Lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 14.66% të krediteve (44 ECTS); - Lëndët plotësuese (D) zënë 7.33 % të krediteve (22 ECTS) - Detyrimet përmbyllëse (E) zënë 4% të krediteve (12ECTS); <u>Në lidhje me shpërndarjen e krediteve shiko komentin në faqe 37 në lidhje me standartin II 3 Kriteri 2.</u>

	Referenca: <i>Plani mësimor i PIND (Aneksi 1.5 Evidenca 14)</i> <i>Rregullorja e PIND (Aneksi 1.21, Evidenca 21)</i> <i>Kalendari akademik (Aneksi 2.12.1, Evidenca 84)</i>												
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Përsa i përket strukturës së programit, organizimit në vite akademike dhe semestra, numrit total të krediteve dhe renditjes së lëndëve sipas semestrave, GVJ konstaton që lëndët dhe renditja tyre janë në të njëjtën linjë me programe të ngjashme ndërkombëtare (dhe kombëtare). GVJ rikonfirmon se UNYT ndjek një qasje të ndarjes së pabarabartë të krediteve, bazuar në peshën specifike të lëndëve karakterizuese, e cila përputhet me modele të universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit. <u><i>Në lidhje me shpërndarjen e krediteve shiko komentin në faqe 37 në lidhje me standartin II 3 Kriteri 2.</i></u> <u><i>Në lidhje me shpërndarjen e lëndëve shiko komentin në lidhje me III Kriteri 7</i></u> Referenca: <i>Rregullorja e PIND (Evidenca 35)</i> <i>RVB Tabela 9</i>												
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Përsa i përket ngarkesës totale në auditor, PIND ka strukturën e mëposhtme (tabela 13 në Tabelën përmbledhëse): <table> <tr> <td>• Leksione</td><td>1539 orë;</td></tr> <tr> <td>• Seminare</td><td>751 orë;</td></tr> <tr> <td>• Ushtrime</td><td>75 orë;</td></tr> <tr> <td>• Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor</td><td>34 orë;</td></tr> <tr> <td>• Praktikë profesionale</td><td>85 orë;</td></tr> <tr> <td>• Diploma</td><td>300 orë</td></tr> </table>	• Leksione	1539 orë;	• Seminare	751 orë;	• Ushtrime	75 orë;	• Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor	34 orë;	• Praktikë profesionale	85 orë;	• Diploma	300 orë
• Leksione	1539 orë;												
• Seminare	751 orë;												
• Ushtrime	75 orë;												
• Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor	34 orë;												
• Praktikë profesionale	85 orë;												
• Diploma	300 orë												

	Totali 2784 orë Raporti Teori (leksione) / Praktikë (sem+usht+proj+prakt.prof) rezulton 1539 orë teori / 1245 orë praktikë ose afërsisht 57% /43%. Kjo balancë mundëson arritjen e objektivave formuese të cilat sic renditen në rregulloren e programit të studimit, ndër të tjera përfshijnë edhe që “programi ka si objektiv të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore shkencore në disiplinat e së drejtës civile dhe tregtare, por edhe me aftësitë e duhura për t’u integruar në tregun e punës dhe shpalosur njohuritë e fituara dhe zotësinë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, ofrimin e sugjerimeve dhe ideve të reja në këto disiplina. Referencë: <i>RVB Tabela Përmbledhëse (Aneksi 1.26 Evidenca 42)</i> <i>Syllabus-et e lëndëve të PIND</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset përmbajnë literaturë të detyrueshme dhe literaturë të rekomanduar. Nga analiza e tyre, GVJ konstaton se në tërësi ato janë kryesisht të përditësuar, jo vetëm në aspektin formal, por edhe atë përmbajtësor. Përditësimi i literaturës ka hapësirë për përmirësim. <i>Në pjesën më të madhe të lëndëve literatura është më e vjetër se e 5 viteve të fundit.</i> Në vlerësimin e GVJ-s, kjo mangësi nuk mund të marri peshë të madhe duke ditur se literatura e përditësuar në fushën e së drejtës nuk është gjithnjë e mundur të plotësohet qartësisht si kriter, sidomos në kontekstin e lëndëve që i referohen legjislacionit shqiptar. Zëvendësimi i tyre me literaturë të huaj (<i>sic do të mund të bëhej në lëndët shkencore</i>) në kuadrin e zbatueshmërisë së legjislacionit shqiptar është i padobishëm. <i>Në këto kushte, GVJ sugjeron, për sa është e mundur, të pasurohet literatura me artikuj shkencorë të botuara në revista shkencore juridike me ISBN.</i> Referencë: <i>Syllabuset e lëndëve të PIND</i>

Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ është e mendimit se përmbajtja e programit të studimit të PIND garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Rregullorja e PIND parashikon që misioni i këtij programi studimi është <i>(ndër të tjera)</i>: Gjenerimi i profesionistëve ligjorë të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm. Për të realizuar këtë, studenti duhet të aftësohet që: 1. Të kuptojë procesin e argumentimit ligjorë dhe arsyetimit; 2. Të zhvillojë kompetencën në interpretimin dhe përdorimin e dispozitave kushtetuese, ligjore dhe statutore; 3. Të ndërtojë aftësinë për të kontekstualizuar vendimet juridike. <i>(neni 6 Rregullore e PIND)</i> Në funksion të qëllimit dhe objektivave formues të synuar në program, studentëve u jepen njohuri në lëndë të ndryshme të së drejtës civile, tregtare, penale, administrative, kushtetuese, bankare etj. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11 Evidenca 21)</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ vlerëson se përmbajtja e programit të studimit PIND mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Programi kombinon teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën duke mundësuar përvetësimin e dijeve bashkëkohore, nxitjen e mendimit krijues dhe kritik te studentët, në përputhje me qëllimin e programit. Në këtë mënyrë program mundëson si vijimin e rrugës akademike, ashtu edhe atë praktike në tregun e punës. Referencë: <i>Syllabuset e lëndëve të PIND (Aneks 1.6 Evidenca 15)</i> <i>Plani mësimor (Anex 1.5, Evidenca 14)</i> <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11 Evidenca 21)</i>
Konkluzione	<i>Në vlerësimin e GVJ-s, programi kombinon teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën duke mundësuar përvetësimin e dijeve bashkëkohore, nxitjen e mendimit krijues dhe kritik te studentët, në përputhje me qëllimin e programit.</i> <i>Në bazë të këtyre konstatimeve, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave të programit</i>

	të studimit, mundësojnë plotësisht thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. <u>GVJ rekomandon, të pasurohet literatura për sa është e mundur, me artikuj shencorë të botuara në revista shkencore juridike me ISBN.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në RVB dhe dokumentet bashkangjitur, GVJ nuk mundi të evidentojë ndonjë dokument që përcakton procedurën konkrete për ndryshimin/përmirësimin e programeve të studimit. Në dosje gjendet një studim biznesi i cili analizon në varësi të nevojave të tregut të punës edhe strategjinë e zhvillimit të UNYT-s. Në dokumentet e tjera në DVV, të konsultuara nga GVJ, nuk pasqyrohet nëse ka patur apo jo rekomandime konkrete të institucioneve partnere, të të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës në lidhje me përmirësimin e cilësisë së programit të studimit dhe nëse po cilat kanë qenë dhe a janë marrë ato në konsideratë nga UNYT. Nga krahasimi i përmbajtjes së programit aktual të studimit të me atë të programit fillestar, konstatohet se nuk ka ndryshime Referencë: <i>Studimi i tregut (Ankesi 1.23 Evidenca 38)</i> <i>RVB (Evidenca 5)</i> <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11 Evidenca 21)</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime	Në statutin e UNYT-s parashikohet shprehimisht përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese të tij. Në

studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	nenin 74 të Statutit parashikohet pse studentët janë pjesë e komunitetit akademik përmes përfaqësuesve të tyre në organet e UNYT-s. Ata mund të shprehin opinionet e tyre mbi çështjet e politikave institucionale dhe çështje me interes të vecantë. Studentët marrin pjesë në unionet dhe klubet studentore për të shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me poilitikat e UNYT-s. Në nenin 75 të Statutit të UNYT-s parashikohet edhe mënyra e funksionimit të Unionit të Studentëve. Në nenin 28 parashikohet përfshirja e një përfaqësuesi nga studentët në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në nenin 18 të Statutit të UNYT-s parashikohet se në përbërjen e senatit akademik është edhe një përfaqësues i studentëve, i zgjedhur nga Këshilli Studentor. Në nenin 36/4 të Statutit parashikohet që pjesë e KPSSC (Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë) është një përfaqësues i studentëve. Referuar edhe diskutimeve me studentët në ditën e vizitës në Institucion, GVJ është e mendimit se Institucioni inkurajon dhe përfshin aktivisht studentët dhe strukturat e tyre përfaqësuese në diskutimet akademike dhe administrative që lidhen me programin e studimit. Referencë: <i>Statuti i UNYT-s (Aneksi 1.2.1 Evidenca 10)</i> <i>Vendim Senati për përfshirjen e studentit në NjSBC (Ankesi 2.16 Evidenca 92)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe	Sipas bisedës me pedagogë në ditën e vizitës në institucion, propozimi për të ndryshuar/përmirësuar një program studimi paraqitet nga njësia bazë (<i>Departamenti</i>) pas konsultimit me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës. Vendimi i njësisë bazë, pas marrjes së mendimit me shkrim të një eksperti të jashtëm duhet të dërgohet tek njësia kryesore (Dekanati). Njësia kryesore ka përgjegjësinë të shqyrtojë propozimet e paraqitura nga njësia bazë dhe t'i paraqesë ato në senatin akademik. Senati Akademik është autoriteti që merr vendimin për miratimin apo jo të propozimeve të paraqitura nga Departamenti. Në lidhje me këtë kriter RVB nuk ofron informacion relevant.

institucione publike e private.	GVJ konsultoi dokumentet në DVV, duke analizuar ndër të tjera edhe opinionin e aktorëve të tregut. Në analizën e marrëveshjeve të Departamentit të Drejtësisë me aktorë të tregut si institucione publike apo private, shoqata, etj ofrohen evidenca që mbështesin bashkëpunimin e njësisë përgjegjëse me rrjete profesionistësh, që japin kontributin e tyre në drejtim të pasurimit të përmbajtjes dhe rritjes së cilësisë së programit të studimit. Një nga llojet e bashkëpunimit me këto aktorë është edhe shkëmbimi reciprok i risive, publikimeve, materialeve didaktike dhe shkencore etj të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Referencë: <i>Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit profesional (Aneksi 1.13 Evidenca 24)</i> <i>Lista e kompanive të praktikës profesionale (Aneksi 2.6 Evidenca 76)</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni analizon, për çdo fakultet dhe departament, ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë mendimet e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionet e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Misioni i programit të studimit përcaktohet qartë në nenin 6 të Rregullores së Programit, dhe në mënyrë të përbeldhur është si më poshtë: - Gjenerim të profesionistëve ligjorë të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm që të kuptojnë mënyrat në të cilat ligji funksionon, ose në rast vakumi lgjor; “Demistifikim”i ligjit dhe proceseve ligjore duke nxitur reflektim kritik mbi ligjin dhe studimin e tij;

	c. Përgatitjes së studentëve për nevojat ligjore gjithnjë e në ndryshim që burojnë nga integrimi i Shqipërisë në NATO, BE dhe tërheqja e investimeve të huaja direkte; d. Plotësimit të studentëve me përvojë të rëndësishme praktike dhe edukimit të tyre ligjor teorik. Objektivat e mësipërme janë tërësisht në përputhje me misionin e UNYT-s (neni 6 i Statutit të UNYT-s), misioni i të cilit është krimi, zhvillimi dhe eavancimi i dijes, si dhe përgatitja e qytetarëve që do të udhëheqin të ardhmen, profesionistë të ardhshëm dhe akademikë, përmes mësimdhënies, të nxënës dhe kërkimit shkencorë me fokus zhvillimin personal dhe integrimin në komunitet të ofrojë dije, aftësi, karakter dhe besim të nevojshëm për sukses në një mjedis të larmishëm dhe ndërkombëtar. Misioni i UNYT-s është të ofrojë dije teorike, teknike dhe praktike për studentët e tij, duke i përgatitur ata për karrierë, që janë objektiva thelbësorë të arsimit. Këto përfshojnë zhvillimin e individit të menduar, kultivimin e kreativitetit dhe epjekurinë e ndjeshmërisë sociale dhe ekullore. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11 Evidenca 21)</i> <i>Statuti i UNYT-s (Aneksi 1.2.1 Evidenca 10)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Gjatë vizitës, stafi akademik u shpreh se kishte gjithë mbështetjen e nevojshme për rritjen akademike të tyre si nëpërmjet kërkimit shkencor ashtu edhe projekte apo aktivitetet të tjera në fushën e mësimdhënies. Bazuar në përshkrimin dhe ndarjen e detyrave dhe të përgjegjësi, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë u japin lirinë dhe nxitjen e nevojshme stafit akademik për zhvillimin e aktiviteteve didaktike dhe kërkimore e shkencore të programit të studimit. Referencë: <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime,	Sipas dokumentave në DVV, GVJ konstatoi se studentët janë aktivë dhe marrin pjesë në projekte aktivitete të ndryshme të tilla si: Gjyq imitues pranë "Halimi Fondation Institut". <i>GVJ sugjeron shtimin e pjesëmarrjes së studentëve në më shumë aktivitete.</i>

projekte dhe aktivitete kërkimore.	Referencë: <i>Vizita në Institucion</i> <i>Cmimi i dytë "Gjyqi simulues Halimi Foundation 2022 (Aneksi 2.20.1,2, 3; Evidenca 87, 88 dhe 89)</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Nga dokumentet e konsultura të DVV dhe takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se Departamenti i Drejtësisë ka organizuar një sërë aktiviteteve shkencore. Drejtuesja e njësisë bazë (DD) u shpreh se mbështetja financiare nga ana e Institucionit ka qenë e tejet e konsiderueshme.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit është organizuar duke mundësuar, nxitur dhe motivuar studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore si, konferenca studimore me caktime të cmimeve inkurajuese për kërkuesit e rinj, punime dhe projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogët e programit.</i> <i>Edhe njësia bazë dhe stafi akademik mbështeten financiarisht nga Institucioni për të nxitur rezultate sa më të mira të punës kërkimore dhe shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të	FDSHS në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional, për arritjen e objektivave në ofrimin e edukimit sa më cilësor ka qenë i anagzhuar, për zgjerimin e bashkëpunimit në planin ndërkombëtar në lidhjen e marrëveshjeve. Bashkëpunimi me qendra të tjera kërkimi shkencor ka cuar në zbatimin e projektit për Arsimin DUAL në Shqipëri (DUALBA), në të cilin Universitete, Institucione të tjera dhe partnerë biznesi do të zhvillojnë dhe zbatojnë programe pilotuese të arsimit të

studimit në kërkim shkencor.	dyfishtë. UNYT do të zhvillojë Edukimin e Dyfishtë Ligjorë si pjesë e këtij projekti. Në mars të vitit 2025, Departamenti i Drejtësisë bahskëpunoi me Institutin për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtën Humanitare Raoul Wallenberg, përfaqësues të Kombeve të Bashkuara dhe aktivistë të të drejtave të njeriut për organizimin e takimit të mbyllur të ekspertëve me tematikë “Human Rights and Humanitarian (plus) Actors: The Challenges & opportunities in Addressing the Rights and needs of At-risk Groups in Afghanistan”. Referencë: <i>Aktivitetet të Departamentit të Drejtësisë (Aneksi 1.14 Evidenca 26)</i> <i>Informacion për projektin DUALBA (Aneksi 1.36 Evidenca 52)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Në rregulloret e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UNYT parashikohet shprehimisht pjesëmarrja dhe angazhimi i stafit akademik dhe studentëve. Nga studimi i dokumenteve në DVV, GVJ konstaton se në tërësi aktivitetet shkencore të përmendura në listën e aktiviteteve dhe në projektet kombëtare edhe ndërkombëtare, angazhimi i stafit akademik dhe studentëve ka qenë maksimal. Nxitja e vazhdueshme e stafit akademik për të zhvilluar kërkim shkencor evidentohet edhe në raportin e vlerësimit të programit të studimit nga Drejtuesi i Njesisë kryesore. Pjesëmarrja e stafit akademik në programe të ndryshme si: Gjyqet imituese me Fondacionin Halimi, projektin DUALBA etj, janë tregues i angazhimit të plotë dhe mbëhstetjes që i jep Departamenti personelit akademik. Referencë: <i>Aktivitetet të Departamentit të Drejtësisë (Aneksi 1.14 Evidenca 26)</i> <i>Informacion për projektin DUALBA (Aneksi 1.36 Evidenca 52)</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin	GVJ konstatoi një listë të mjaftueshme të aktiviteteve shkencore konferencave dhe takimeve të tjera që ndihmojnë si stafin akademik, ashtu edhe studentët e programit të studimit. Leksionet e hapura, trajnimet dhe shkëmbimet në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare, pjesëmarrja në dsa konkurse kombëtare dhe



dhe studentët për arritjen e objektivave.	ndërkombëtare si Moot Court apo Debatit studentor ndërkombëtar etj, janë disa shembuj pozitivë të nxitjes së aktiviteteve në fushën e së drejtës civile dhe tregatë, ndërgjegjësimit të studentëve në lidhje me çështje të rëndësishme të profesionit por edhe të punëdhënësve të cilët përmes këtyre aktiviteteve vijnë në kontakt me institucionin dhe me studentët. Referencë: <i>Aktivitetet të Departamentit të Drejtësisë (Aneksi 1.14 Evidenca 26)</i> <i>Informacion për projektin DUALBA (Aneksi 1.36 Evidenca 52)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Në bazë të Planit Mësimor të programit PIND dhe syllabuseve përkatëse, GVJ vlerëson se studentët e diplomuar janë përgjithësisht të aftë të punojnë në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit. Ata janë konkurrues për këtë treg dhe mund të përshtaten me kërkesat e paraqitura nga punëdhënësi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, GVJ vlerësoi disa satistika, sipas të cilave përqindja e të punësuarve në nivel institucional deri në vitin 2022 ishte 98%. Një tregues i fortë i plotësimit të këtij kriteri. GVJ sugjeron rivlerësimin e situatës në një trend periodik. Referencë: <i>Statistika mbi punësimin e studentëve në nivel institucioni (Aneksi 5.20 Evidenca 216)</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Në përfundimin me sukses të PIND studenti merr 300 ECTS, të cilat janë kriter hyrës në të gjitha provimet për marrjen e licencës për profesionet e lira në fushën e së drejtës (si psh licencën e avokatisë, notërisë, ndërmjetësimi). Nga bisedat me stafin akademik, u konstatua se njësia bazë mban marrëdhënie profesionale si me Dhomën e Avokatisë, ashtu edhe me të Noterisë dhe Ndërmjetësimit (por jo vetëm) për të diskutuar dhe konsultuar programin e studimit, me qëllim që këta studentë të jenë sa më mirë të përgatitur për ndjekjen e shkollave apo dhënien e provimeve profesionale pas përfundimit të programit të studimit
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e	Ky kriter nuk gjen zbatim në këtë program studimi.

rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).				
Konkluzione	GVJ konstaton mbështetjen institucionale në kuadër të organizimit të aktiviteteve kërkimore dhe shkencore në formën e hartimit të rregulloreve të posacme, mbështetjes financiare dhe logjistike si edhe krijimit të kushteve për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve dhe stafit të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë,	Në lidhje me format e organizimit të mësimdhënies GVJ konstatoi se neni 6 i Rregullores së FDSHS parashikon se, programi ofrohet përmes leksioneve, seminareve, workshop-eve etj. Mësimdhënia dhe të nxënës organizohen në një larmi metodash tradicionale (<i>leksione ekspozuese, provative, ëorkshope, tutoriale</i>) dhe innovative (<i>ambiente virtuale të të</i>

projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

nxënit, simulime, debate, diskutime në grupe, projekte individuale dhe në grup, etj.) Vlerësimi lidhet me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit. Të tilla janë projekte, diskutime në klasë, ushtrime në laborator, ekspozita, ese reflektuese mbi lexime të caktuara, recensione librash ose artikujsh, provime të shkruara (brenda ose jashtë klasës me libra të hapura apo jo), ese dhe punë kërkimore, prezantime individuale apo në grupe.

Cdo semestër organizohet në 15 javë akademike. Vlerësimi i njohurive të studenteve për secilin kurs bëhet në menyre të vazhdueshme dhe shprehet nëpërmjet krediteve dhe notës së kursit. 1 kredit ECTS i korespondon 25 orëve mësimore në auditore dhe jashtë saj. Në përfundim të suksesshëm të cdo semestri akademik studenti përfiton 30 kredite ECTS, dhe si rrjedhim në përfundim të suksesshëm të programit të studimeve studenti fiton 300 kredite ECTS.

Përqindja përkatëse që zenë këto komponentë përgjithësisht por pa u limituar në to, është:

- 40%-50% provim përfundimtar;
- 20%-30% provim i ndërmjetëm;
- 10%-20% detyra kursi, prezantim punim shkencor;
- 10%-20% pjesëmarrje aktive;

Studentët pritet të studiojnë tekstet primare dhe sekondare akademike dhe shkencore, së bashku me materialet përkatëse të azhurnuara, duke shfrytëzuar njëkohësisht edhe mundësitë që UNYT ofron përmes platformës e-learning. Cdo kurs lektohet 3-4 herë në javë. Futja e bazave të të dhënave ndërkombëtare të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor është një avantazh konkurrues i këtij programi përmes ofrimit të literaurës nga tekste të dallueshme ndërkombëtare si Oxford University Press, Canbredge University Press etj.

Format e mësimdhënies janë të koordinuara me procesin e mësimxënies, duke mundësuar për studentët shprehitë e dijeve në fomën e detyrave të kursit, projekteve, provimeve dhe debateve akademike në auditor. Në përfundim të secilës lëndë është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës, si dhe teza e diplomës/provimi përfundimtar, pas përfundimit të të gjitha provimeve të lëndëve (moduleve) të programit. Forma e studimeve të PIND është dy vite akademike me kohë të plotë,



	të ndara në katër semestra, me jo më pak se 60 kredite në vit. Vlerësimi nga pikëpamja akademike e leksioneve, projekteve dhe detyrave, praktikave seminareve dhe punimeve të tjera të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse “orë” të zhvilluar në auditor si dhe orë pune të pavarura studimore të kryer nga studenti. Një krediti formimi universitar i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit. Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh universitare nga një student me kohë të plotë është 60 kredite ose 1500 orë mësimore punë të studentit. Këto përfshijnë orë në auditor dhe orë për punë të pavarur të tij. Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale, vjetore, provimeve të fundvitit, detyrave të kursit, prezantimeve, aktivizim në praktikën mësimore dhe përgatitjes së temave të diplomës. Referencë: <i>Rregullorja e PIND (Ankes 1.11 Evidencë 21)</i> <i>RVB Anex, Tabela 10 (Evidencë 5)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua që mësimdhënia zhvillohej në mënyrë interaktive jo vetëm në seminare por edhe në leksione, duke vendosur studentin në qendër. Studentët njiheshin me temën që do trajtohej paraprakisht dhe kjo e bënte leksionin më inetersant dhe frytdhënës në aspektin e mësimnxënies. Studentët e kontaktuar gjatë vizitës në Institucion u shprehën se ishin shumë të kënaqur me larminë e metodave didaktike të pedagogëve të cilët angazhohen për të përfshirë sa më shumë studentët dhe për t’iu përgjigjur nevojave të tyre. Rastet studimore, “role play”, puna në grupe, “learning by doing”, përdorimi i materialeve audio-vizive janë disa nga metodat inovative të përdorura në auditor, të cilat janë vlerësuar pozitivisht nga studentët në takimet e zhvilluara nga GVJ. Kushtet logjistike të klasave ishin të mira për të garantuar që personeli akademik të angazhohej në mënyra alternative mësimdhënieje (raste studimore apo lektorë të ftuar dhe aktivitete të tjera të organizuara nga njësia bazë) dhe duke përdorur mjete të ndryshme si kompjuterë, projektorë, etj.

	Referencë: <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Referuar Tabelës përmbledhëse, ku evdientohet personeli akademik, GVJ konstatoi se 70% e stafit janë të njëjtë në tre vitet e fundit të programit. Ky tregues i stabilitetit të stafit akademik dëshmon për trajtim dinjitoz, profesional dhe mbështetje të tyre nga ana e Institucionit. Këtë fakt e konfirmuan pa asnjë rezervë të gjithë pedagogët e kontaktuar gjatë vizitës në Institucion. UNYT ka mbështetur personelin akademik që të përfitoi nga programet e vizitave dhe shkëmbimit të personelit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohuri me praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. Referuar dokumentacionit në DVV dhe nga diskutimi me stafin akademik gjatë vizitës në Institucion, konfirmohet kjo mbështetje. Referencë: <i>Plani mësimor i PIND (Aneks 1.5, Evidencë 14)</i> <i>Konferencat dhe [unimet shkencore të stafit akademik PAK dhe PAE (Aneksi 2.19 Evidenca 95)</i> <i>Forma e mbështetjes financiare për stafin akademik (Aneksi 3.24 Evidencë 131)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe	Nga shqyrtimi i dosjeve të CV-ve të personelit akademik efektiv në programin e studimit të ciklit të dytë të integruar, dosjet e vetëvlerësimit të tyre si edhe dokumenta në DVV si kualifikimet dhe kërkimet shkencore të PAE gjatë viteve të fundit dhe trajnimet dhe shkëmbimet në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, pedagogët janë të përgatitur për të ofruar mësim cilësor dhe kanë përputhshmëri mes fushës së formimit të tyre akademik dhe njohurive të nevojshme për t'u përcuar tek studentët e programit të studimit. Në lidhje me angazhimin si titullarë lëndësh, referuar të dhënave mbi personelin akademik të përfshirë në programin e studimit si dhe syllabuset e lëndëve, GVJ evidentoi që titullarët e lëndëve të PIND <u>nuk kanë titullin Profesor.</u>

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<i>GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për të mundësuar si titullarë lëndësh në këtë program studimi personel akademik të kategorisë "Profesor", sipas pika 3 neni 59, Ligjit Nr. 80/2015.</i> Gjatë procesit mësimor, stafi akademik u shprehën se janë të prirur të nxisin pjesëmarrje dhe nivel të lartë të aktivizimit të studentëve, të zgjojnë tek ata të menduarin kritik dhe gjykimin profesional. Studentët u shprehën se procesi mësimor karakterizohet nga mbështetja dhe orientimi i stafit pedagogjik drejt aftësimit praktik të tyre. Referencë: <i>CV-t e lektorëve, të PIND (Aneks 1.28, Evidenca 44)</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Rregullorja e PIND arashikon se një nga funksionet e Përgjegjësit të Departamentit është "mbikqyrja e respektimit të programeve të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të veprimtarive të tjera". Cdo department zgjedh Komitetin shkencor për cdo program të studimit të ciklit të dytë, i cili përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik. Komiteti shkencor mban përgjegjësinë organizative për programin përkatës të ciklit të dytë. Komiteti shkencor përgatit dhe propozon strategjinë e zhvillimit, planin dhe strukturën e studimeve, dhe programin e kërkimeve. Komiteti përgatit cdo vit raportin e veprimtarive të programeve të studimit të ciklit të dytë. Në UNYT studentët bëhen rregullisht pjesë e procesit të vlerësimit të procesit të mësimit dhe të pedagogut nëpërmjet anketimit sipas modaliteteve të parashikuara në Rregulloren e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sipas kësaj rregulloreje në fund të cdo semestri, para sezonit të provimeve, Njësia organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo program studimi në bashkëpunim me sekretarinë mësimore. Pas cdo vlerësimi raportin para Senatit akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse. Referencë: <i>Formular vlerësimi të personeli akademik nga kolegët (Aneks 6.4, Evidenca 239)</i>

	<i>Vlerësimet e pedagogëve nga studentët (Aneksi 6.9.1, Evidencë 247)</i> <i>Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. (NJBSC) (Aneks 6.7, Evidenca 243)</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni e ka pjesë të strategjisë së tij përmirësimin në vijimësi të procesit akademik, përmes përfshirjes së të gjitha strukturave akademike, ndihmës-akademike dhe administrative. Shtyllat bazë të strategjisë së institucionit lidhen me procesin akademik në tërësi dhe kërkimor-shkencor. Stafi akademik trajnohet në vijimësi për të përmirësuar metodat e mësimdhënies dhe për të përdorur metodat më innovative, në varësi të cdo programi studimi. Bashkëpunimi ndërmjet njësive është i përcaktuar në aktet bazë të institucionit. Zyra që mbështet në mënyrë të vazhdueshme dhe specifike përdorimin dhe aplikimin efektiv të metodologjisë së duhë në procesin akademik është zyra e koordinuese e teknologjisë së inovacionit dhe komunikimit. Programet e ciklit të dytë drejtohen nga departamentet përkatëse. Koordinator i përgjithshëm i programeve të ciklit të dytë emërohet nga Senati akademik. Cdo program i ciklit të dytë ka një koordinator të vecantë, i zgjedhur nga Komiteti shkencor. Referuar Rregullores së PIND cdo department zgjedh Komitetin shkencor për cdo program të studimit të ciklit të dytë, i cili përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik. Ky Komitet përgatit dhe propozon strategjinë e zhvillimit, planin dhe strukturën e studimeve dhe programin e kërkimeve. Komiteti përgatit cdo vit raportin e veprimtarive të programeve të studimit të ciklit të dytë. NJBSC është strukturë përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Rektorit. Njësia gëzon autonomi dhe akses në të dhënat e Institucionit. NJBSC i ushtron funksionet e saj në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili hartohet në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe miratohet nga Senati. Në fund të cdo semestri ose para sezonit të provimeve, NJBSC organizon pyetësin për studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo program studimi. NJBSC evidenton problematikat, propozon mjete dhe procedura mbi bazën e elgjislacionit të arsimit të lartë,

	standartet e cilësisë, praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe zgjedhje për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. NJBSC përgatit raportin vjetor të vetëvlerësimit. Raportet e vlerësimeve përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në Raport NJBSC udhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Raporti përmban arritjet dhe jep sugjerimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë. Propozimet e NJSBC shqyrtohen nga organet dhe autoritet drejtuese të Institucionit dhe reflektohen në vendimmarrjen konkrete. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneks 1.11, Evidenca 21)</i> <i>Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. (NJBSC). (Aneks 6.7, Evidenca 243)</i> <i>Manual i sigurimit të cilësisë (Aneks 6.1, Evidencë 232)</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni organizon struktura të mjaftueshme që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe garantojnë procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin. Studentët përfshihen në procesin e vlerësimit të procesit mësimor.</i> <i>GVJ rekomandon që, në përputhje me kriteret ligjore në fuqi Institucioni të marrë masa për të mundësuar si titullarë lëndësh në këtë program studimi personel akademik të kategorisë "Profesor".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2




Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																		
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit të vlerësimit të njohurive përcaktohen në Rregulloren e PIND dhe në Procedurën e Provimeve. Sipas këtyre Rregulloreve, por edhe pasi GVJ konsultoi programet e disa lëndëve, konstatoi se studentët vlerësohen mbi bazën e provimeve semestrale/vjetore, detyrave të kursit, prezantimeve, aktivizimeve, praktikës mësimore dhe përgatitjes së temës së diplomës. Provimi, është forma kryesore për vlerësimin e nivelit të përvetësimit të njohurive që studenti ka përfutur gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde. Studenti përfiton të drejtën për tu paraqitur në provimin e një lënde, kur ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin mësimor dhe në masën e përcaktuar në këtë rregullore si dhe në akte të tjera që rregullojnë këtë problematikë. Studenti përfiton të drejtën për t'u paraqitur në provim, kur shlyerja e detyrimeve të konfirmuar nga pedagogu në pasqyrën e rezultateve të detyrimeve që plotësohet në përfundim të procesit mësimor dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore, të paktën një javë para fillimit të sezonit të provimeve. Studenti ka detyrimin të ndjekë të paktën 75% të lëndëve teorike dhe të paktën 75% të laboratorit dhe aplikimit. Studentët të cilët nuk përmbushin këto norma nuk hyjnë në provimin përfundimtar semestral. (neni 36 i Rregullores së PIND) Vlerësimi bëhet në përputhje me nenin 37 të Rregullores së PIND si më poshtë:																																		
	<table><tr><th rowspan="2">Nota (sipas sistemit shqiptar)</th><th rowspan="2">Shpjegimi</th><th>Vlerësim</th><th></th><th></th></tr><tr><th>Pikët</th><th>Nota shkronjë</th><th>Pikë cilësie</th></tr><tr><td>10</td><td>Ekselent</td><td>90-100</td><td>A</td><td>4,00</td></tr><tr><td rowspan="2">9</td><td rowspan="2">Shumë mirë</td><td>85-89</td><td>A-</td><td>3,66</td></tr><tr><td>80-84</td><td>B+</td><td>3,33</td></tr><tr><td rowspan="2">8</td><td rowspan="2">Mirë</td><td>75-79</td><td>B</td><td>3,00</td></tr><tr><td>70-74</td><td>B-</td><td>2,66</td></tr><tr><td>7</td><td>Kënaqshëm</td><td>65-69</td><td>C+</td><td>2,33</td></tr></table>	Nota (sipas sistemit shqiptar)	Shpjegimi	Vlerësim			Pikët	Nota shkronjë	Pikë cilësie	10	Ekselent	90-100	A	4,00	9	Shumë mirë	85-89	A-	3,66	80-84	B+	3,33	8	Mirë	75-79	B	3,00	70-74	B-	2,66	7	Kënaqshëm	65-69	C+	2,33
Nota (sipas sistemit shqiptar)	Shpjegimi			Vlerësim																															
		Pikët	Nota shkronjë	Pikë cilësie																															
10	Ekselent	90-100	A	4,00																															
9	Shumë mirë	85-89	A-	3,66																															
		80-84	B+	3,33																															
8	Mirë	75-79	B	3,00																															
		70-74	B-	2,66																															
7	Kënaqshëm	65-69	C+	2,33																															

		60-64	C	2,00
6	Mjaftueshëm	55-59	C-	1,66
		50-54	D+	1,33
5	Kalues	45-49	D	1,00
4	Jokalues	40-44	D-	0,66
		0-39	F	0

Referencë:
Syllabus-et e PIND (Aneks 1.6, Evidencë 16)
Rregullorja e PIND (Aneksi 1.11, Evidenca 20)
Rregullorja e FDSHS (Aneksi 1.8, Evidenca 18)

Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se metodologjia e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore është e parashikuar në të gjitha syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit, të cilat janë të aksesueshme nga të gjithë studentët që në fillim të vitit akademik. Nga informacioni i marrë dhe i kryqëzuar nga pedagogët e lëndëve dhe studentët gjatë vizitës në UNYT, rezulton se studentët vihen në dijeni të metodologjisë së vlerësimit që në orët e para të zhvillimit të lëndës. Referencë: <i>Syllabuset e PIND (Aneks 1.6, Evidencë 16)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi për secilin kurs bëhet sipas raportit të mëposhtëm: - Provim përfundimtar 40%; - Povim afatmesëm 30%; - Aktivitete 20%; - Pjesëmarrja 10 %; Kriteret për përbërjen e provimit afatmesëm dhe atij përfundimtar do të përcaktohen nga stafi akademik përkatës, në fillim të semestrit. (neni 32 i Rregullores së PIND). Pedagogët kanë liri akademike të vlerësojnë peshën specifike të çdo komponenti në varësi të lëndës, në mënyrë që t'i japi studentit mundësi të demonstrojë më së miri njohuritë dhe kompetencat e fituara.

	Referencë: <i>Rregullorja e FDSHS (Aneks 1.8, Evidencë 18)</i> <i>Rregullore e PIND (Aneks 1.11, Evidenca 21)</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>Në PIND ka rregulla të qarta dhe të balancuara të vlerësimit të studentëve të cilat përfshihen në kuadrin rregullator të brendshëm të Institucionit, në syllabus-et e lëndëve, dhe u bëhen me dije studentëve në fillim të cdo lënde/moduli.</i> <i>Mënyra e vlerësimit është e diversifikuar mes disa formave të vlerësimit (provim me shkrim dhe/ose me gojë, detyra kursi, projekte etj) duke mundësuar që studentët të shfaqin aftësitë e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në zbatim të Rregullores së PIND (neni 32), vlerësimi për secilin kurs bëhet sipas raportit të mëposhtëm: - Provimi përfundimtar 40%; - Provim afatmesëm 30%; - Aktivitete 20%; - Pjesëmarrja 10%; Kriteret për përbërjen e provimit afatmesëm dhe përfundimtar përcaktohen nga stafi akademik përkatës në fillim të semestrit. Kreditet e veprimtarisë do të jepen sipas: Pjesëmarrjes aktive; kuize, Deryrat e shtëpisë javore; Punime; Aktivitete mësimore praktike etj. Kushtet e provimit përcaktohen në Kalendarin Akademik dhe janë të shpallura në faqen e internetit të Universitetit. Pedagogët kanë liri akademike të vlerësojnë peshën specifike të cdo komponenti në varësi të lëndës, në mënyrë që t'i japi studentit

	mundësi të demonstrojë më së miri njohuritë dhe kompetencat e fituara. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11 Evidenca 21)</i> <i>Procedurat e provimeve (Aneksi 3.17 Evidenca 119 & 120)</i> <i>Kalendari Akademik (Aneksi 2.12. dhe 2.12.1 Evidenca 84 & 85)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimiit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në RVB dhe në dokumentet e DVV-s nuk rezulton që në Institucion të përdoret ndonjë metodë vlerësimi elektronik si psh CleanScore. Një komponent kyc në lidhje me këtë kriter vlerësimi është sistemi i plagjiaturës "Turnitin", platforma më e madhe e plagjiaturës dhe identifikimin e përmbytjes së krijuar nga AI e kontraktuar nga UNYT. Turnitin bën kontrollin e plagjiaturës në mënyrë efektive në lidhje me përmbytjen joorigjinale që studentët mund të kenë ngarkuar si detyrë. Ky sistem dekurajon praktika e pandershme, dhe promovon kulturën e përgjegjësisë akademike dhe transparencës. Referencë: <i>Rregullore AI (Aneksi 3.13 Evidenca 115)</i> <i>Kontrata e shërbimit TURNITIN (Aneksi 3.3 Evidenca 104)</i> <i>Shembuj përdorimi TURNITIN Aneksi 3.3.1 Evidenca 105)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga diskutimet me stafin akademik të angazhuar në PIND në UNYT dhe me studentët e këtij programi, u konfirmua që vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhej në përputhje me syllabus-in e lëndës, dhe këto të fundit (nga analiza e kryer nga GVJ) janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Referencë: <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është	Bazuar në Rregulloret e evdientuara në DVV, GVJ nuk gjeti ndonjë rregullim të posacëm në lidhje me detyrimin e Komisionit të vlerësimit për të dhënë komete apo feedback për vlerësimin. Në Procedurën e Provimeve (neni 11)

i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	parashikohet që “instruktorët e kursit duhet të dorëzojnë notat përfundimtare, përfshirë provimin afatmesëm, provimin përfundimtar, pjesëmarrjen bredna klasës dhe përbërësit e tjerë pranë Zyrës së Regjistrimeve. Notat përfundimtare duhet të dorëzohen në përputhje me systemin e vlerësimit të UNYT-s sic është aprovuar nga Senati. Zyra e Regjistrimeve mban dokumentet e provimit përfundimtar në kopje elektronike dhe të arkivuar në përputhje me Rregulloren e UNYT-s për Arkivin. Të pyetur gjatë vizitës, stafi akademik dhe studentët e programit të studimit konfirmuan këto modalitete të vlerësimit të njohurive të cilat parashikohen në rregulloren përkatëse. Referencë: <i>Procedura e Provimit (Aneksi 3.17 Evidenca 120)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në Procedurën e Provimeve (neni 11) parashikohet se, “Asnjë telefon celular ose pajisje tjetër elektronike nuk lejohet në sallën e provimit (pika 12). Po ashtu asnjë procedurë mashtruese në cdo kohë dhe në cdo rrethanë është e palejueshme. Instruktori i kursit është përgjegjës të sigurojë që procedura e provimit të jetë e pakorruptueshme, dhe të zbatojë rregulloret e Universitetit për ata që mund të përpiqen të shkelin ndërshtëmërinë akademike (pika 14)” Në lidhje me plagjiaturën, UNYT ka lidhur një kontratë shërbimi për systemin antiplagjiaturë “Turnitin”, platforma më e madhe e plagjiaturës dhe identifikimin e përmbajtjes së krijuar nga AI Turnitin bën kontrollin e plagjiaturës në mënyrë efektive në lidhje me përmbajtjen joorigjinale që studentët mund të kenë ngarkuar si detyrë. Ky sistem dekurajon praktika e pandershme, dhe promovon kulturën e përgjegjësisë akademike dhe transparencës. Gjithashtu, në Rregulloren e UNYT-s (neni 73) është parashikuar se “kopjimi, plagjiatura apo paraqitja si punë e vet e punës së një tjetri” të konsiderohen së përbëjnë shkelje të etikës së Universitetit dhe ndaj tyre ndiqn procedura disiplinore me synimin e parandalimit të cdo shkelje. Vendimet e masave disiplinore merrem me Vendim të Këshillit të Etikës. Referencë:

	<i>Rregullore AI (Aneksi 3.13 Evidenca 115)</i> <i>Kontrata e shërbimit TURNITIN (Aneksi 3.3 Evidenca 104)</i> <i>Shembuj përdorimi TURNITIN Aneksi 3.3.1 Evidenca 105)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në rregulloren e PIND dhe Procedurën e Provimeve, provimet janë me shkrim. Rezultatet e provimit duhet të shpallen dhe dorëzohen në zyrën e Regjistrimeve nga instruktori i kursit brenda 5 (pesë) ditësh nga data e provimit. Nga vizita në Institucion, si studentët ashtu edhe stafi akademik pohuan që afati 5 ditor është zbatuar lehtësisht në cdo rast dhe nuk pasur asnjëherë vonesa. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11. Evidenca 21)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në Rregulloren e FDSHS (neni 25) dhe në Rregulloren e PIND (neni 45) parashikohet qartësisht e drejta e studentit për të apeluar rezultatet e provimit. Sipas këtyre dispozitave, nëse studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin përfundimtar ose studenti konsideron se provimi nuk është zhvilluar në përputhje me Ligjin për Arsmin e Lartë dhe/ose Statutin e UNYT-s, ose Programin mësimor, atëherë studenti ka të drejtë të paraqesë kundërshtimin me shkrim për rezultatin e provimit dhe ta adresojë atë pranë Zyrës së Çështjeve Studentore brenda 48 orëve nga shpallja e rezultatit. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11. Evidenca 21)</i> <i>Rregullore e FDSHS (Aneksi 1.8 Evidenca 18)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e	Në Rregulloren e FDSHS dhe atë të PIND parashikohet qartësisht, jo vetëm e drejta e kundërshtimit të rezultatit të provimit, por edhe procedura që duhet të ndiqet për të adresuar ankimin e studentit. Kështu, në bazë të nenit 45 të Rregullores së PIND dhe të nenit 25 të Rregullores së FDSHS-s parashikohet se: Zyra e Çështjeve Studentore ia përcjell ankesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës brenda 48

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	orëve. Nëse Përgjegjësi i Departamentit konsideron se janë përmbushur kushtet e nevojshme atëherë ai/ajo do t'i kërkojë personelit përkatës akademik të rivlerësojë provimin. Vendimi i Kryetarit të Departamentit dhe rivlerësimi i profesorit duhet të përfundojë brenda 48 orëve. Nëse studenti nuk është i kënaqur me rezultatin e rivlerësimit të provimit ai/ajo ka të drejtë të kërkojë të kontrollohet nga një komitet <i>ad hoc</i>. Komiteti <i>ad hoc</i> përfshin stafin akademik nga e njëjta fushë shkencore ose e ngjashme e kursit. Studenti duhet t'i drejtohet Dekanatit të Fakultetit me një kërkesë me shkrim në mënyrë që të mbledhet komiteti <i>ad hoc</i>, brenda 24 orëve. Dekani i Fakultetit do të japë vendimin e komitetit brenda 3 ditëve të punës. Studenti do të marrë notën përfundimtare sic vendoset me vendimin e komitetit <i>ad hoc</i> pa të drejtë ankese të mëtejshme.” Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11. Evidenca 21)</i> <i>Rregullore e FDSHS-s (Aneksi 1.8 Evidenca 18)</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>Në PIND procedura e organizimit të provimeve dhe e vlerësimit të njohurive të studentëve është e rregulluar dhe zbatohet në përputhje me çfarë është parashikuar në rregulloret institucionale.</i> <i>Studentët informohen në lidhje me vlerësimin e tyre dhe mangësitë që kanë sjellë rezultatin përkatës dhe kanë të drejtën të ankimojnë jo vetëm vlerësimin përfundimtar por edhe procedurën e kryerjes së provimit.</i> <i>Procedura e ankimit të vlerësimit është e parashikuar në rregullore dhe ndiqet në tërësi. Në përfundim të procedurës, dokumentacioni arkivohet në sekretarinë mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.4


Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Sipas Rregullores së PIND (<i>neni 6</i>), pas diplomimit studentët do të kenë fituar njohuritë e mëposhtme: • Të demonstrojnë të kuptuarit e çështjeve lëndore dhe objektivave në lidhje me shkanecat juridike; • Të kenë një formim të plotë • Të jenë në gjëndje të zbatojnë teorinë në mënyrë kritike dhe analitike në çështjet juridike reale; • Të integrojnë njohuritë e marra në program për të analizuar në çështje ligjore; • Të jetë në gjëndje të hartojë dhe zhvillojë një çështje, mbrojtje ligjore; • Të ndjek studimet pasuniversitare në fushën e shkencave juridike. Dhe të kenë marrë aftësitë dhe vlerat e mëposhtme: • Aftësi e shkëlqyer komunikimi me shkrim dhe me gojë që tregon aftësi të menduarit analitik dhe kritik të domosdoshëm për të marrë vendime të sakta juridike. • Aftësi komunikuese; • Shkathësi numerike dhe sasiorë përfshirë interpretimin e analizës së të dhënave • Dije dhe ndjeshmëri ndaj diversitetit global • Vetë-menaxhin efektiv • Aftësi për fleksibilitet • Përdorim efektiv të teknologjisë. Duke konsultuar planet mësimore dhe syllabuset, GVJ vlerëson se temat e përshfshira në to janë të vecanta dhe mbulojnë fusha konkrete të së drejtës, duke mundësuar aftësimin e studentëve në fusha specifike. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11. Evidenca 21)</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>Syllabuset e programit të studimit (Aneks 1.6, Evidenca 15)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Ky program studimi nuk garanton zhvillimin e aftësive të vecanta në fushën e teknologjisë dhe informacionit. Ndërsa për aftësitë e tjera të kërkuara në këtë kriter (aftësi në fushën humane, sociale, komunikimi dhe ndërveprimi), GVJ gjykon se

informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	disa prej tyre (p.sh, komunikimi) mund të përftohen në mënyrë indirekte nga përgatitja dhe prezantimi i detyrave të kursit që nxisin punën në grup, dhe përmirësimin e komunikimit profesional dhe ndërveprimit në komunitet. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11. Evidenca 21)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Misioni i programit është, që në përfundim të programit, studenti të aftësohet për t'u punësuar në sektorin publik, privat ose si i vetëpunësuar. Njohuritë që ofrohen nga ky program krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike për të mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Kurrikula e ofruar jo vetëm që optimizon njohuritë, por dhe krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me vecoritë që kërkon tregu specifik i juristëve. (<i>Rregullore PIND</i>) Në përputhje me Rregulloren e PIND dhe sic parashikohet edhe në syllabuset përkatëse, java e fundit e semestrit dedikohet për të bërë një përmbledhje të njohurive të shpjeguara përgjatë semestrit. GVJ u informua nga studentët e programit të studimit se kjo përmbledhje e njohurive e kërkuar nga ky kriter, zbatohej me rigozitet dhe ishte tejte e nevojshme për ta. Gjatë përmbledhjes dhe përsëritjes së njohurive kyce, pedagogët japin informacion në lidhje me detyrimet përmbyllëse të lëndës dhe studentët kanë të drejtë të pyesin dhe të sqarohen në lidhje me paqartësi të fundit që mund të kenë. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11. Evidenca 21)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli	Rregullorja e PIND parashikon si forma kryesore të mësimdhënies: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, studim i çështjeve gjyqësore, projekte, etj. Gjatë diskutimeve me stafin e angazhuar në programin e studimit, GVJ krijoi përshtypjen se ata ishin të angazhuar që të realizonin një proces mësimor serioz dhe të orientuar nga përfitimi i kompetencave në favor të studentëve.

akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Përdorimi i burimeve logjistike të Institucionit, si laboratorët dhe bibliotekat (fizike dhe online) ishin instrumente që stafi i përdorte për të nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve. Puna në grup mbështetej dhe inkurajohej. Metodat interaktive të mësimdhënies përdoren gjerësisht nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi. Pedagogët bëjnë përpjekjen maksimale të përdorin leksione të zgjeruara, pyetje dhe diskutime, shkrimin në klasë, debate, mësimdhënie të bazuara në kompjutera, etj. Referencë: <i>Rregullore e PIND (Aneksi 1.11. Evidenca 21)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në DVV institucioni ka prezantuar një listë të gjatë me aktivitete shkencore, ku vendin kryesor e zënë leksionet e hapura (<i>jashtë strukturës mësimore</i>). Vihet re që në këto leksione të hapura lektorët janë kryesisht jo personel akademik efektiv apo me kontratë me Institucionin. Këta të fundit konfirmuan gjatë vizitës në institucion që kanë qenë gjithnjë pjesëmarrës në këto leksione të hapura dhe se periodikisht organizojnë tavolina të rrumbullakta, debate dhe orë të hapura që drejtohen prej tyre. Referencë: <i>Aktivitete të Departamentit të Drejtësisë (Aneksi 1.14, Evidenca 26)</i> <i>CV e stafit akademik (Aneksi 1.28, Evidenca 44)</i> <i>Shtyllat e kërkimit shkencorë (Aneksi 2.18, Evidencë 94)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UNYT ofon mbështetje financiare për kërkimin shkencor dhe botimet akademike të stafit akademik. Rregullorja e Zyrës së Kërkimit Shkencore, përcakton rregull në këtë fushë dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe në funksion të procesit mësimor. Referencë:




	<i>Forma e mbështetjes financiare për stafin akademik (Aneksi 3.24, Evidenca 131)</i>			
Konkluzione	<i>PIND garanton rritjen e aftësive krijuese tek studentët dhe mësimdhënia në këtë program kryhet në bazë të kompetencave dhe në mënyrë interaktive. Personeli akademik nxit punën në grup dhe aftësitë shkencore dhe kërkimore tek studentët e programit.</i> <i>Stafi angazhon lektorë të ftuar (nga jashtë institucionit) që ndajnë eksperiencat e tyre në fusha të ndryshme të së drejtës (pa u kufizuar vetëm në të drejtë civile dhe tregtare). Në të gjithë procesin, studentët nxiten dhe inkurajohen të bëhen pjesë e procesit cilësor didaktik dhe shkencor. Ky program studim, për vetë matyrën që ka, nuk garanton zhvillimin e aftësive të vecanta në fushën e teknologjisë dhe informacionit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Sipas kurrikulës së programit, si detyrim përmbyllës i studimeve për PIND parashikohet punimi i diplomës i cili vlerësohet me 12 ECTS dhe të gjithë studentët kanë të drejtë të mbrojnë temë diplome, pavarësisht mesatares. Në RVB në lidhje me plotësimin e këtij kriteri është referuar një Rregullore e Projektit të Diplomimit, që <i>de facto</i> është një "Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës". Ky dokument është i rëndësishëm për përgatitjen e temës nga studentët dhe asistimin e tyre nga profesorët udhëheqës, por në të, nuk gjenden elementë të tillë si (a) mënyra e mbrojtjes së diplomës; (b) mënyra e vlerësimit të Komisionit; (c) lëshimi i diplomës dhe suplementi përkatës etj. Rregullorja e PIND (neni 30) parashikon se "Për të regjistruar Projektin e Diplomimit, për PIND, studenti duhet të marrë së

	paku 234 ECTS studentët e në këtë program studimi diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Projekti i diplomimit është i detyrueshëm të regjistrohet si kurs i rregullt. Referuar RVB (por pa u mbështetur në ndonjë dokument në DVV), UNYT ka hartuar një dokument politikash që rregullon procedurën e lëshimit të diplomave, si dhe mënyrën e dorëzimit të tyre tek studentët. Kjo procedurë është e strukturuar në pesë faza: 1. Identifikimi i studentëve kandidat për t'u diplomuar - përcaktimi i studentëve që kanë përfunduar të gjitha kërkesat akademike për diplomim; 2. Miratimi institucional i "Statusit të të Diplomuarve" – Procedura për miratimin e statusit të të diplomuarve nga autoritetet përkatëse të institucionit; 3. Lëshimi i Diplomës, Listës zyrtare të notave dhe Shtojcës së Diplomës – Përgatitja dhe lëshimi i dokumenteve zyrtare që vërtetojnë përfundimin e studimeve; 4. Dorëzimi i Diplomës, Listës zyrtare të notave dhe Shtojcës së Diplomës tek të diplomuarit – Procesi i dorëzimit të dokumenteve përfundimtare tek studentët përkatës; 5. Arkivimi dhe Rikthimi në Arkivë i Diplomave. Listave zyrtare të Notave dhe Shtojcës së Diplomës të të Diplomuarve. – Sigurimi i ruajtjes dhe arkivimit të të gjitha dokumenteve për qëllime administrative dhe të ardhshme; <u>GVJ sugjeron që Departamenti i Drejtësisë të miratojë një Udhëzues të detajuar në lidhje me procedurën e diplomimit.</u> Referencë: <i>Rregullore e Projektit të Diplomimit (Aneksi 3.25 Evidenca 132)</i> <i>Rregullore PIND (Aneksi 1.11 Evidenca 20)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe	Sipas Rregullores së PIND (neni 29), cdo studenti i cmërohet një Këshilltar i Projektit të Diplomimit. Angazhimet dhe notat në drejtim të Projektit të Diplomimit përcaktohen nga Këshilli

materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	i Projektit të Diplomimit sipas plan-programit në fillim të semestrit. Sipas bisedës me pedagogë dhe studentë në ditën e vizitës në institucion, Departamenti brenda një muaji nga dita e fillimit të semestrit të parë të vitit të fundit u bën të njohur studentëve të vitit të fundit temat e diplomave. Cdo departament përcakton procedurat që duhet të ndiqen për përcaktimin e ndarjes së temave të diplomave, si dhe për informimin e studentëve. Personeli akademik i ngarkuar me udhëheqjen e studentit është në kontakt të vazhdueshëm me studentin dhe e asiston atë jo vetëm me udhëzime, por edhe me materiale konkrete orientuese, të cilat ata vetë i siguronin nga libraritë elektronike. Studentët e intervistuar në Institucion, që ishin në proces përgatitje të temës së diplomës ishin tejet të kenaqur dhe falenderues për asistencën që u jepej nga stafi akademik dhe personeli administrative i fakultetit (si psh punonjësi i bibliotekës). Referencë: <i>Rregullore PIND (Aneksi 1.11, Evidenca 21)</i> <i>Rregullore e Projektit të Diplomimit (Aneksi 3.25, Evidenca 132)</i> <i>Formati i Diplomës (Aneksi 3.26, Evidenca 133)</i> <i>Forma e aplikimit për temë diplome (Aneksi 3.27 Evidenca 134)</i> <i>Email udhëzues (Aneksi 3.28, Evidenca 135)</i> <i>Vizitë në Institucion</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi sepse sipas kurrikulës së programit, si detyrim përmbyllës i PIND parashikohet punimi i diplomës.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i	Bazuar në bisedat me stafin akademik dhe studentët, roli i udhëheqësit është kryesisht drejtues, këshillues dhe konsultues.

diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Rekomandimet e tij janë të rëndësishme vecanërisht për përcaktimin e një strukture të temës, nxjerrjen e grupçështjeve, trajtimin e problematikave teoriko-praktike, rekomandimine literaturës, sugjerimin e mënyrave efikase të shfrytëzimit të literaturës, përcaktimine afateve të punës etj. Realizimi i disa seancave metodologjike, të cilat janë orë në auditor, që realizohen nga udhëheqësi i temës dhe kanë për qëllim që të ndihmojnë studentët që të përpunojë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin e temës së diplomës. Orët e senacave metodologjike duhet të trajtojnë çështje të tilla si: (i) Përcaktimi shkencor i objektit të marrënë shqyrtim; (ii) sqarimi i dobësisë praktike të punimit; (iii) përzgjedhja e problematikës dhe tematikës që do të trajtohet; (iv) përcaktimi i terreneve empirike të studimit; (vi) ndërtimi i hipotezave dhe verifikimi i tyre; (vii) trajtimi i anëve metodologjike si dhe i metodës së anketimit dhe intervistimit; (viii) ndërtimi i strukturës së punimit; (ix) përpilimi dhe debatimi i materialit bibliografik; (x) përpunimi i metodave të paraqitjes sasiore (<i>diagrame, kurba etj</i>) cilësore ose mikes; (xii) hartimi i materialit prezantues para komisionit (xiii) debatimi i përfundimeve të studimit. Referencë: <i>Rregullore PIND (Aneksi 1.11, Evidenca 21)</i> <i>Rregullore e Projektit të Diplomimit (Aneksi 3.25, Evidenca 132)</i> <i>Formati i Diplomës (Aneksi 3.26, Evidenca 133)</i> <i>Forma e aplikimit për temë diplome (Aneksi 3.27 Evidenca 134)</i> <i>Email udhëzues (Abeksi 3.28, Evidenca 135)</i> <i>Vizitë në Institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	N / A

Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar në Rregulloren e PIND, studenti në çdo rast e mbron diplomën përpara një Komisioni, i cili caktohet me Urdhër të Dekanit. Në vlerësimin përfundimtar komisioni merr në konsideratë edhe vlerësimet me shkrim të udhëheqësit dhe oponentit. Temat e diplomave merren në shqyrtim nëse ato janë të pranuar dhe nënshkruara nga udhëheqësi i punimit dhe studenti. Në përfundim të mbrojtjes së temës, Komisioni me detyrë të mbullura, mer vendim, sipas mesatares së pikëve të secilit anëtar të Komisionit. Vlerësimi jepet me notë dhe ia komunikon studentit. Referencë: <i>Rregullore PIND (Aneksi 1.11, Evidenca 21)</i> <i>Rregullore e Projektit të Diplomimit (Aneksi 3.25, Evidenca 132)</i> <i>Formati i Diplomës (Aneksi 3.26, Evidenca 133)</i> <i>Forma e aplikimit për temë diplome (Aneksi 3.27 Evidenca 134)</i> <i>Email udhëzues (Aneksi 3.28, Evidenca 135)</i> <i>Vizitë në Institucion</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Neni 70 i Rregullores së UNYT-s (<i>Pajisja me Diplomë</i>), ndër të tjera parashikon se “Institucioni pajis studentët e diplomuar në Ciklin e parë dhe të Ciklin e Dytë me Suplementin e Diplomës. Ky dokument përgatitet edhe në njërën prej gjuhëve kryesore evropiane. Suplementi i Diplomës përshkruan fushën dhe nivelin e studimeve, qëllimin dhe fushën e zbatimit të dijeve, listën e lëndëve me orët në auditor dhe me kreditet e vlerësimet përkatëse. Përmbajtja, formati dhe regjistrimi i diplomave dhe suplementit rregullohen përmes akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara nga ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin, rregulloret dhe politikat e krijuara nga Bordi i Adminsitritimit dhe përcaktimeve që rrjedhin nga detyrimet marrëveshjeve të programeve të përbashkëta. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit, dhe evidentohet në regjistrin përkatës. Nëse prania e të diplomuarit është objektivist e pamundur, tërheqjen mund ta bëjë një nga pjestarët e familjes, i pajisur me prokurë të posacme të noteriazuar dhe me dokument identifikimi. Në qoftë se diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheqë atë dhe të kërkojë pajisjen

	me diplomë të rregullt. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremony. Në qoftë se origjinali i diplomës humbet ose dëmtohet deri në atë masë sa të bëhet i papërdorshëm, UNYT nuk lëshon dublikatë. Institucioni mund të japë vetëm një vërtetim të shoqëruar me listën e krediteve dhe notave të fituara. Vërtetimi është i njëvlershëm me diplomën pasi të jetë nënshkruar nga Rektori, Dekani i Fakultetit dhe Sekretaria Mësimore dhe nënshkrimet e tyre të jenë vërtetuar me vulën e UNYT-s. Pas përfundimit me sukses të mbrojtjes së diplomës dhe shpalljes së rezultateve, studenti ka të drejtë të pajiset me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar. Sipas nenit 50 të Rregullores së PIND, "Për të lëshuar një diplomë, studenti duhet: a. Të plotësojë formularin e DIMPLOMIMIT; b. Të ketë leje nga zyra e Bibliotekës, IT dhe Financave; Duhet të kthejë në Zyrën e Regjistrimit Formën e Nënshkruar (firmosur nga Këshilluesi, Kryetari I Programit dhe Dekani i Fakultetit); DIPLOMA e nënshkruar nga Dekani dhe Rektori, që do të lëshohet, konsiderohet e mbyllur dhe e përfunduar. Nga tërësia e materialeve të konsultuara në përmbushje të këtij kriteri nuk rezulton që studentit t'i vihet në dispozicion pa kërkesë të tij një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit, por sic del nga RVB dhe u konfirmua nga personeli akademik gjatë vizitës në institucion, me kërkesë të studentit atij i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. Referencë: <i>Rregullore e Projektit të Diplomimit (Aneksi 3.25, Evidenca 132)</i> <i>Rregullore e Arkivës (Aneksi 5.31, Evidenca 231)</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti	Bazuar në statutin e UNYT-s, cdo formë diploma dhe certifikate, përpara se të lëshohet nga institucioni, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.

informacione për studentin nëse kërkohen.	Sipas RVB dhe nga vizita në institucion rezulton se, sekretaria mësimore mban në mënyrë të rregullt informacionet për studentët si të dhëna të përgjithshme në lidhje me ta që nga momenti i fillimit të studimeve si formularët e regjistrimit, kopje e dokumentit ID, kontrata e lidhur me studentët, ashtu edhe evidenca gjatë studimeve si evidencat për vlerësimet dhe notat, etj. Bazuar në nenin 54 të Rregullores së PIND (duplikimi i diplomës), në rast të humbjes së diplomës, studenti duhet të kërkojë me shkrim lëshimin e dokumenteve zyrtare për të zëvendësuar diplomën e humbur. Do të lëshohet diploma e DUPLIKUAR ose certifikatë DIPLOMIMI dhe një fjalë „Duplikuar“ do të shkruhet në Diplomë; Diploma e duplikuar lejohet VETËM një herë. Certifikata e Diplomimit jepet me kërkesë me shkrim. Tarifat për lëshimin e diplomës së kopjuar ose Certifikatën e Diplomimit propozohen nga Rektorati dhe aprovohen nga Bordi i Administrimit. Sipas nenit 63 (4) të Rregullores së UNYT-s, „Regjistri i diplomave dhe certifikatave administrohet nga Zyra e Procesverbaleve dhe ruan dëshmitë e të gjitha diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga UNYT dhe tërhejen e tyre nga studentët.“ Referencë: <i>Statuti i UNYT-s (Aneksi 1.2.1, Evidenca 10)</i> <i>Vizita në institucion</i> <i>RVB (Evidenca 5)</i>
Konkluzione	<i>Sipas kurrikulës së PIND, si detyrim përmbyllës i studimeve parashikohet punimi i diplomës. Punimi i diplomës është individual dhe punohet në udhëheqjen shkencore të një pedagogu me eksperiencë dhe gradë shkencore.</i> <i>Gjatë punës, studenti këshillohet dhe asistohet nga pedagogu udhëheqës. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë “Program i integruar 5-vjecar “Master i shkencave në Drejtësi” si edhe me suplementin e diplomës. Bazuar në këto elemente që u verifikuan edhe për shkallën e realizimit të tyre gjatë vizitës në Institucion, GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i>

Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N / A
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e	N / A




trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit,	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin me tituj akademikë e grada shkencore duke përmbushur kërkesat ligjore dhe pritshmëritë e cilësisë akademike. Po aq e rëndësishme, stafi akademik në këtë program studimi angazhohet në proceset e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe gjithë elementeve të tjerë të programit të studimit. Bazuar në të dhënat tabelore të dërguara nga IAL pas vizitës në institucion, rezultojnë se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit është si më poshtë: 1. Për vitin akademik 2020-2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 11 pedagogë, nga të cilët 8 PAE dhe 3 PAK;

natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

2. Për vitin akademik 2021-2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 17 pedagogë, nga të cilët 11 PAE dhe 6 PAK;
3. Për vitin akademik 2022-2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 19 pedagogë, nga të cilët 12 PAE dhe 7 PAK;
4. Për vitin akademik 2023-2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 22 pedagogë, nga të cilët 13 PAE dhe 9 PAK;
5. Për vitin akademik 2024-2025 në këtë program studimi janë angazhuar 20 pedagogë, nga të cilët 13 PAE dhe 7 PAK.

Tituj/ grada	2020- 2021		2021- 2022		2022- 2023		2023- 2024		2024- 2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-	2	-	3	-
Prof. Asoc.	2	2	1	2	1	3	1	2	2	3
Dr./PhD	2	-	6	2	6	2	5	4	4	2
Msc.	4	1	4	2	5	2	5	3	4	2
Totali	8	3	11	6	12	7	13	9	13	7

Referuar këtyre të dhënave, del në pah që në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc (PI) në Drejtësi, është angazhuar edhe staf akademik me Msc, ndryshe nga sa parashikohet në nenin 59/6 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet: "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës".

GVJ konstaton se në periudhën 2020 – 2024, 30.% – 45 % e stafit mësimdhënës në këtë program studimi kanë qenë me Msc.

Për rrjedhojë, GVJ sugjeron që institucioni të marrë masat e nevojshme për të angazhuar në këtë program studimi staf akademik me kualifikimin "Doktor Shkencash" sikundër normohet në aktet ligjore në fuqi në fushën e arsimit të lartë.

	GVJ vëren se fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik kanë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ata mbulojnë. Përvoja akademike ndërthuret mirë edhe me atë profesionale duke e shtuar gamën e informacionit që ofrohet për studentin. Referencë: <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse": Tabela 6; Tabela 12;</i> <i>Evidenca 1.28 "CV-të e stafit akademik";</i> <i>Evidenca 1.5 "Plani mësimor i programit Msc në Drejtësi".</i>																									
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultojnë se programi i studimit, objekt vlerësimi, është organizuar në leksione, praktika, seminare, praktika profesionale, punimi i diplomës dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor, me ngarkesën përkatëse në kredite ECTS. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në kredite (në %) për veprimtaritë formuese është konceptuar duke respektuar parashikimet e VKM nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar. Sipas të dhënave të sjella nga IAL si dhe vizita e kryer në institucion, raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) për katër vitet e fundit PAE/PAK është si më poshtë: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>525</td><td>360</td><td>165</td><td>68% / 32%</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>930</td><td>655</td><td>275</td><td>70%/30%</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>2963</td><td>2551</td><td>412</td><td>86 % / 14 %</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>3097</td><td>2588</td><td>509</td><td>83 % / 17%</td></tr></table>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2020-2021	525	360	165	68% / 32%	2021-2022	930	655	275	70%/30%	2023-2024	2963	2551	412	86 % / 14 %	2024-2025	3097	2588	509	83 % / 17%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																						
2020-2021	525	360	165	68% / 32%																						
2021-2022	930	655	275	70%/30%																						
2023-2024	2963	2551	412	86 % / 14 %																						
2024-2025	3097	2588	509	83 % / 17%																						
	Për sa më sipër konstatohet se dy vitet e para të funksionimit të programit mbulimi i ngarkesës së orëve në auditor ka qënë në																									

	limitet e mbulimit nga stafi akademik efektiv, kjo gjë është përmirësuar vitet në vijim. Referencë: <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse": Tabela 12.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar vërehet se pjesa dërrmuese e lëndëve të programit mbulohet nga personeli akademik i brendshëm, çka garanton qëndrueshmërinë dhe kualifikimin e këtij personeli për të gjithë periudhën e akreditimit. Po ashtu, konstatohet se dhe një pjesë e stafit akademik me kohë të pjesshme, ka pasur marrëdhënie konstante për angazhimin në mësimdhënie për këtë program, sipas fushave të tyre të ekspertizës. Midis IAL dhe anëtarëve të veçantë të personelit akademik janë lidhur kontratat përkatëse të punësimit. Për secilin prej tyre janë bërë rregullisht deklaratimet lidhur me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, gjë që u konfirmua gjatë vizitës në institucion, në takimin me përfaqësuesit e zyrës së burimeve njerëzore. Referencë: <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse": Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës;</i> <i>Evidenca 4.28 "Kontratë pune me kohë të plotë me afat të pacaktuar";</i> <i>Evidenca 4.28.1 "Kontratë pune me kohë të pjesshme";</i> <i>Evidenca 4.28.2 "Kontratë pune me kohë të plotë me afat të përcaktuar";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York".</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,	Procesi i rekrutimit fillon me identifikimin e nevojës për personel akademik nga njëzia bazë e UNYT, ku përcaktohen kriteret e përgjithshme e ato specifike, si dhe fushëveprimi dhe lëndët që kërkohet nga personel akademik. Ky dokumentacion i përcillet Rektoratit për miratim, procedurë e cila pasohet nga publikimi i njoftimit me përshkrimin e punës dhe cilësive që kërkohen në faqen zyrtare të IAL dhe në mediat përkatëse, me qëllimin për të hapur konkursin publik dhe ndjekur procedurat e përzgjedhjes së personelit akademik.

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Komisioni i rekrutimit përbëhet nga rektori, përgjegjësi i departamentit, dekani, një anëtar i stafit akademik dhe nga zyra e Burimeve Njerëzore. Ai shqyrton aplikimet, vlerëson dokumentacionin shoqërues si dhe përgatit listën me renditjen e kandidatëve në përputhje me nivelin e tyre të kualifikimit. Intervista zhvillohet në bazë të listave të përgatitura dhe në përfundim të saj, anëtarët e komisionit të rekrutimit paraqesin vlerësimet e tyre duke renditur kandidatët sipas vlerësimeve të bëra. Në vijim, vazhdohet me lidhjen e marrëveshjes me kandidatin fitues. Në aktet e brendshme rregullatore të këtij IAL janë përcaktuar gjithashtu kriteret e rekrutimit për personelin akademik me kohë të pjesshme si edhe për personelin ndihmës-akademik dhe administrativ. Personeli akademik gëzon status dhe trajtim specifik në përputhje me VKM nr. 329, datë 12.4.2017 "Per statusin dhe trajtimin e personelit akademik". Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", kapitulli V;</i> <i>Evidenca 1.7 "Rregullore Universiteti", nenet 52-23;</i> <i>Evidenca 4.25 "Format i shpalljes së pozicionit";</i> <i>Evidenca 4.25.1 "Format standard i procedurës së rekrutimit";</i> https://unytold.unyt.edu.al/index.php/job-vacancies-work-with-us/; <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore.</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ vëren se ky program studimi nuk ka orë laboratorike e laboratorë të dedikuar, pasi ka natyrë teorike dhe jo aplikative. Në këtë kuptim, në tërësinë e tij kriteri 5 nuk gjen shumë hapësirë për zbatim e nuk ka peshë specifike si kriteret e tjera të fushës IV.1. UNYT ka në dispozicion edhe personel ndihmës mësimor-shkencor, i cili angazhohet në detyrat administrative të përgjithshme për realizimin e orëve mësimore parashikuar në syllabuse dhe mirëmbajtjen e mjediseve ku zhvillohen këto orë mësimore. Gjatë vizitës së GVJ, personeli i bibliotekës dhe stafi administrativ i institucionit tregoi gjithë angazhimin e duhur për të siguruar burimet e të dhënave, përdorimin e bibliotekës online, etj.

	Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", nenet 47-48;</i> <i>Evidenca 4.3 "Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse-Politika dhe Procedura";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York".</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Të dhënat e personelit akademik, të dokumentuara në dosjet e administruara për këtë qëllim, të angazhuar në programin e studimit, mbahen dhe administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore, në formën e dosjes për secilin anëtar. Njësia bazë që ofron këtë program studimi si dhe institucioni, mbajnë të dhënat mbi ngarkesën mesimdhënëse të secilit pedagog të angazhuar në programin e studimit, si dhe detyrat dhe funksionet e tjera akademike dhe administrative brenda UNYT. Përfaqësuesi i zyrës së Burimeve Njerëzore ka vënë në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Nga dokumentet e administruar në dosje u vu re që ishin në përputhje me llojet e dokumenteve të përcaktuar në aktet e brendshme rregulluese. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", neni 54;</i> <i>Evidenca 1.7 "Rregullore universiteti", neni 48;</i> <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse": Tabela 1, Tabela 2, Tabela 4, Tabela 6, Tabela 7, Tabela 8, Tabela 12;</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të	Departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për mbikëqyrjen e praktikës, e cila zhvillohet në institucione me të cilët UNYT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Praktika profesionale është përfshirë si lëndë më vete në këtë program nën emërtimin "Internship". E njëjta praktikë ndiqet edhe për udhëheqjen e diplomës për të cilën angazhohet staf akademik me tituj dhe grada, pedagogë PAE. Drejtuesi i departamentit cakton një këshilltar për projektin e diplomës për secilin prej studentëve. Në këtë kuadër puna e studentëve drejtohet edhe nga Rregullorja e projektit të diplomimit.

tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Referencë: <i>Evidenca 1.11 "Rregullore programi e rishikuar 2025";</i> <i>Evidenca 2.6 "Listat e kompanive të praktikës profesionale";</i> <i>Evidenca 2.5.1 "Programi i lëndës Internship";</i> <i>Evidenca 3.25 "Rregullore e projektit të diplomimit".</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucioni, nëpërmjet njësisë bazë që ofron programin e studimit, ka lidhur marrëveshjet përkatëse me institucione publike dhe jopublike për kryerjen e praktikave profesionale si dhe ka caktuar mbikëqyrësit në ambientin pritës, të cilët ndihmojnë studentët për përmbushjen e detyrimeve gjatë periudhës së praktikës. Për ta bërë këtë proces sa më efikas dhe mbikëqyrjen efektive, mbikëqyrësit në fjalë kryejnë vlerësimin e praktikës profesionale, duke plotësuar një raport për këtë qëllim. Referencë: <i>Evidenca 2.5 "Format për internshipin";</i> <i>Evidenca 1.46 "Praktikë studenti Internshipi (Edit Merkaj)".</i>
Konkluzione	<i>Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, i përmbush kryesisht standardet sasiore përsa i përket nivelit të duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit.</i> <i><u>GVJ rekomandon</u> që institucioni duhet të marrë masat që në mësimdhënien e këtij program studimi të angazhohen vetëm staf akademik me kualifikimin "Doktor Shkencash" në përputhshmëri me aktet ligjore.</i> <i>Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë transparente, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi si dhe në aktet e posaçme rregullatore.</i> <i>Fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik janë në përputhje qoftë me programin e studimit, por edhe me lëndët specifike që ata mbulojnë.</i> <i>Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi</i>

	<i>studimi, përfshirë edhe instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës profesionale.</i> <i>Informacioni mbi funksionimin dhe organizimin e strukturave akademike dhe ndihmës-akademike administrohet në përputhje me kriteret ligjore dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Programi ka qasje të mjaftueshme në sallat dhe hapësirat për zhvillimin e procesit mësimor dhe akademik. Mësimdhënia për këtë program studimi realizohet në kampusin qendror, të gjendur në “Rrugën e Kavajës”, Tiranë, ku u zhvillua edhe vlerësimi dhe vizita e GVJ. Sipas të dhënave të administruara dhe të konfirmuara gjatë vizitës, institucioni në këtë kampus ka në dispozicion një sipërfaqe të përgjithshme prej 3643.33 m², i ndarë në një numër të mjaftueshëm ambientesh që përdoren si klasa leksioni/seminari, laboratorë, salla për konferenca, zyra për personelin akademik, mjedis për fotokopjime, për aktivitetet e qeverisë studentore, mjedise për stafin ndihmës-akademik e administrativ, etj. GVJ konstatoi një sipërfaqe të mjaftueshme në funksion të sallave për leksione, etj, në raport me numrin e studentëve, dhe të mjaftueshëm për zyra, sa i përket stafit. Biblioteka ka sipërfaqe totale 76 m². Ambientet në tërësi kanë një sistem të përshtatshëm ndriçimi, ajrimi dhe kondicionimi. Institucioni disponon sipërfaqe parkimi, ambiente çlodhëse për studentët dhe mjedise hidrosanitare, të pajisur me infrastrukturën e nevojshme. Nga vizita në institucion u konstatua se institucioni siguron aksesueshmëri infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuara. Për sigurimin dhe mirëmbajtjen në vijimësi të

	mjediseve në fjalë, institucioni ka miratuar dhe rregulloren përkatëse. Referencë: <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse", Tabela 16 dhe Tabela 17;</i> <i>Evidenca 4.12 "Sipërfaqja në funksion të mësimdhënies Main Campus";</i> <i>Evidenca shtesë "Seksioni E: Infrastruktura akademike në funksion të programit";</i> <i>Evidenca shtesë "Certifikatë për mbrojtjen nga zjarri";</i> <i>Evidenca shtesë "Akt miratim higjieno-sanitar";</i> <i>Evidenca shtesë "Operations department. Policies and procedures";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", vizita në institucion.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore janë të pajisur me mjetet e nevojshëm teknologjikë për zhvillimin normal dhe bashkëkohor të veprimtarisë mësimore. Përveç kompjuterëve të gjendur në klasat studimore, ka pajisje kompjuterike edhe në bibliotekë. Duke qenë që programi i studimit ka karakter teorik e jo aplikativ, nuk ka nevojë për shumë infrastrukturë teknologjike në dispozicion. Stafi akademik e zhvillon procesin mësimor duke përdorur mjetet audiovizive të instaluar në sallat mësimore. Këto mjete mund të aksesohen edhe nga studentët për realizimin sa më cilësor të prezantimeve të projekteve apo detyrave të kursit. Kjo veprimtari asistohet më së miri nga zyra e IT-së së universitetit. GVJ konstatoi se në godinë funksionon normalisht shërbimi i internetit <i>wireless</i>, i aksesueshëm nga studentët dhe nga stafi i institucionit. Referencë: <i>Evidenca 4.12.1 "Infrastruktura dhe aktivitete";</i> <i>Evidenca 4.17 "IT Shërbimet";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", vizita në institucion.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës	Hapësira kryesore ku studentët e programit të studimit realizojnë detyrat e kursit janë kryesisht biblioteka dhe sallat e leksioneve/seminareve. Këto hapësira janë të pajisura me

specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave formuese të programit të studimit. Ambientet konsiderohen të përshtatshëm për zhvillimin e leksioneve të hapura dhe për veprimtari të tjera të ngjashme. Referencë: <i>Evidenca 4.12.1 "Infrastruktura dhe aktivitete";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", vizita në institucion.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Programi i studimit në vlerësim nuk ka parashikuar orë laborator. IAL disponon 4 laboratorë informatike, të pajisur me programe profesionale si <i>McGraw Hill, Turnitin, Office 365, SPSS</i>, gjithashtu ka siguruar ambientin e nevojshëm për përdorimin e pajisjeve kompjuterike në sallën e bibliotekës, ku studentët kanë mundësinë që të kryejnë detyra e punime të ndryshme, duke shfrytëzuar programe profesionale, që lehtësojnë punën e tyre. Referencë: <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse": Tabela 16, Tabela 17;</i> <i>Evidenca 4.17 "IT Shërbimet";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York".</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore,	UNYT në përgjithësi ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore për zbatimin e marrëveshjeve bashkëpunuese me institucione dhe subjekte të tjera. Po ashtu, zotëron infrastrukturën akademike dhe hapësirat përkatëse për debate, tryeza, leksione të hapura, seminare, dhe takime të tjera të rëndësishme. Gjithsesi, sa u përket këtyre marrëveshjeve, <u>GVJ sugjeron lidhjen e marrëveshjeve të tjera sidomos me institucione të tillë si gjykata, prokuroria dhe institucione të tjerë të rëndësishëm në fushën e drejtësisë, ku mund të realizohen praktika të përshtatshme e që lidhen drejtpërdrejt me objektivat e këtij programi studimi.</u> Në këtë drejtim, gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se nuk ka një sallë apo një ambient tjetër të përshtatshëm, të destinuar për zhvillimin e gjyqeve imituese.

institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Referencë: <i>Evidenca 5.10 "Lista e MoU";</i> <i>Evidenca 2.6 "Lista e kompanive të praktikës profesionale";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", vizita në institucion.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon infrastrukturën, aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit në përputhje me natyrën dhe objektivat e tij.</i> <i>Në dispozicion të studentëve janë vendosur laboratorë dhe mjedise të përshtatshme për formimin praktik, në përshtatje me natyrën e programit të studimit.</i> <i>Mjediset e zhvillimit të procesit mësimor, zyrat dhe mjediset e tjera në funksion të procesit të mësimdhënies janë të pajisura me teknologjinë e informacionit, për realizimin me sukses të programit të studimit.</i> <i><u>GVJ sugjeron</u> që institucioni të krijojë një sallë për zhvillimin e gjyqeve imituese, e cila i shërben kryerjes së veprimtarive praktike për programin e integruar të studimeve në drejtësi.</i> <i><u>GVJ sugjeron</u> që institucioni të lidhë marrëveshje me institucione të tillë si gjykata, prokuroria dhe institucione të tjerë të rëndësishëm në fushën e drejtësisë, për kryerjen e praktikave, në dobi të plotësimit të objektivave të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të	E gjithë literatura bazë dhe ajo ndihmëse është vënë në dispozicion të studentëve si në formë fizike, ashtu dhe digjitale. Materialet kryesore mësimore të programit janë në gjuhën angleze, por edhe në gjuhën shqipe. Po ashtu ofrohet edhe

studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	mundësia për akses nga ana e studentëve e literaturës <i>online</i> dhe pa pagesë (<i>e-library</i>) duke i ofruar studentit mundësinë e shfrytëzimit të një databaze më të plotë, duke kombinuar literaturën bazë të detyrueshme dhe atë të rekomanduar, e cila përgatitet nga pedagogu i lëndës. Duke qenë se literatura e detyrueshme dhe që gjendet në qarkullim, për shkak të rrethanave që nuk varen nga stafi akademik, <i>është më e vjetër se pesë vitet e fundit</i>, konsiderohet e përshtatshme që të shfrytëzohen sa më shumë burime të tjerë, si artikuj në lëmin e së drejtës, të botuar në revista të pajisura me ISBN. Kjo, për arsye se pasurimi i vazhdueshëm i literaturës së vënë në dispozicion garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, si dhe kërkimin shkencor, të parashikuar për programin e studimit dhe, një kombinim më i mirë i literaturës bazë me atë të përditësuar të programit do të rriste më tej cilësinë e materialeve në dispozicion të studentëve. Referencë: <i>Evidenca 1.6 "Syllabuset e lëndëve";</i> <i>Evidenca 4.12.1 "Infrastruktura dhe aktivitete";</i> <i>Evidenca shtesë 1 "List of books MSc. in Law";</i> <i>Evidenca shtesë 2 "Literatura për Ligjin në gjuhën shqipe";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Çdo vit akademik, programi mësimor i nënshtrohet procesit të rishikimit me qëllim përmirësimin e përmbajtjes dhe cilësisë së tij. Ky proces përfshin në radhë të parë departamentet si njësitë bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit. Departamentet ndërmarrin nismën për rishikimin e kurrikulës dhe përditësimin e programeve të lëndëve. Më tej, vendimmarrja vijon në struktura të tjera. Titullarët e lëndëve çdo vit akademik reflektojnë ndryshime në programet e lëndëve në përshtatje me zhvillimet e reja të fushës që mbulon lënda. Në funksion të përditësimit të literaturës përdoren edhe artikuj shkencorë, vendime gjyqësore nga praktika e Gjykatës së Lartë apo Gjykatës Kushtetuese. Departamenti gjithashtu ka realizuar kërkesa për blerje nga biblioteka të literaturës mbështetëse për lëndët mësimore, me

	qëllim pasurimin e burimeve të literaturës. Materialet për përditësimin e literaturës në bibliotekën fizike janë vënë në dispozicion të GVJ gjatë vizitës së kryer në institucion. Referencë: <i>Evidenca 1.7 "Rregullore universiteti";</i> <i>Evidenca 1.9 "Rregullore departamenti";</i> <i>Evidenca shitesë 1 "List of books MSc. in Law";</i> <i>Evidenca shitesë 2 "Literatura për Ligjin në gjuhën shqipe";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takim me stafin akademik dhe takim me punonjësen e bibliotekës.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UNYT ka në shfrytëzim bibliotekën e tij, e cila përdoret si për punën kërkimore ashtu edhe për studimin. Biblioteka e gjendur në katin e katërt të kampusit qendror ka një numër prej 40 vendesh dhe një infrastrukturë që ofron akses si në materialin fizik ashtu edhe në atë <i>online</i>. Në kuadër të këtij programi studimi, biblioteka ka shtuar numrin e titujve të dedikuar në studimet e së drejtës. Gjatë vizitës që u krye në bibliotekë, GVJ konstatoi se ambienti në fjalë është plotësisht i aksesueshëm nga të gjithë studentët. Për të shfrytëzuar titujt fizikë, studentët regjistrohen nëpërmjet kartës së anëtarësimit. Biblioteka ka ambient të mjaftueshëm, me ndriçim, ajrim dhe sistem të përshtatshëm kondicionimi, e përshtatshme për të mundësuar orët studimore. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", neni 57;</i> <i>Evidenca 4.13 "Ambientet e bibliotekës";</i> <i>Evidenca shitesë "Biblioteka. Politika dhe procedurat";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takim me punonjësin e bibliotekës.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën	Literatura e gjendur në bibliotekë përbëhet në pjesën dërrmuese nga botime në gjuhën angleze, e ndjekur nga ata në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera, pavarësisht numrit jo të konsiderueshëm të studentëve që ndjekin këtë program studimi. Literatura e gjendur në bibliotekë, në gjuhën shqipe dhe të huaj,

shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	është e larmishme dhe përfshin burime të ndryshme, duke garantuar përmbushjen e objektivave të programit për studentët. Referencë: <i>Evidenca shtesë 1 "List of books MSc. in Law";</i> <i>Evidenca shtesë 2 "Literatura për Ligjin në gjuhën shqipe";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", takimi në bibliotekë.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë, përfshirë bibliotekat online, është pa pagesë. Studentët e këtij programi studimor kanë qasje të barabartë në bibliotekat online të fushës së studimit, siç janë <i>Emerald Insight</i>, <i>EBSCOhost</i>, <i>JSTORE</i>, <i>PROQUEST</i>, <i>APA</i>, <i>GALE</i>, <i>Sage</i>. GVJ kërkoi aksesimin në bibliotekat online dhe bazat e tjera të të dhënave, gjatë vizitës në institucion, gjë e cila rezultoi plotësisht e realizueshme, në përputhje me deklarin e bërë nga institucioni në RVB. Referencë: <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse", tabela 17;</i> <i>Evidenca shtesë "EBSCO Product Order Form";</i> <i>Evidenca shtesë "Emerald_service contract 2020-2021";</i> <i>Evidenca 4.13 "Ambientet e bibliotekës";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", takim me punonjësin e bibliotekës.</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me pajisjet e duhura teknike, tavolinat e punës si dhe programet kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin e saj nga studentët. Evidencat mbi tekstet akademike, literaturën shtesë dhe udhëzuesit për studentët, në funksion të shfrytëzimit të saj, gjenden dhe në formatin elektronik në faqen elektronike zyrtare të institucionit. Njëra prej hapësirave të bibliotekës përmban zonën e kompjuterave dhe aksesoret e tjerë të nevojshëm, 8 vende të tillë. Kjo infrastrukturë digjitale fizike ofrohet pa kufizime apo pagesë për të gjithë studentët e programit, në përputhje me rregulloren e bibliotekës. Megjithatë, duhet të shihet me përparësi rritja e

	kapacitetit të vendeve në bibliotekë pasi numri i vendeve për një sallë studimi është i limituar, duke menduar që numri i studentëve mund të rritet. Referencë: <i>Evidenca 4.13 "Ambientet e bibliotekës";</i> <i>Evidenca shitesë "Biblioteka. Politika dhe procedurat";</i> https://www.unyt.edu.al/page/library; <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takim me punonjës in e bibliotekës.</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi (09.00-19:00 dhe në fundjavë deri në orën 17.00) që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Mirëpo, do të ishte e udhës që orari i shërbimit të ndryshonte në periudhën e provimeve dhe të zgjatej edhe në orët e mbrëmjes që t'iu mundësohet studentëve hapësira e nevojshme për përgatitje për provime. Referencë: <i>Evidenca 4.13 "Ambientet e bibliotekës";</i> <i>Evidenca 4.9.1 "Library for all".</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë	Drejtuesit e departamenteve hartojnë një plan të detajuar për të rritur numrin e materialeve të bibliotekës në përputhje me programet studimore, projektet e kërkimeve shkencore dhe përgatitjes së temave nga studentët. Kërkesat shqyrtohen nga organet eprorë dhe nëse miratohen e janë në përputhje me buxhetin e parashikuar për shpenzimet e bibliotekës, i kalojnë për ekzekutim bibliotekës dhe administratorit të universitetit. Procedura për shtimin e literaturës në bibliotekë dhe për përditësimin e fondit të saj është parashikuar në nenet 7 dhe 8 të "Politikave dhe procedurave të bibliotekës". Sipas R/VB, f. 63, buxheti i bibliotekës varion nga 15.000-20.000 Euro për blerjen dhe përditësimin e teksteve të rinj akademikë dhe 20.000 Euro për abonimin vjetor në burimet elektronike dhe të bibliotekave online. Nga takimi me stafin akademik na u konfirmua fakti që institucioni merr në konsideratë kërkesat e tyre për literaturë

qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	plotësuese, kurse nga takimin me punonjësen e bibliotekës u konfirmua se mbante të dhëna të sakta lidhur me shfrytëzimin e bibliotekës dhe fondeve të saj, fakt i pasqyruar edhe në përmbajtjen e RVB, f. 65. Referencë: <i>Evidenca shtesë "Biblioteka. Politika dhe procedurat";</i> <i>Evidenca 2.13 "Rregullore e buxhetit";</i> <i>Evidenca 2.13.1 "Plan Buxheti - Drejtësia 2023-2024";</i> <i>Evidenca 2.13.2 "Plan Buxheti-Drejtësia 2025-2026";</i> <i>Evidenca 2.4.2 "Shembull porosi literature (procesi i prokurimit)";</i> <i>Evidenca 2.4 "Shembull email porosi literature";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", takimet me stafin akademik dhe me punonjësin e bibliotekës.</i>			
Konkluzione	<i>Literatura e detyrueshme si dhe ajo e këshillueshme është një nga komponentët e syllabuseve të lëndëve.</i> <i>Institucioni ka krijuar një fond të konsiderueshëm në bibliotekën e tij, me tekste në fushën e drejtësisë. Titujt zgjidhen nga departamenti që ofron programin e studimit.</i> <i>Institucioni ka mundur akses të lirë dhe mundësi të barabarta për shfrytëzimin e bibliotekës për të gjithë studentët e këtij programi si dhe personelin akademik, për qëllime studimore dhe kërkimore.</i> <i>Biblioteka është e pajisur me programe dhe sisteme kompjuterike të regjistrimit të librave dhe kërkimit të literaturës si dhe ka akses në disa databaza të kërkimit të literaturës online, që i shërbejnë kërkimit shkencor, përgatitjes së tezave, etj.</i> <i>Biblioteka ka orare të përshtatshme të shërbimit, të lidhura me programin e studimit dhe nevojat e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UNYT ka një sistem të menaxhimit të informacionit që realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit nga regjistrimi deri në diplomim ((sistemi GNOMON). Ky sistem shërben edhe për nxjerrjen e statistikave dhe zhvillimin e analizave përkatëse. Duke nisur nga viti akademik 2023-2024, institucioni ka filluar të përdorë platformën e re KION, me risi në drejtim të regjistrimit të lëndëve dhe lehtësirave të tjera për stafin akademik dhe studentët për të dhënat e krijuara gjatë procesit mësimor. Sekretaria mban në formë të shkruar/<i>hard copy</i>: Regjistrin themeltar të studentëve dhe Regjistrin e arritjeve akademike të studentit. Këto të dhëna ruhen dhe arkivohen sipas legjislacionit përkatës mbi arkivat. Të dhënat në fjalë u konsultuan gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ, si regjistrat, dosjet e studentëve të përzgjedhura rastësisht, ashtu dhe procesverbale të vlerësimit të tyre, dokumente të cilët u gjetën të rregullt në formë dhe përmbajtje. Referencë: <i>Evidenca shitesë "Internal regulation for the operation of the record and registrar office";</i> <i>Evidenca 4.20 "Platforma Gnomon";</i> <i>Evidenca 4.21.6 "Regjistrimi i studentëve në KION";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimet me anëtarët e GVB, stafin e sekretarisë dhe me stafin akademik.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe	Sistemi i administrimit të brendshëm të informacionit dhe dokumentacionit funksionon edhe në lidhje me stafin akademik. Ky informacion menaxhohet nga struktura të ndryshme si: zyra e Burimeve Njerëzore, Arkiva, Sekretaria dhe IT, në përputhje me aktet e brendshme të punës për funksionimin e administratës së UNYT. Të dhënat e stafit akademik ruhen dhe përditësohen rregullisht çdo vit. Për secilin anëtar të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit mbahet informacioni lidhur me performancën akademike, por edhe lëndët përkatëse në

partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	secilin semestër, lëndët që mbulojnë, etj. Të dhënat në fjalë administrohen nga zyra e burimeve njerëzore, e cila ka vënë gjatë vizitës në institucion në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Institucioni ka të administruara të dhëna lidhur me veprimtaritë ku është përfshirë stafi, si të natyrës sociale, pjesëmarrje në <i>workshop</i>-e dhe trajnime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca si dhe botimet e bëra nga stafi akademik. Departamenti i Drejtësisë administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre. Referencë: <i>Evidenca "5.31 Rregullore e Arkivës";</i> <i>Evidenca shitesë "Internal regulation for the operation of the record and registrar office";</i> <i>Evidenca 4.29 "Emërim stafi";</i> <i>Evidenca 1.28 "CV e stafit akademik";</i> <i>Evidenca 1.14 "Aktivitetet e Departamentit të Drejtësisë";</i> <i>Evidenca 2.19 "Konferencat dhe punimet shkencore të stafit akademik PAK dhe PAE";</i> <i>Evidenca 1.13 "Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit";</i> <i>Evidenca 5.10 "Lista e MoU";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takim me zyrën e Burimeve Njerëzore.</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar si dhe vizita e kryer në institucion rezulton më së miri se sistemi i menaxhimit në shfrytëzim, bën të mundur në mënyrë efikase aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët sipas programeve të studimit duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale. Sistemi është në gjendje të sigurojë informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog. Referencë: <i>Evidenca 5.31 "Rregullore e arkivës";</i> <i>Evidenca 4.18 "Sistemi i menaxhimit KION";</i> <i>Evidenca 4.20 "Platforma Gnomon dhe aksesimi";</i>

	<i>Evidenca 4.22 "Deklaratë pëlqimi";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York".</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit mundëson aksesin në të dhëna me anë të llogarive individuale, me të cilat janë pajisur stafi dhe studentët e programit, në platformën e re KION. Çdo student disponon adresën e tij elektronike me akses personal, dhe është në gjendje që nëpërmjet saj të regjistrohet në programin e studimit, të ndjekë lëndët dhe të verifikojë arritjet personale në mënyrë konfidenciale. Institucioni, nëpërmjet sistemit të menaxhimit që ka në shfrytëzim, mundëson krijimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit. Sistemet lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit, gjë e cila u konfirmua nga GVJ gjatë takimit me punonjëset e zyrës së sekretarisë mësimore. Referencë: <i>Evidenca shitesë "Internal regulation for the operation of the record and registrar office";</i> <i>Evidenca 4.21.4 "Akses i studentëve në KION";</i> https://www.unyt.edu.al/page/my-unity; <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me sekretarinë mësimore.</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Aktet e brendshme parashikojnë rregullime në lidhje me krijimin dhe administrimin e dokumentacionit nga strukturat e UNYT, përgjegjëse për këtë program studimi. Në këto akte janë parashikuar në detaje aspekte që lidhen me administrimin shkresor të korrespondencës, ruajtjen fizike, asgjësimin apo arkivimin e dokumenteve. Njëkohësisht, janë përcaktuar edhe detyrat e strukturave përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit, të tilla si sekretaria mësimore, dekanati, departamenti, pedagogët. Platformat që përdoren për komunikim dhe shkëmbimin e informacionit mund të monitorohen në çdo kohë, pasi hedhja e çdo të dhëne lë gjurmë elektronike. Kjo mundëson marrjen e çdo informacioni të nevojshëm për qëllime monitorimi ose qëllime të tjera që lidhen me mbarrëvajtjen dhe administrimin e procesit mësimor në këtë program studimi.

	Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", neni 21, pika 2, germa c, në lidhje me nenin 19, pika 2, germa k;</i> <i>Evidenca 1.35 "Raporti vjetor i UNYT".</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të UNYT gjendet informacion në lidhje me programin e studimit dhe veprimtari të ndryshme, kriteret e përzgjedhjes së studentëve në këtë program studimi, marrjen e informacionit mbi syllabuset e lëndëve, dhe aspekte të tjera që lidhen me zhvillimin e procesit akademik. Pjesë e përmbytjes së kësaj faqeje janë edhe të dhënat për stafin akademik, aktivitetet shkencore, etj. Faqja e internetit është tërësisht në gjuhën angleze, çka përputhet me synimin për ndërkombëtarizimin e programit. Megjithatë, <u>GVJ sugjeron</u> që, në përputhje me standardet e vendosur në shtojcën nr. 3 të VKM nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë", informacionet të publikohen edhe në gjuhën shqipe. Referencë: https://www.unyt.edu.al/.
Konkluzione	<i>Sistemi i menaxhimit në përdorim nga UNYT mundëson ndjekjen e ecurisë së studentëve që nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre dhe përfundimin e studimeve.</i> <i>Institucioni administron dhe përditëson dokumentacionin për personelin akademik, ndihmës-akademik dhe atë administrativ në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e të dhënave.</i> <i>Sistemi i administrimit dhe menaxhimit të informacionit mundëson marrjen në kohë reale të informacionit të nevojshëm për qëllime monitorimi ose qëllime të tjera që lidhen me mbarëvajtjen dhe administrimin e procesit mësimor në këtë program studimi.</i> <i>GVJ sugjeron marrjen e masave të duhura në mënyrë që informacionet lidhur me këtë program studimi të publikohen online në faqjen zyrtare të IAL edhe në gjuhën shqipe, në përputhje me standardet dhe kriteret e vendosur në shtojcën nr.</i>

	3 të VKM nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë".		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësishë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Çdo vit buxhetor UNYT pasqyron dhe administron të dhënat në lidhje me buxhetin duke i dhënë prioritet financimit të nevojave parësore në nivel institucional. Referuar të dhënave në dispozicion, UNYT është organizuar në formën e një shoqërie tregtare, i regjistruar rregullisht në regjistrin tregtar. Prej vitit 2018 është bërë pjesë e Fondacionit Shtetëror Turk "Maarif". Institucioni harton çdo vit plane buxhetore afatmesëm, si pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Institucioni harton projekt-buxhetin e tij, ku pasqyron shpenzimet si dhe të ardhurat dhe burimet e tyre. Referuar RVB, f. 70, procesi i brendshëm i planifikimit buxhetor nis në periudhën Prill-Maj të vitit akademik, duke u bazuar në shpenzimet e vitit aktual dhe parashikimet e numrit të studentëve, programeve të reja akademike si dhe shpërndarjen e tyre në ciklet dhe degët e studimit. Raportimi i veprimtarisë financiare paraqitet si një i tërë dhe nuk u referohet programeve të veçanta. Institucioni ka hartuar plane financiare që i referohen ndarjes së burimeve financiare me qëllim mbarëvajtjen financiare në nivel institucional dhe nuk i referohen specifikisht këtij program studimi. Njësitë bazë në kuadrin e hartimit të projekt-buxhetit, propozojnë dhe bëjnë kërkesa për fonde buxhetore që iu referohen shpenzimeve lidhur me mbarëvajtjen e programeve mësimore. Institucioni ka ngritur struktura të dedikuara ndaj mbikëqyrjes së veprimtarisë financiare në nivel institucional, si Bordi i Administrimit dhe Administratori.

	Burim i të ardhurave, bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion janë të ardhurat nga vetëfinancimi dhe burimet e tjera, projektet dhe donacionet. Të ardhurat faktike, rezultojnë të jenë siguruar nga tarifat e shkollimit, grantet për kërkim dhe kontratat dhe aktivitetet tregtare. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", neni 21, pika 2, germa f, në lidhje me nenin 19, pika 2, germa m, nenet 37-39, neni 78;</i> <i>Evidenca 2.13. "Rregullore e buxhetit";</i> <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse", tabela 18.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni harton plane financimi çdo periudhë buxhetore. Në planet e financimit pasqyrohen detaje që i referohen ndarjes së burimeve financiare në formën e shpenzimeve dhe të të ardhurave. Pasqyrimi i këyre të dhënave nuk është i kategorizuar sipas programeve që ofron institucioni. Struktura e programit financiar bëhet duke i ndarë të ardhurat sipas shpenzimeve të tyre. Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, duke marrë në konsideratë fondin e pagave, kontributet shoqërore dhe shëndetësore, për veprimtari shkencore dhe fondin e ekselencës. Gjatë hartimit të planit mbahen parasysh gjithashtu kërkesat për sigurimin e cilësisë, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, shpenzimet për pasurimin e bibliotekës, bibliotekën online, etj. Po ashtu, plani i financimit parashikon dhe nevojat e departamenteve/njësive për fonde për punë kërkimore, sipas listës së veprimtarive që do të zhvillohen. Këto parashikime janë në përputhje me përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve në drejtësi. Referencë: <i>Evidenca 2.13. "Rregullore e buxhetit".</i> <i>Evidenca 2.13.1 "Plan Buxheti - Drejtësia 2023-2024";</i> <i>Evidenca 2.13.2 "Plan Buxheti - Drejtësia 2025-2026";</i> <i>Evidenca 4.32 "Procedura e buxhetimit".</i>

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni çdo vit harton dhe dokumenton gjendjen financiare të tij, kontabilizimin e shpenzimeve të kryera dhe të ardhurave të realizuara. Njëkohësisht, në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, i nënshtrohet procesit të auditimit të përvitshëm të situatës financiare të tij. Institucioni zbaton detyrimet që lidhen me monitorimin e situatës financiare, auditimin dhe raportimin, duke mundësuar në këtë mënyrë transparencën financiare. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm në UNYT kryhet nga ekspertë të licencuar, të pavarur. Përveç auditimit të jashtëm, realizohet dhe auditimi i brendshëm (Njësia e Auditit të Brendshëm), nga i cili dalin të dhënat në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë në përputhje me rregullat dhe standardet. Ky kontroll konsiston në auditim financiar, logjistik dhe administrativ. Në raportet e audititit pasqyrohet opinioni i tyre mbi transparencën financiare si dhe pasqyrimi i të dhënave financiare të institucionit. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", neni 79;</i> <i>Evidenca 4.30 "Raporti i auditit të jashtëm";</i> <i>Evidenca 4.31 "Bilanci dhe auditit".</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Strukturat përgjegjëse të UNYT informojnë dhe raportojnë mbi aspektet që lidhen me realizimin e buxhetit. Hartimi i projekt-buxhetit vjetor bëhet edhe mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin buxhetor afatmesëm. Në kuadër të hartimit të projekt-buxhetit, departamentet evidentojnë kërkesat për fonde buxhetore në lidhje me aspekte që u referohen mbarrëvajtjes së programeve të studimit. Administratori i njësive kryesore i raporton për veprimtarinë që lidhet me funksionin financiar administratorit të institucionit, ku përfshihen të dhëna lidhur me analizën e realizimit të buxhetit për një vit kalendarik, duke dhënë në mënyrë të detajuar realizimin e shpenzimeve sipas treguesve. Në këtë analizë përfshihet dhe rezultati i pritshëm i të ardhurave. Në vijim, administratori i institucionit i paraqet në përfundim të vitit akademik Bordit të Administrimit dhe senatit raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit.

	Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", nenet 36-38;</i> <i>Evidenca 4.31 "Bilanci dhe audit";</i> <i>Evidenca 4.32 "Procedura e buxhetimit".</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Duke mbajtur në vëmendje të dhënat e shqyrtuara, mund të konkludohet se institucioni shfaq qëndrueshmëri financiare dhe ka mjetet e duhura financiare për të siguruar mbarëvajtjen dhe vijimin e këtij programi studimi. Situata financiare paraqet qëndrueshmëri dhe për studentët e ardhshëm që do të zgjedhin të ndjekin programet e studimit të ofruar nga departamenti i Drejtësisë. Është theksuar në RVB, f. 72, se financimi i vazhdueshëm nga fondacioni ka siguruar qëndrueshmëri financiare dhe siguri për zhvillimin e programeve të studimit. Megjithatë, duke konsideruar burimet e të ardhurave faktike të deklaruar nga vetë institucioni, <u>sugjerohet që institucioni të zgjerojë mundësinë e përfshirjes edhe burimeve të tjerë alternativë në të ardhurat institucionale, gjë e cila lejohet nga statuti, në mënyrë që të jetë në gjendje për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë edhe në situata të paparashikuara rreziku.</u>
Konkluzione	<i>Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare si dhe administron dokumentacion në lidhje me veprimtarinë e tij financiare.</i> <i>UNYT realizon raportimin financiar si dhe harton plane financiare që i referohen ndarjes së burimeve financiare, me qëllim mbarëvajtjen financiare në nivel institucional.</i> <i>Në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, institucioni i nënshtrohet procesit të auditimit të përvitshëm të situatës financiare të tij si dhe zbaton detyrimet që lidhen me auditimin dhe raportimin, duke mundur në këtë mënyrë transparencën financiare.</i> <i>Institucioni shfaq qëndrueshmëri financiare dhe ka mjetet e duhura financiare për të siguruar mbarëvajtjen dhe vijimin e këtij programi studimi.</i> <u><i>GVJ sugjeron që institucioni të zgjerojë mundësinë e përfshirjes edhe të burimeve të tjerë alternativë në të ardhurat institucionale, gjë e cila lejohet nga statuti, në mënyrë që të jetë</i></u>

	<i>në gjendje për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë edhe në situata të paparashikuara rreziku.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Organizimi i këtij programi studimi mbështetet në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Në përputhje me rregullimet ligjore, janë hartuar nga institucioni edhe aktet rregullatore të brendshme që parashikojnë politika dhe procedura që i referohen ecures së studentit nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se institucioni disponon të dhëna të hollësishme mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve duke nisur nga pranimi deri në diplomim, përfshirë numrin e të regjistruarve, të transferuarve, kalueshmërinë, notën mesatare, etj.

	Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025";</i> <i>Evidenca 1.7 "Rregullore universiteti";</i> <i>Evidenca 1.11 Rregullore programi e rishikuar 2025";</i> <i>Evidenca 2.8 "Rregullore e transferimit të krediteve Eng";</i> <i>Evidenca 3.25 "Rregullore e projektit të diplomimit";</i> <i>Evidenca 5.1 "Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore".</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në parim dhe sipas dokumentacionit të paraqitur, ky program ndjek procedura dhe politika që garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të UNYT. Rregullorja e programit të studimit përcakton qartazi të drejtat dhe detyrimet e studentëve dhe personelit akademik. Kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve, të përpiluara e miratuara sipas ligjit të aplikueshëm, publikohen në faqen zyrtare të institucionit. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", kapitulli VIII;</i> <i>Evidenca 1.7 "Rregullore universiteti", kreu IV;</i> <i>Evidenca 1.11 "Rregullore programi e rishikuar 2025".</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi dhe përmes kriterëve të aplikimit të shpallura publikisht, ku përfshihet edhe dokumentacioni që kandidati duhet të paraqesë. UNYT shpall listën dhe renditjen përkatëse të kandidatëve publikisht përpara fillimit të procesit mësimor. Ky vendim, sikundër edhe të gjithë kriteret, si të përgjithshme edhe të veçanta, është i aksesueshëm edhe në faqen zyrtare të institucionit. Numri i kandidatëve të pranuar bëhet në bazë të kriterit të mesatares dhe brenda kuotave të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Si kriter i veçantë për përzgjedhjen e studentëve me qëllim pranimin në këtë program studimi është parashikuar zotërimi i gjuhës angleze, për shkak se është gjuha zyrtare e mësimdhënies. Referencë:

	<i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", kapitulli VIII;</i> <i>Evidenca 1.7 "Rregullore universiteti", kreu IV;</i> <i>Evidenca 1.11 Rregullore programi e rishikuar 2025";</i> <i>Evidenca 5.2 "Vendim Senati për kriteret e pranimit 2020-2024";</i> <i>Evidenca 5.9 "Lista e aplikantëve U-Albania";</i> <i>Evidenca 5.9.1 "Lista e fituesve U-Albania";</i> https://www.unyt.edu.al/page/admission-criteria.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Procedurat dhe kriteret e përdorur për përzgjedhjen, përparimin, transferimet apo njohjen e studimeve janë të qarta dhe të kuptueshme. Këto kritere u bëhen të njohura të interesuarve apo kandidatëve për studentë në përputhje me procedurat e parashikura në aktet rregullatore. Aktet rregullatore të brendshme përmbajnë informacione të detajuara në lidhje me kriteret e përparimit, kohëzgjatjen e studimeve, transferimet, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin. Programet mësimore si dhe syllabuset e lëndëve kanë përmbajtje mjaft të detajuar që i shërben procesit informues. Në përmbajtjen e programit gjenden të gjithë elementet mbi objektivat, strukturën e programit, kohëzgjatjen e studimeve, etj. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacion të detajuar dhe të kuptueshem mbi detyrimet e studentëve, format e kontrollit dhe vlerësimit të lëndës. Nga vizita në institucion, ekspertët e GJV konstatuan se njoftimet që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor apo çdo veprimtari të zhvilluar nga institucioni, bëhen të ditura nga një sërë strukturash të brendshme dhe janë plotësisht të aksesueshme nga studentët. Institucioni publikon informacion në lidhje me kriteret e këtij programi studimi edhe në faqen e tij zyrtare. Referencë: <i>Evidenca 1.11 Rregullore programi e rishikuar 2025";</i> <i>Evidenca 1.6 "Syllabuset e lëndëve";</i> <i>Evidenca 5.28 "Programet e studimit";</i> https://www.unyt.edu.al/page/p-law.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, kuotat si dhe procedurat e regjistrimit publikohen dhe u vihen në dispozicion të interesuarve përpara fillimit të vitit akademik. Me qëllim lehtësimin e aksesit në informacion, institucioni publikun njoftime në faqen e tij zyrtare. Në faqen zyrtare të institucionit publikohen gjithashtu edhe programet mësimore. Informacioni i nevojshëm mund të aksesohet lehtësisht edhe pranë sekretarisë mësimore. Mënyrë tjetër informimi është ajo e takimeve që realizon institucioni përmes Zyrës së Çështjeve Studentore, e cila zhvillon takime informuese me nxënësit maturantë të shkollave të arsimit të mesëm të lartë. Në takime marrin pjesë anëtarë të stafit akademik dhe akademik, të cilët udhëzojnë të interesuarit mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta për programet e studimit të ofruar nga UNYT. Njëkohësisht, informacioni në lidhje me programet e studimit mund të aksesohet edhe nëpërmjet broshurave informuese apo fletë palosjeve, pjesëmarrjes në panaire të ndryshme dhe veprimtarive të tjera. Referencë: <i>Evidenca 5.1 "Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore";</i> <i>Evidenca 5.5 "Kursët e maturës";</i> <i>Evidenca 5.6 "Panairi i punës dhe studimit";</i> <i>Evidenca 5.25 "Materiale promovimi";</i> https://www.unyt.edu.al/page/explore-study-programs.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni ka parashikuar në aktet e tij të brendshme mbrojtjen nga çfarëdo diskriminimi gjatë procesit të pranimit të kandidatëve për studentë. Për kandidatët që u përkasin kategorive të përmendura në këtë kriter, institucioni përdor politika lehtësuese si dhe publikon kuotat përkatëse për individë që u përkasin këtyre grupeve shoqërore. Gjithsesi, pavarësisht vendimmarrjes në favor të personave që vijnë nga grupe shoqërore vulnerabël, do të ishte e përshtatshme që të rishikoheshin aktet e brendshme rregullatore, duke bërë parashikime të posaçme në to. Në RVB, f. 77, përmendet se politikat lehtësuese zbatohen ndaj personave në nevojë edhe nëpërmjet provimit të bursës si dhe peticioneve financiare për lehtësimin e pagesave.

	Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", neni 71;</i> <i>Evidenca 1.7 "Rregullore universiteti", neni 62;</i> <i>Evidenca 5.3 "Kuotat për vitin akademik";</i> <i>Evidenca 5.8 "Provimi i bursës";</i> https://unytold.unyt.edu.al/index.php/student-academic-petition/.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni miraton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret dhe procedurat për rekrutimin e kandidatëve për studentë nga shtetet e tjera, mbi bazën edhe të kërkesave që ka pasur vitet e shkuara. Këto kuota janë të miratuara me vendim të senatit akademik. Gjatë vizitës në institucion rezultoi se në këtë program studimi është një studente, shtetase e Republikës së Kosovës. Referencë <i>Evidenca 5.2 "Vendim senati për kriteret e pranimit";</i> <i>Evidenca 5.3 "Kuotat për vitin akademik";</i> https://www.unyt.edu.al/page/international-students; https://int.unyt.edu.al/; <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", takimet me stafin akademik, anëtarët e GVB dhe studentët.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UNYT miraton për çdo vit akademik kriteret për akordimin dhe fitimin e bursave, sipas programeve përkatëse, duke u mbështetur në dokumentacionin e përgatitur nga Zyra e Çështjeve Studentore. Vendimet merren nga komiteti i bursave, duke pasur si referencë notën mesatare të shkollës së mesme, arritjet e tyre brenda dhe jashtë vendit si dhe provimin e bursës. Mbi bazën e këtyre kriterëve variojnë edhe bursat e përfituara. Kriteret për fitimin e bursave përcaktohen në politikën e bursave. Referencë: <i>Evidenca 5.7 "Politika e bursave";</i> <i>Evidenca 5.1 "Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore";</i>




	<i>Evidenca 5.8 "Provimi i bursës".</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tij të brendshme.</i> <i>Procedurat dhe kriteret e përgjithshme dhe të posaçme që përdor institucioni për përzgjedhjen e kandidatëve dhe për përparimin akademik të studentëve janë të qarta dhe të kuptueshme.</i> <i>UNYT, nëpërmjet strukturave të tij të dedikuara, zbaton të gjitha procedurat e nevojshme për të informuar në mënyrë të plotë të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të këtij programi studimi dhe për të lehtësuar aksesin në informacion.</i> <i>Në politikat e tij, institucioni u ka kushtuar vëmendjen e duhur kategorive të veçanta të studentëve si dhe ka zbatuar politika mbështetëse për pjesëmarrjen e tyre në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	UNYT ka hartuar një kuadër rregullator të plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomim. Aktet rregullatore të brendshme përmbajnë elemente informues mbi përzgjedhjen e studentëve, sistemin e përparimit dhe vlerësimin të dijeve, diplomimit si dhe transferimit të krediteve. Programet e lëndëve, gjithashtu, përmbajnë informacion të detajuar didaktik dhe akademik për studentët. Në programet e lëndëve përcaktohen kritere të detajuara të përparimit akademik të tilla si detyrimet për frekuentimin e procesit mësimor në

	auditor (leksione, seminare), shlyerja e projekteve, provimet e ndërmjetme, mënyra e shlyerjes në përfundim të lëndës, pikët e nevojshme për vlerësimin kalues në secilën lëndë. Studentët njihen me përmbajtjen dhe komponentët e programit të çdo lënde në fillim të procesit mësimor. Njëkohësisht këto informacione janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të IAL. Studentët mund të marrin të gjithë informacionin e duhur në lidhje me aspekte të procesit mësimor dhe përparimit akademik edhe pranë sekretarisë mësimore, kurse shfrytëzimi i platformës KION mundëson informimin dhe njohjen e përparimeve akademike nga studentët në kohë reale. Nëpërmjet Zyrës së Çështjeve Studentore studentët informohen për rregullat e frekuentimit, kurset e detyrueshme, modulet karakterizuese, kurset integruese, kurset e detyrueshme me zgjedhje, praktikën dhe temën e diplomës, sezonet e provimeve, si edhe me numrin e krediteve që marrin për çdo lëndë dhe semestrin kur duhet ta ndjekin. Pavarësisht larmisë së burimeve nga ku studentët mund të marrin dijeni për të gjithë procesin mësimor, <i>GVJ konstaton mungesën e një guide apo udhëzuesi për studentët, ku të jenë të përmbledhur të gjithë rregullat, procedurat dhe strukturat që ofrojnë shërbimet në funksion të tyre, çka do të lehtësonte orientimin e studentëve të regjistruar por dhe të personave që aspirojnë të ndjekin studimet në këtë universitet.</i> Referencë: <i>Evidenca 1.7 “Rregullore universiteti”, kreu IV;</i> <i>Evidenca 1.11 “Rregullore programi e rishikuar 2025”;</i> <i>Evidenca 1.6 “Syllabuset e lëndëve”;</i> <i>Evidenca shtesë “Internal regulation for the operation of the record and registrar office”;</i> <i>Evidenca 5.1 “Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore”;</i> <i>Evidenca 4.18 “Sistemi i menaxhimit KION”;</i> <i>https://www.unyt.edu.al/page/p-law;</i> <i>Evidenca shtesë “Shënime New York”, takimet me stafin akademik dhe studentët.</i>
--	--

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UNYT si institucion i arsimit të lartë, ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Institucioni garanton mundësinë e njohjes dhe njësimit të periudhës së studimit dhe detyrimeve të programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e universitetit dhe atë të këtij programi studimi, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi mbi arsimin dhe kërkimin në institucionet e arsimit të lartë. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm edhe pranë Sekretarisë Mësimore. Referencë: <i>Evidenca 1.7 "Rregullore universiteti", kreu IV;</i> <i>Evidenca 1.11 "Rregullore programi e rishikuar 2025";</i> <i>Evidenca shtesë "Internal regulation for the operation of the record and registrar office";</i> <i>Evidenca 2.8 "Rregullore e transferimit të krediteve";</i> https://www.unyt.edu.al/page/transfer-student-admissions.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Aktet rregullatore të institucionit dhe në veçanti rregullorja e programit të studimit parashikon kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi. Rregullorja e programit të studimit përcakton rregullat mbi të cilat bazohet procesi i vlerësimit të njohurive dhe dijeve të studentëve të përfituara përgjatë procesit mësimor. Ajo parashikon rregullime të detajuara lidhur me format e kontrollit të njohurive, shlyerjes së provimeve, riprovimeve, sistemit të vlerësimit, etj. Njëkohësisht studenti e merr këtë informacion edhe nga syllabusi i lëndës. Programet e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi mënyrën e vlerësimit të dijeve si dhe komponentët e vlerësimit. Në programet e lëndëve përcaktohen format e kontrollit të njohurive dhe vlerësimi për secilin komponent. Kontrolli i njohurive përbëhet nga disa komponentë dhe realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Në fillim të çdo semestri, studentët informohen nga pedagogët mbi përmbajtjen dhe komponentët e secilit nga syllabuset. Metodologjia dhe struktura e hartimit të testeve janë gjithashtu pjesë e informacionit që merret nga studentët, përmes stafit

	akademik. Në kuadrin e detyrave që ushtrojnë pedagogët përfshihet edhe konsultimi me studentët, sipas nevojave dhe kërkesës së tyre, në funksion të përvetësimit sa më të plotë të programit mësimor. Rol në këtë proces luajnë edhe këshilltarët akademikë si dhe sekretaria mësimore. Nga takimi me studentët rezultoi se ata janë të informuar mbi komponentët e programit të studimit të tyre, që lidhen me vlerësimin e dijeve dhe njohurive të marra në të. Referencë: <i>Evidenca 1.11 "Rregullore programi e rishikuar 2025";</i> <i>Evidenca 1.6 "Syllabuset e lëndëve";</i> <i>Evidenca shtesë "Internal regulation for the operation of the record and registrar office";</i> <i>Evidenca 2.9.1 "Detyrat e këshilltarëve akademikë";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", takimi me studentët.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	UNYT ofron një udhëzues informativ mbi punimin e diplomës, ku përfshihen kërkesat dhe formati i tezës, duke përfshirë edhe njohuritë mbi shkrimin akademik për t'i dhënë mundësinë studentit që të paraqesë një punë kërkimore origjinale dhe hulumtuese që demonstroi kompetencën në fushën e studimit dhe njohuritë profesionale në këtë profil. Periudhat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në kalendarin akademik. Në takimin me studentët rezultoi se ata kishin dijeni të plotë lidhur me procesin e përgatitjes së tezës. Referencë: <i>Evidenca 1.11 "Rregullore programi e rishikuar 2025";</i> <i>Evidenca 3.25 "Rregullore e projektit të diplomimit";</i> <i>Evidenca 3.26 "Formati i diplomës";</i> <i>Evidenca 2.12 "Kalendari akademik 24-25";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", takimi me studentët.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike,	Institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik, merr masat e nevojshme për realizimin e veprimtarive informuese me qëllim njohjen me programet e studimit. Kriteret për përzgjedhjen e

institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	kandidatëve, kuotat si dhe procedurat e regjistrimit publikohen dhe u vihen në dispozicion të interesuarve përpara fillimit të vitit akademik. Nëpërmjet Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Departamentit të Drejtësisë, institucioni organizon takime të hapura për të informuar të interesuarit dhe studentët mbi programin e studimit. Takime informuese zhvillohen edhe në mjediset e institucionit ku shpërndahen edhe fletëpalosje për të interesuarit mbi të dhënat e programit të studimit. Me qëllim lehtësimin e aksesit në informacion, institucioni publikon njoftime në faqen e tij zyrtare. Këto informacione publikohen gjithashtu edhe në rrjetet sociale apo media. Referencë: <i>Evidenca 5.27 "SAO Plani vjetor 2023";</i> <i>Evidenca 5.4 "Ditët e hapura dhe vizitat e studentëve";</i> <i>Evidenca 5.5 "Kurset e maturës".</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar kuadrin rregullator të duhur mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomim.</i> <i>Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimit të studimeve janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi mbi arsimin e lartë.</i> <i>UNYT ka parashikuar dhe zbaton procedura mbi informimin e studentëve mbi komponentët e programit të studimit. Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, rezultoi se ata ishin të informuar mbi organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</i> <i>GVJ sugjeron që UNYT të marrë masat për hartimin dhe miratimin e një guide ose udhëzuesi për studentët, ku ata të gjejnë të përmbledhur të gjitha rregullat, procedurat dhe strukturat që ofrojnë shërbimet në funksion të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Informimi i studentëve lidhur me programin mësimor, strukturën dhe përmbajtjen, kohëzgjatjen, lëndë/modulet që zhvillohen dhe syllabuset e tyre, së bashku me detyrimet semestrale dhe strukturën akademike të programit, realizohet me studentët që në momentin kur kontaktojnë për të shprehur interes rreth programit. UNYT dhe departamenti i Drejtësisë si njësi bazë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit, kanë në përbërje të gjithë kapacitetet njerëzore për t'u mundësuar studentëve informacionin e nevojshëm mbi komponentët e programit. Edhe nga takimi me studentët u vu re se ata ishin të mirëinformuar mbi afatin e përfundimit të studimeve si dhe organizimin e programit mësimor nëpërmjet informimit <i>online</i> ose përmes zyrës së sekretarisë mësimore, stafit akademik, këshilltarëve akademikë, etj. Referencë: <i>Evidenca 2.9.1 "Detyrat e këshilltarëve akademikë";</i> <i>Evidenca 2.12.1 "Kalendari akademik 2023-2024";</i> <i>Evidenca 5.1 "Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore";</i> https://www.unyt.edu.al/page/p-law; <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me studentët.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët kanë qasje në informacionin dhe dokumentacionin udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, ngarkesën mësimore, orët në auditor, syllabuset e detajuar, praktikatat, ushtrimet, detyrat e kursit si dhe çdo veprimtari tjetër që përfshihet në programin e studimit. Këto informacione ofrohen ndaras si pjesë e syllabuseve, rregulloreve të ndryshme të programit, si dhe njoftimeve të vazhdueshme. Informimi mundësohet si në fillim, ashtu dhe në vijim të vitit akademik. Institucioni i publikon

	informacionet në lidhje me programet e studimit që ofron edhe në faqen zyrtare të tij. Do të ishte mirë dhe më lehtë për studentët që këto informacione të ishin të grumbulluara dhe strukturuara në një manual apo udhëzues të integruar të programit të studimit. Referencë: <i>Evidenca 1.11 "Rregullore programi e rishikuar 2025";</i> <i>Evidenca 1.6 "Syllabuset e lëndëve";</i> https://www.unyt.edu.al/page/p-law; <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni organizon orientime të studentëve në lidhje me mundësitë dhe orientimin në tregun të punës si dhe mundëson kontaktin e studentëve me alumni të punësuar. Gjithashtu, studentët informohen mbi mundësitë e punësimit dhe u ofrohet mbështetje institucionale nëpërmjet letrave të rekomandimit, orientimeve specifike, etj. Për këtë program studimi nuk ka ende studentë të punësuar. Përgjegjësinë kryesore për orientim karriere e ka Zyra e Karrierës. Një ndër veprimtaritë e rëndësishme të realizuara nga kjo zyrë është panairi vjetor i punës, ku studentëve iu jepet mundësia të dëgjojnë intervista nga përfaqësues të sektorit publik dhe subjektet e ndryshëm të biznesit, alumni, etj. Në lidhje me këtë kriter, vërehet se mungon një udhëzues i posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës si dhe për zhvillimin e karrierës. Referencë: <i>Evidenca 5.11 "Rregullore Zyra e Karrierës";</i> <i>Evidenca 5.12 "Aktivitete Zyra e Karrierës";</i> <i>Evidenca 5.12.2 "Panairi i punës 2024-2025";</i> <i>Evidenca 5.16 "Plani vjetor Zyra e Karrierës 23-24";</i> <i>Evidenca 5.15.3 "Panairi i karrierës 2024-2025";</i> <i>Evidenca 5.17 "Paneli alumni";</i> https://www.unyt.edu.al/page/job-gate;

	<i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me përfaqësuesit e zyrës së karrierës dhe alumni-t.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentëve iu vihet në dispozicion informacioni i përditësuar mbi programin e studimit në lidhje me veprimtaritë e ndryshme mësimore që organizohen nga UNYT, procesin mësimor, kalendarin akademik, infrastrukturën e shërbimit për studentët, etj, në fillim të çdo viti akademik gjatë ditëve të hapura. Këtu vlen të përmendet dhe roli i këshilltarit akademik, i cili siguron udhëzime për secilin student në të gjitha çështjet akademike si dhe ai i strukturave administrative që sigurojnë mbështetjen administrative dhe infrastrukturë. Informacioni i përditësuar gjendet dhe në faqen zyrtare elektronike të UNYT. Referencë: <i>Evidenca 1.8 "Rregullore fakulteti";</i> <i>Evidenca 1.11 "Rregullore programi e rishikuar 2025";</i> <i>Evidenca 5.4 "Ditët e hapura dhe vizitat e studentëve";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me studentët.</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi KION mundëson, me përmirësimet që sjell, informacionin e nevojshëm edhe nëpërmjet llogarive personale të studentëve duke krijuar lehtësi në komunikimin me stafin akademik të angazhuar në program, aksesin e leksioneve në formatin elektronik dhe çdo informacion tjetër që lidhet me organizimin e programit mësimor. Ky informacion mund të aksesohet qoftë brenda ambienteve universitare, por lehtësisht edhe në distancë. Referencë: <i>Evidenca 4.18 "Sistemi i menaxhimit KION";</i> <i>Evidenca 4.21.4 "Akses i studentëve në KION";</i> https://students.unyt.edu.al/.
Konkluzione	<i>UNYT ka në përbërje struktura të dedikuara si dhe përdor kapacitetet e nevojshme për t'u mundësuar studentëve të gjithë informacionin mbi komponentët e programit të studimit.</i> <i>Informacioni lidhur me organizimin, strukturën akademike, objektivat formuese, kurrikulën e programit të integruar të</i>

	<i>studimit si dhe infrastrukturën mbështetëse gjendet në aktet e brendshme, por sigurohet edhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik.</i> <i>Mbarimi i studimeve pranë UNYT mundëson vazhdimësinë e karrierës profesionale të studentëve në fushën e drejtësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe administron të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimeve sipas viteve, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Në këtë program studimi nuk ka studentë të diplomuar, duke qenë se ka aplikuar për akreditimin për herë të parë. Referencë: <i>Evidenca 1.26 “Tabelat përmbledhëse”; tabela 21, tabela 22;</i> <i>Evidenca 1.35 “Raporti vjetor i UNYT”.</i>								
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin	Sekretaria Mësimore, si struktura përgjegjëse, administron të dhënat që lidhen me studentët për çdo vit akademik. Dokumentacioni i administruar nga institucioni përmban të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim. Referuar të dhënave të sjella nga institucioni dhe vizitës në institucion, numri i studentëve për këtë program studimi rezulton të jetë si më poshtë: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Nr. i të regjistruarve</th><th>Nr. i të çregjistruarve</th><th>Nr. aktual</th></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table>	Viti akademik	Nr. i të regjistruarve	Nr. i të çregjistruarve	Nr. aktual				
Viti akademik	Nr. i të regjistruarve	Nr. i të çregjistruarve	Nr. aktual						

(Signature)

(Signature)

zhvillohet programi i studimeve.	2020-2021	10	3	7
	2021-2022	15	1	14
	2022-2023	4	-	4
	2023-2024	21	1	20
	2024-2025	14	1	13
Gjatë vizitës së realizuar në institucion u vërejt se dokumentacioni i administruar nga sekretaria ka të dhëna mbi numrin e studentëve, në vite të regjistruar në këtë program, numrin e studentëve që ndjekin këtë program si dhe tërheqjet nga programi apo mospërfundimin e tij. Pranë sekretarisë depozitohet gjithashtu dokumentacioni i personelit akademik mbi vijueshmërinë e procesit mësimor, frekuentimin si dhe vlerësimin e provimeve. Ky dokumentacion shërben si bazë për përpunimin e të dhënave statistikore. Gjithashtu, nga kontrolli i kryer në dosjet e regjistrimit të studentëve në sekretarinë mësimore, për zgjedhur në mënyrë rastësore, u konstatua se në to gjendeshin të administruar të gjithë dokumentet e nevojshëm, të përcaktuar në aktet e brendshëm të institucionit. Nuk u konstatuan probleme sa i përket matrikullimit të studentëve. Referencë: <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse", tabela 21 "Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve";</i> <i>Evidenca shtesë "Internal regulation for the operation of the record and registrar office";</i> <i>Evidenca 4.18 "Sistemi i menaxhimit KION";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", vizita në sekretarinë mësimore.</i>				
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes	Institucioni administron, sipas rregullave në fuqi për arkivat dhe dokumentet zyrtare, të gjithë dokumentacionin që lidhet me studentët dhe procesin mësimor. Kompetencat dhe detyrat e			

sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	strukturave përgjegjëse për administrimin e të dhënave të studentëve përcaktohen edhe në rregulloret dhe aktet e brendshme të institucionit. Sistemi i menaxhimit të informacionit është lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar. Administrimi i dokumentacionit mbi të dhënat e studentëve realizohet në dy forma, në formatin dokumentar dhe atë elektronik. Këto të dhëna ruhen në formatin dokumentar në formën e regjistrave apo procesverbaleve të notave. Administrimi i të dhënave në sekretari mundësohet në format elektronik nëpërmjet menaxhimit elektronik. Format e administrimit garantojnë sigurinë e të dhënave dhe i bëjnë ato lehtësisht të aksesueshme. Referencë: <i>Evidenca shitesë "Internal regulation for the operation of the record and registrar office";</i> <i>Evidenca 5.31 "Rregullore e arkivës";</i> <i>Evidenca 4.18 "Sistemi i menaxhimit KION";</i> https://academic.unyt.edu.al/; https://students.unyt.edu.al/.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni kryen kontrole periodike pranë sekretarisë mësimore si struktura përgjegjëse për pasqyrimin dhe administrimin e dokumentacionit në lidhje me studentët. Ky kontroll realizohet nëpërmjet një komisioni <i>ad hoc</i>, që merret me auditimin e brendshëm të njësive administrative. Rezultatet e kontrollit janë pjesë e analizave vjetore që realizohen që nga niveli i njësive bazë, deri në nivel institucional. Referencë: <i>Evidenca 6.14 "Internal Audit Procedure";</i> <i>Evidenca 6.14.2 "Raporti i auditit në sekretarinë mësimore".</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e	Departamenti i Drejtësisë administron të dhëna mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe nxjerr konkluzione mbi cilësinë nëpërmjet notës mesatare dhe kalueshmërinë për këtë program studimi. Referuar të dhënave të sjella nga institucioni, nota mesatare në hyrje:

cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	- Për vitin akademik 2020-2021 është 8.69; - Për vitin akademik 2021-2022 është 8.37; - Për vitin akademik 2022-2023 është 8.86; - Për vitin akademik 2023-2024 është 9.03; - Për vitin akademik 2024-2025 është 6.83; Vihet re se mesatarja në hyrje e studentëve është e kënaqshme. Institucioni për këtë program studimi administron edhe të dhëna mbi ecurinë akademike të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit, të cilat administrohen si mbi baza semestrale, ashtu edhe mbi bazë vjetore. Departamenti, çdo vit akademik analizon cilësinë e përmbushjes së programit mësimor dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore. Pjesë e analizës vjetore janë edhe aspektet që lidhen me rezultatet e provimeve, shkallën e kalueshmërisë si dhe notën mesatare. Këto të dhëna administrohen dhe pasqyrohen në formën e të dhënave në nivel institucioni. Nuk konstatohet që pjesë e analizës të jenë edhe arritjet e studentëve në ato lëndë apo grup-lëndësh ku ata tregojnë rezultate më të larta apo më të ulëta, me qëllim nxitjen e tyre apo orientimin e duhur të aftësive të tyre akademike. Për sa i takon punësimit, sikundër është theksuar më lart, në këtë program nuk ka studentë të diplomuar/punësuar. Referencë: <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse", tabela 21;</i> <i>Evidenca 1.35 "Raporti vjetor i UNYT".</i>
Konkluzione	<i>Institucioni disponon dhe administron të dhëna statistikore mbi studentët që ndjekin këtë program studimi.</i> <i>Të dhënat administrohen nëpërmjet dokumentacionit si dhe sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, i cili është i sigurt dhe lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar.</i> <i>Nëpërmjet të dhënave statistikore, institucioni analizon profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe nxjerr rezultate mbi cilësinë dhe kalueshmërinë për këtë program studimi.</i> <u><i>GVJ sugjeron që analiza vjetore e njësisë bazë të fokusohet edhe në të dhënat specifike të arritjeve të studentëve në ato lëndë apo</i></u>

	<i>grup-lëndësh në të cilat studentët shfaqin rezultatet më të larta apo më të ulëta, për t'i motivuar apo për t'i orientuar më mirë aftësitë e tyre akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Sipas parashikimeve të nenit 98/1, gërma c, të ligjit nr. 80/2015 dhe dispozitave rregullatore të brendshme, UNYT garanton përfshirjen e studentëve në disa struktura si Senati Akademik, Këshilli Studentor, Këshilli i Etikës dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", neni 74 në lidhje me nenet 18, 27 dhe 36;</i> <i>Evidenca 1.9 "Rregullore departamenti", neni 41;</i> <i>Evidenca 2.16 "Përfshirja e studentëve në Senat, NjSBC, Këshilli i Etikës".</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Angazhimi i studentëve është konkret, pasi ata janë vendimmarrës në disa struktura të universitetit, gjë që u konfirmua gjatë takimit me studentët si dhe mund të vërtetohet edhe në të dhënat e bëra publike nga IAL lidhur me strukturat e tij të brendshme. Gjithashtu, një përfaqësues i studentëve nga ky program, është anëtar i GVB. Të dhënat e mbledhura nga vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies, bëhen pjesë e analizave institucionale, me qëllim përmirësimin e problemeve të ngritura prej tyre. Rezultatet e analizave diskutohen në nivel të strukturave drejtuese. <u>Sugjerohet</u> që të bëhen analiza periodike mbi

	<i>përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin e procesit akademik.</i> Referencë: <i>Evidenca 2.15 "Email për studentët (zgjedhjet studentore)";</i> <i>RVB;</i> <i>Evidenca 2.16 "Përfshirja e studentëve në Senat, NjSBC, Këshilli i Etikës";</i> https://www.unyt.edu.al/page/university-governance#senate; https://www.unyt.edu.al/page/permanent-commissions; <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me studentët.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Si pjesëmarrës në organet kolegjiale dhe në përputhje me përcaktimet statutores, studentët kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në hartimin e kurrikulave apo përmirësimin e programit të studimit si nëpërmjet përfshirjes në organet kolegjiale, ku bëjnë pjesë, ashtu edhe pjesëmarrjes në fokus-grupe, përgjigjen e pyetësorëve <i>online</i> dhe mbledhje të departamentit në formatin e hapur për studentët. Në takimin e zhvilluar me ta, studentët konfirmuan mundësitë e dëgjimit të zërit të tyre nëpër struktura si dhe përmes Unionit Studentor si dhe u shprehën për shtimin e lëndëve penale me zgjedhje në programin e studimit, objekt vlerësimi. Referencë: <i>Evidenca 2.16 "Përfshirja e studentëve në Senat, NjSBC, Këshilli i Etikës";</i> <i>Evidenca 6.9 "Formular vlerësimi nga studentët";</i> https://www.unyt.edu.al/page/students-union; <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me studentët.</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të	Rregullorja e Fakultetit dhe rregullorja e programit përcaktojnë procedurat në rast ankese nga studenti si përsa i takon procedurës, ashtu edhe vlerësimit të provimit. Ndërkohë, pedagogu i lëndës dhe sekretaria mësimore janë në dispozicion të studentit për informacione. Studenti ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë dhe ankimin brenda 48 orëve. Studentët mund t'i drejtohen zyrës së çështjeve studentore dhe

rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	mandej procedura vijohet nga drejtuesi i departamentit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga takimet në institucion, nuk rezulton që të ketë pasur ndonjë proces të ezauruar në të gjitha shkallët përkatëse lidhur me ankesat ndaj vlerësimit të dijes. Referencë: <i>Evidenca 1.8 "Rregullore fakulteti", neni 25;</i> <i>Evidenca 1.11 "Rregullore programi e rishikuar 2025", neni 42;</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimet me stafin akademik, studentët dhe vizita në sekretarinë mësimore.</i>			
Konkluzione	<i>UNYT garanton dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje si dhe dhënien e mendimit të tyre nëpërmjet përfaqësimit në organet vendimmarrëse të institucionit.</i> <i>Mekanizmat përkatës që mundësojnë përfaqësimin e studentëve në vendimmarrje apo vlerësimin e procesit akademik, funksionojnë realisht, janë në shërbim të studentit si dhe në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.</i> <i>Studentët e shprehin mendimin e tyre edhe nëpërmjet mekanizmave të tërthortë si pyetësorët e studentëve, me anë të të cilëve ata japin kontributin e tyre në vlerësimin dhe përmirësimin e programit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në	UNYT dhe departamenti përgjegjës për këtë program, informojnë studentët mbi procesin mësimor, afatet dhe detyrimet akademike, si dhe qasjen në shërbime të dedikuara për studentët. Sekretaria mësimore, zyra e karrierës, zyra e

përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	pranimeve dhe zyra e këshillimit luajnë rol të qenësishëm në ofrimin e shërbimeve për studentët, në nivel njësie. Përmes departamentit, studentëve u ofrohet edhe këshillim/mentorim gjatë gjithë periudhës së studimeve. Informacionin e nevojshëm dhe zyrat që realizojnë shërbimet përkatëse janë të publikuara dhe në faqen <i>online</i> të institucionit. Në një kohë që aspektet akademike të informimit dhe shërbimit të studentëve janë të mirërregulluara, janë ngritur gjithashtu edhe shërbimet që kanë të bëjnë me mirëqenien mendore dhe shëndetësore, përfshirë ato për studentë me nevoja të veçanta. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", kapitulli VI;</i> <i>Evidenca 3.7 "Qendra e mbështetjes akademike & Qendra e Këshillimit";</i> https://www.unyt.edu.al/page/student-counseling-center.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ka ngritur një sistem të posaçëm për këshillimin dhe mbështetjen e studentëve që ndjekin programin e studimit, i cili përbëhet nga departamenti dhe stafi akademik, Qendra e këshillimit të studentëve, Zyra e çështjeve studentore, Zyra e karrierës si dhe këshilltari akademik, i cili ka për detyrë të udhëzojë studentët që të regjistrohen në kurse, të zbulojnë interesat dhe talentin e tyre, të ndjekin punën akademike dhe japë udhëzime në të gjitha çështjet arsimore. Studentët e konfirmuan mbështetjen e dhënë gjatë takimit të zhvilluar me ta. Institucioni ka ngritur për këtë qëllim platforma të larmishme komunikimi që mundësojnë shkëmbimin e saktë dhe të shpejtë të informacioneve, përmes faqes zyrtare <i>online</i>, rrjeteve sociale të komunikimit, postës elektronike dhe njoftimeve nga instruktorët. Referencë: <i>Evidenca 1.16 "Manuali i instruktorëve";</i> <i>Evidenca 2.9.1 "Detyrat e këshilltarëve akademikë";</i> <i>Evidenca 5.1 "Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", takimet me studentët, zyrën e karrierës, dekanin e studentëve.</i>


Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Institucioni ka ngritur dhe bërë funksionale zyrën e karrierës, e cila jep mbështetjen e duhur për studentët që të integrohen me sukses në tregun e punës. Kjo zyrë iu siguron studentëve dhe të diplomuarve udhëzime dhe orientime që i ndihmojnë ata për të planifikuar karrierën e tyre të ardhshme në një treg pune në zhvillim e sipër, në përputhje dhe me aftësitë e synimet individuale. Zyra vepron në bazë të një rregulloreje të posaçme për funksionimin e saj si dhe ka hartuar planet vjetore të punës. <i>Sikundër është vërejtur nga grupi i ekspertëve të jashtëm, mungon një udhëzues i posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës si dhe për zhvillimin e karrierës.</i> <i>Gjithashtu, institucioni ka lidhur disa marrëveshje me institucione publike e private, ku ata planifikohet të zhvillojnë praktikën profesionale. Sikundër është gjetur edhe më lart, do të ishte e dobishme, parë edhe numrin e kufizuar të studentëve të programit, që të shtoheshin marrëveshjet për kryerjen e praktikave edhe me institucione të tjerë që kryejnë veprimtari të qenësishme në fushën e drejtësisë.</i> Nëpërmjet strukturave të tij, institucioni siguron gjithashtu këshillimin për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët, e cila është konceptuar si lëndë më vete, e përfshirë në programin e studimit. Referencë: <i>Evidenca 5.11 "Rregullore Zyra e karrierës";</i> <i>Evidenca 5.16 "Plani vjetor zyra e karrierës 23-24";</i> <i>Evidenca 5.22.2 "Raport vjetor aktivitete Zyra e Karrierës 23-24";</i> <i>Evidenca 5.19.2 "Email për mundësi punësimi dhe praktike 2024-2025";</i> <i>Evidenca 5.19 "Postimet për punësim në rrjete sociale";</i> <i>Evidenca 5.15.3 "Panairi i karrierës 2024-2025";</i> <i>https://www.unyt.edu.al/page/career-office-1;</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me përfaqësuesit e zyrës së karrierës.</i>
---	---

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	UNYT, nëpërmjet zyrës së karrierës, ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve dhe ua vë në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Sipas të dhënave që i përkasin këtij programi studimi, nuk ka ende studentë që kanë përfunduar këtë program dhe të jenë të punësuar. Referencë: <i>Evidenca 5.11 "Rregullore Zyra e karrierës";</i> <i>Evidenca 5.17.1 "Komunikime alumni";</i> <i>Evidenca 5.20 "Statistika mbi punësimin e studentëve në nivel institucioni";</i> <i>Evidenca 1.26 "Tabelat përmbledhëse", tabela 23.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni realizon në mënyrën e duhur informimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë gjithë procesit mësimor.</i> <i>Nëpërmjet strukturave akademike dhe ndihmës-akademike, studentët orientohen drejt mbi aspektet që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor si dhe zhvillimin e praktikave profesionale.</i> <i>Zyra e karrierës mban kontakte me studentët, ndjek në vazhdimësi karrierën e studentëve të diplomuar, duke mbledhur të dhënat e nevojshme që kanë të bëjnë me rritjen profesionale të tyre.</i> <i>GVJ sugjeron hartimin e një dokumenti të posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës, në formën e Udhëzuesit për zhvillimin e karrierës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UNYT ka hartuar një sërë dokumentesh nëpërmjet të cilëve vlerëson dhe monitoron cilësinë në nivel institucional. Cilësia dhe metodat e mësimdhënies janë komponentë që i nënshtrohen vlerësimit dhe monitorimit. Hartimi i dokumenteve të tillë në nivel institucional ndihmon në harmonizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si një nga objektivat strategjike të institucionit. Me qëllim realizimin e këtij objekti, një rëndësi e veçantë i është dhënë rritjes së kapaciteteve profesionale të personelit akademik nëpërmjet organizimit të trajnimeve dhe aktiviteteve që synojnë rritjen e cilësisë. Zhvillimi i kapaciteteve të qëndrueshme për pëmirësimin e programit dhe kurrikulave kanë qenë objekt i trajnimeve të zhvilluara edhe me partnerët ndërkombëtarë. Në strategjinë zhvillimore të institucionit pasqyrohet vizioni për qasje moderne dhe një konceptim bashkëkohor të arsimit, kërkimit dhe trajnimit. Referencë: <i>Evidenca 1.12 "Strategjia e Universitetit 2020-2025";</i> <i>Evidenca 1.12.1 "Strategjia e Universitetit 2026-2030";</i> <i>Evidenca 1.47 "Mobilitet stafi";</i> <i>Evidenca 6.18 "Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit".</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit	Institucioni përdor një sërë metodash dhe ka ngritur struktura me qëllim monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së personelit akademik. Rritja e performancës së personelit akademik, të aftë për të gjeneruar dhe shpërndarë njohuri bashkëkohore në fushën e së drejtës, në funksion të rritjes së kapaciteteve njerëzore, duke dhënë kontribut domethënës në këtë lëmë, është një nga prioritetet e institucionit.




akademik dhe
ndihmësakademik.

Për këtë qëllim, janë ngritur dhe funksionojnë një sërë procedurash të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies si raportimi vjetor, nga niveli institucional deri në nivel departamentesh. Ky proces monitorohet dhe vlerësohet edhe përmes instrumenteve të ndryshme siç janë vlerësimi në auditor i stafit akademik nga drejtuesit e njësive (dekani, përgjegjësi i departamentit), vlerësimi nga studentët nëpërmjet pyetësorëve, rezultatet e raporteve të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (e përmendur në vijim me inicialet NJSBC).

Institucioni ka institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe aktet rregullatore të tij. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një nga objektivat strategjikë në nivel institucional. Për këtë qëllim, janë hartuar strategji për sigurimin e cilësisë, plane veprimi si dhe manuale për sigurimin e cilësisë, të cilat parashikojnë objektiva dhe hapa konkrete në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.

Një nga kriteret e vlerësimit të stafit akademik, ku bazohet metodologjia e vlerësimit, është përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Të dhënat analitike të vlerësimeve të anketimit, në mënyrë të përmbledhur i bëhen të njohura gjithë stafit akademik. Në analizën e tij vjetore të punës, stafi akademik nxjerr konkluzione mbi aspekte që i referohen procesit të mësimdhënies gjatë vitit akademik të marrë në analizë si dhe hapat për përmirësim.

Referencë:

Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025";

Evidenca 1.8 "Rregullore Fakulteti";

Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë";

Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësine të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë";

Evidenca 6.1 "Manual i Sigurimit të Cilësisë";

Evidenca 6.2.3 "Raporti Vjetor NJSBC 2023-2024";

Evidenca 1.35 "Raporti Vjetor i UNYT".

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni ka hartuar strategji zhvillimore si dhe ka ngritur mekanizma e procedura të mbikëqyrjes dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së personelit akademik. Një nga format e vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse janë pyetësorët e studentëve. Monitorimi realizohet nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar me studentët si dhe pyetësorëve të zhvilluar me ish-studentët. Nëpërmjet këtyre pyetësorëve vlerësohet si cilësia e programit të studimit, ashtu edhe performanca e pedagogëve. Rezultatet që dalin nga pyetësorët përpunohen dhe shërbejnë për të nxjerrë konkluzione konkrete në lidhje me cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe mekanizmat e ndërhyrjes për përmirësimin e cilësisë. Formularët e vlerësimit të stafit akademik nga studentët ruajnë anonimat dhe studentët kanë mundësi të bëjnë vlerësimin e tyre dhe komente të ndryshme. Po ashtu, studentët kanë mundësi të parashirojnë ankesa për rezultatet e provimeve. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", neni 58;</i> <i>Evidenca 1.7 "Rregullore universiteti", neni 71;</i> <i>Evidenca 6.9 "Formular vlerësimi nga studentët";</i> <i>Evidenca 6.9.1 "Vlerësimet e pedagogëve nga studentët 2021-2023";</i> <i>Evidenca 1.11 "Rregullore programi e rishikuar 2025", neni 42.</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Bazuar në të dhënat e siguruara nga këto vlerësime, strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, ku përfshihen dhe rezultati i punës së personelit akademik dhe ndihmës akademik, harton raportin vjetor me anë të të cilit informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UNYT rreth rezultateve të monitorimeve, në mënyrë që të merren masat e nevojshme për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit. Të dhënat e marra gjatë procesit, raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe raporti i komisionit të vlerësimit dhe zhvillimit të cilësisë në arsimin e lartë, publikohen në faqen zyrtare të institucionit.




	Referencë: <i>Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë";</i> https://www.unyt.edu.al/page/quality-assurance .			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Mekanizmat e vlerësimit përdoren për të nxjerrë konkluzione, ndër të cilat nëpërmjet shembujve pozitivë, stafi akademik nxitet për rritjen e vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies. Raste që gjykohen si pozitive përgjatë procesit të mësimdhënies evidentohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bëhen të njohura për anëtarët e tjerë. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe masat e marra për garantimin e cilësisë dhe promovimin e praktikave më të mira me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të personelit akademik në përputhje me standardet ndërkombëtare, edhe pse gjatë vizitës në institucion nuk u vu në dukje ndonjë shembull konkret i tillë. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", nenet 9-10;</i> <i>Evidenca 6.18 "Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit";</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", takim me përfaësuesit e NJSBC.</i>			
Konkluzione	<i>UNYT vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore të institucionit si dhe publikon rezultatet e vlerësimit të kryer.</i> <i>Institucioni përdor mekanizma dhe procedura të mbikëqyrjes dhe vlerësimit periodik të cilësisë të mësimdhënies dhe performancës së personelit akademik.</i> <i>Për monitorimin e brendshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve, institucioni përdor metodologji vlerësimi si dhe instrumente matëse dhe vlerësuese, ndër të cilat dhe anketimet e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UNYT, si institucion i arsimit të lartë, është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ky universitet ka institucionalizuar sistemin e brendshëm të cilësisë në përputhje me kriteret e standardeve shtetërore të cilësisë të përcaktuar në nenet 103 e vijues të ligjit nr. 80/2015. Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet strukturave hierarkike organizative të brendshme të UNYT, në nivel institucioni dhe njësie kryesore, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për përmbushjen e tij. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një nga objektivat strategjikë në nivel institucional. Në funksion të këtij objektiivi janë hartuar strategji për sigurimin e cilësisë, plane veprimi si dhe manuale të cilësisë, të cilat parashikojnë hapat konkretë për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ka hartuar RVB në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë. Institucioni ka ngritur NJSBC e vet, e cila në kuadër të misionit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe asaj kërkimore-shkencore planifikon veprimtarinë e saj si dhe harton plane veprimi për realizimin e aktiviteteve. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", nenet 36, 58;</i> <i>Evidenca 1.7 "Rregullore universiteti", nenet 29-30;</i> <i>Evidenca 1.12.1 "Strategjia e Universitetit 2026-2030", qëllimi I;</i> <i>Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përherëshëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë";</i>

	<i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.1 "Manual i Sigurimit të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.18 "Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit;</i> <i>Evidenca 6.16.1 "Plan vjetor NjSBC 2023-2024".</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për sigurimin e cilësisë duke mundësuar një sistem funksional të sigurimit të cilësisë. Në përputhje me rregullimet institucionale, janë ngritur dhe funksionojnë mekanizmat e vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, ku njëri prej anëtarëve është student si dhe NJSBC, si struktura kryesore e sigurimit të cilësisë, e cila mbikëqyr standardet e brendshme të cilësisë, propozon ndryshime në drejtim të rritjes së cilësisë si dhe vlerëson efektivitetin e veprimtarive mësimore-kërkimore të institucionit; gjithashtu mundëson mbledhjen e rezultateve nga instrumentet e vlerësimit të cilësisë. Institucioni ka hartuar dhe zbaton një strategji zhvillimi ku pasqyrohet vizioni mbi një qasje moderne dhe një konceptim bashkëkohor të arsimimit, kërkimit, trajnimit dhe kualifikimit në fushën e arsimit të lartë. Me qëllim konkretizimin dhe zbatimin praktik të detyrimeve ligjore në fushën e cilësisë, është hartuar rregullorja për funksionimin e NJSBC-së, si dokumenti themelor ku përcaktohen parimet e sigurimit të brendshëm të cilësisë, struktura, organizimi, funksionet dhe marrëdhëniet reciproke të subjekteve gjatë procesit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, procedurat e vlerësimit të brendshëm të veprimtarisë akademike/mësimore, kërkimit shkencor, si dhe dokumentacioni për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në UNYT. Kjo rregullore synon garantimin dhe rritjen e cilësisë së procesit akademik e atij kërkimor në nivel institucional. Nga ana tjetër, Manuali i Cilësisë gjithashtu përcakton objektivat e sigurimit të cilësisë, politikat për sigurimin e cilësisë si dhe proceset e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë. Pjesë e rëndësishme e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë janë edhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve. Është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë

	të jashtëm; respektivisht në përbërje të NJSBC-së është parashikuar një ekspert i jashtëm me profil akademik. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", nenet 36, 58;</i> <i>Evidenca 1.12.1 "Strategjia e Universitetit 2026-2030", qëllimi 1;</i> <i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë", neni 4;</i> <i>Evidenca 6.1 "Manual i Sigurimit të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.18 "Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit;</i> <i>Evidenca 6.5 "Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtëm".</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Nga takimi me përfaqësuesit e NJSBC si dhe nga evidencat e vëna në dispozicion, institucioni përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. UNYT, sikundër gjen parashikim në statut dhe rregulloren për NJSBC, e realizon sigurimin e cilësisë nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Në këtë dokument, institucioni ka qartësuar parime dhe standarde konkrete në shërbim të krijimit të një sistemi efikas për sigurimin e cilësisë. Të dhënat që merr institucioni nga studentët lidhen me aspekte të mësimdhënies, të programeve dhe të lëndëve mësimore, ndërsa vlerësimi që kryhet nga stafi akademik lidhet me aspekte të programeve, lëndëve dhe mësimdhënies. Në mënyrë periodike, institucioni realizon vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë, standardet evropiane dhe ndërkombëtare, përfshi dhe akreditimin nga subjekte të huaj, rekomandimet e të cilëve kujdeset që t'i plotësojë. Gjithashtu, institucioni zhvillon apo merr pjesë në veprimtari që lidhen me aftësimin e stafit për procesin e sigurimit të cilësisë. Ky program studimi i nënshtrohet akreditimit të tij për herë të parë. Referencë

	<i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", nenet 36, 58 dhe 77; Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë", nenet 7 e 13;</i> <i>Evidenca 6.1 "Manual i Sigurimit të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.11 "YÖKAK Visit Agjenda";</i> <i>Evidenca 6.19 "Akreditimi ACCA";</i> <i>Evidenca 6.17 "Trajnim NJSBC";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me përfaqësuesit e NJSBC.</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Cilësia e mësimdhënies dhe e programeve të studimit është një nga komponentët që i referohet Sistemit të Brendshëm të Cilësisë. Një nga detyrat e NJSBC është garantimi i cilësisë së brendshme të programeve që ofrohen prej UNYT, në përputhje me standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Kjo njësi bën vlerësimin në vazhdimësi të programeve, përfshi edhe këtë program që po vlerësohet, që ofrohen nga universiteti nëse janë në përputhje me standardet e cilësisë, si dhe koherencën e tyre. Njëkohësisht departamenti si njësi bazë përgjegjëse, zbaton instrumente për realizimin e cilësisë së procesit mësimdhënës dhe programit të studimit. Raportet periodike të vlerësimeve të kryera nga njësitë për matjen e cilësisë së veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore, përdoren për ndryshime dhe përmirësime të cilësisë dhe si bazë për hartimin e kërkesave për akreditimin. Stafi akademik njihet dhe përditësohet mbi sistemin e cilësisë si dhe merret mendimi i tij në këtë drejtim. Raportet përfundimtare reflektojnë edhe rezultatet që vijnë nga <i>feedback-u</i> i strukturave përkatëse. Referencë: <i>Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.18 "Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit;</i> <i>Evidenca 6.2.3 "Raporti vjetor NJSBC 2023-2024";</i> <i>Evidenca 6.21 "Raport mbi drejtësinë e vlerësimit, transparencën, krahasueshmërinë dhe auditueshmërinë".</i>

Konkluzione	UNYT ka ngritur mekanizma për sigurimin e cilësisë si dhe zbaton metodologji për të siguruar në mënyrë efektive funksionimin e sistemit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Institucioni i pasqyron politikat e tij të sigurimit të cilësisë në dokumente strategjike si dhe i konkretizon në plane veprimi që kanë një sërë parashkimesh mbi monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë. Vlerësimi i programit të studimit bëhet në kuadrin e strukturave institucionale të vlerësimit të cilësisë. Në nivel institucional, organet drejtuese të institucionit, në kuadrin e kompetencave të tyre, garantojnë zbatimin e politikave dhe strategjive që i referohen sigurimit të brendshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.	UNYT vë në përdorim një sërë mekanizmash për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të integruar të studimit Master Shkencor në "Drejtësi". Rregulloret dhe akte të tjera të posaçme të institucionit kanë parashikuar procedurat për miratimin, rishikimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve si dhe kompetencat e strukturave përgjegjëse në këtë drejtim. Departamenti, si njësia përgjegjëse për zbatimin e programit, inicion ndryshimet dhe përmirësimet e kurrikulës, me qëllim përshtatjen me risitë e reja shkencore. Më tej, vendimmarrja u përket strukturave të tjera akademike deri në miratimin përfundimtar nga senati. Mbikëqyrja e programit të studimit është pjesë e proceseve të vlerësimit periodik në kuadrin e vlerësimit në tërësi të cilësisë. Institucioni ka përdorur si metodologji vlerësimi anketimet që japin rezultate në lidhje me vlerësimin e studentëve mbi programin e studimeve, pyetësorët

Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	e studentëve si dhe vetëvlerësimet e stafit akademik. Rezultatet e anketimeve të studentëve për secilin nga syllabuset përkatës janë pjesë e vlerësimit periodik të programit. Në nivel institucional, Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit, si dhe për organizimin dhe vlerësimin e projekt-programeve të studimit të ciklit të dytë, në nivel njësie bazë, të paraqitura sipas parashikimeve të statutit. Nga vizita në institucion dhe nga studimi i dokumentacionit, rezulton se institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi bazuar në metodën SWOT (RVB) si dhe instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre, duke kombinuar metodat e tërthorta me ato të drejtpërdrejta. NJSBC harton raportin vjetor të të dhënave të mbledhura nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit, i cili bëhet i aksesueshëm për stafin e universitetit dhe studentët në sistemin e brendshëm të universitetit, por dhe publikisht në faqen elektronike zyrtare të tij. Referencë: <i>Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë", nenet 9-12;</i> <i>Evidenca 6.18 "Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit;</i> <i>Evidenca 6.2.3 "Raporti vjetor NJSBC 2023-2024";</i> <i>Evidenca 6.16.1 "Plan vjetor NJSBC 2023-2024";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takim me përfaqësuesit e NJSBC.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra	Sistemi i vlerësimit të programit të studimit shtrihet nga departamenti si njësi përgjegjëse për zbatimin e tij, deri tek strukturat më të larta akademike. Departamenti, në raportet vjetore, pasqyron gjetjet në lidhje me rezultat e vlerësimit të programit të studimit, mangësitë, si dhe adreson rekomandimet për përmirësimin e cilësisë. Në nivel departamenti, bëhet një përshkrim i rezultateve të vlerësimeve, por nuk është hartuar një

për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	plan veprimi për masat e marra për adresimin e mangësive për vitin pasardhës akademik. Nga ana tjetër, NJSBC harton raportin vjetor të vlerësimit, që përmban të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultatet e vënë në dukje. Raporti përmbledh të dhëna të marra nga burime të ndryshme dhe përqendrohet në përvojën e studentëve si dhe mënyrën e adresimit të çështjeve gjatë vitit akademik. Përfundimet e evidentuar në raportin vjetor institucional vlejné për procesin e vendimmarrjes lidhur me miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit. Referencë: <i>Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.18 "Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit;</i> <i>Evidenca 1.30.1 "Raporti vjetor i monitorimit 2022- 2023";</i> <i>Evidenca 1.35 "Raporti Vjetor i UNYT";</i> <i>Evidenca 6.1 "Manuali i sigurimit të cilësisë", seksioni IV.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e	Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për sigurimin e cilësisë si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, syllabuseve, rezultatet e të nxënit, testet, vlerësimi i didaktikës nga kolegët. Metoda të tjera për promovimin e mësimdhënies janë seminarët akademike, procesi i rishikimit të syllabuseve. Sipas <i>RVB, f. 98</i>, UNYT merr vlerësimet e studentëve për personelin e angazhuar në programin e studimit dy herë në vit, një herë në semestër, ndërsa për personelin e angazhuar për herë të parë në këtë universitet, vlerësimi realizohet dy herë në semestër. I gjithë informacioni i mbledhur përpunohet dhe analizohet në nivel njësie bazë dhe institucional. Referencë: <i>Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë", neni 11;</i>

arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<i>Evidenca 6.1 "Manuali i sigurimit të cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.9.1 "Vlerësimet e pedagogëve nga studentët 2021-2023";</i> <i>Evidenca 6.9.2 "Vlerësimet e pedagogëve nga studentët 2024-2025";</i> <i>Evidenca 6.9 "Formular vlerësimi nga studentët";</i> <i>Evidenca 6.4 "Formular vlerësimi nga kolegët";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me përfaqësuesit e NJSBC.</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Programet mësimore në UNYT i nënshtrohen procesit të vlerësimit periodik, mbikëqyrjes dhe përditësimit nëpërmjet përdorimit të procedurave dhe instrumenteve të tërthorta. Në kuadrin e metodave të tërthorta të përdorura në procesin e vlerësimit të programit të studimit, UNYT ka përdorur si metodologji vlerësimi procesin e vlerësimit të studentëve, marrjen e mendimit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe për institucionin, marrjen e mendimit nga personeli akademik, ndihmësakademik dhe administrativ si dhe strukturat përgjegjëse. UNYT mban kontakte të ngushta me studentët e diplomuar edhe pas përfundimit të studimeve, por në këtë program nuk ka të tillë, ndaj nuk mund të paraqiten të dhëna për këtë grup. Referencë: <i>Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë", neni 11;</i> <i>Evidenca 6.9 "Formular vlerësimi nga studentët";</i> <i>Evidenca 1.32 "Shembull vlerësimi nga kolegët".</i>
Konkluzione	<i>UNYT ka hartuar dhe zbaton strategji që kanë si pjesë të objektivave edhe vlerësimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</i> <i>Në zbatim të objektivave strategjike, janë përdorur një sërë instrumentesh e metodologjish vlerësimi të mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit.</i>

	<i>Për kryerjen e vlerësimit institucioni përdor si metodat e drejtpërdrejta, ashtu edhe metodat e tërthorta, që japin rezultate në lidhje me vlerësimin e programit të studimit.</i> <i>Rezultatet e vlerësimit janë pjesë e raporteve të brendshme të vlerësimit dhe ndikojnë në ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe studentëve që ndjekin programin e studimit mbi rëndësinë e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UNYT në aktet dhe procedurat e cilësisë, ka parashikuar subjektet që përfshihen në procesin e sigurimit të cilësisë si njësitë bazë, stafin akademik dhe studentët, të cilët japin kontributin gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve. Gjithashtu, në aktet dhe procedurat e cilësisë është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, sipas përcaktimeve statutores dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", nenet 36, 58;</i> <i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë", neni 4;</i> <i>Evidenca 6.1 "Manual i Sigurimit të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.5 "Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtëm".</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në	Në aktet e brendshme rregullatore të UNYT përcaktohen kompetencat si dhe roli i secilës nga strukturat e angazhuara në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këto akte janë

sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	përcaktuar edhe përgjegjësitë e këtyre strukturave në ushtrimin e kompetencave dhe zbatimin e detyrave të tyre. Në aktet rregullatore është parashikuar ngritja e NJSBC si strukturë e brendshme e cilësisë në nivel institucional, e cila realizon procesin e vlerësimit periodik të cilësisë. Kjo strukturë bashkëpunon me njësi të tjera në nivelin e njësive kryesore dhe njësisë bazë me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në nivel departamenti të këtij programi studimi, nuk ka përcaktime në rregulloren e programit, por në rregulloren e fakultetit dhe atë të departamentit janë bërë parashikimet përkatëse që lidhen me procesin e sigurimit të cilësisë. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", nenet 36, 58;</i> <i>Evidenca 1.7 "Rregullore universiteti", nenet 29-30;</i> <i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë", nenet 11-12;</i> <i>Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë", nenet 5, 8 dhe 10;</i> <i>Evidenca 6.1 "Manual i Sigurimit të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 1.8 "Rregullore fakulteti", neni 4;</i> <i>Evidenca 1.9 "Rregullore departamenti", neni 5.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Departamenti si njësi bazë dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si njësi kryesore, ushtrojnë kompetencat e tyre në procesin e sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë të programit të studimit. Departamenti harton dhe përditëson syllabuset e lëndëve duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Përmirësimi i syllabuseve realizohet nga stafi akademik, si në lidhje me literaturën, ashtu dhe me temat e programit mësimor me qëllim përditësimin me risitë shkencore. Aktet rregullatore të institucionit përcaktojnë qartë rolin e departamentit që ofron këtë program studimi, si dhe atë të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, por edhe të studentëve në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit. Në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin

	e Standardeve të Cilësisë, një anëtar është përfaqësues i studentëve. Në përbërje të NJSBC janë dy anëtarë nga stafi administrativ. Vlerësimi i programit të studimit përfshin departamentin, Fakultetin dhe strukturat më të larta akademike. Raportet vjetore pasqyrojnë problematikat mbi rezultatet e vlerësimit të programit si dhe masat për përmirësimin e cilësisë. Referencë: <i>Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë", nenet 4 dhe 8;</i> <i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë", nenet 4, 7 dhe 9;</i> <i>Evidenca 6.4 "Formular vlerësimi nga kolegët";</i> <i>Evidenca 6.9 "Formular vlerësimi nga studentët";</i> <i>Evidenca 6.10 "Formular vlerësimi i performancës individuale";</i> https://www.unyt.edu.al/page/permanent-commissions.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit të programit të studimit respekton parimin e barazisë dhe integritetit akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, studentëve apo subjekteve të tjerë të përfshirë në këtë proces. Në përzgjedhjen e anëtarëve të strukturave përgjegjëse për procesin e monitorimit e të vlerësimit të cilësisë merren në konsideratë kriteret që lidhen me kompetencat profesionale dhe parimi i paanshmërisë, duke shmangur çdo konflikt interesi që mund të ndikojë në proces. Njëkohësisht, parimi i kolegjalitetit në vendimmarrje shman anshmërinë dhe garanton të drejtën e secilit anëtar për shprehjen e lirë të vullnetit. Ky konstatim u përforcua gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët. Referencë: <i>Evidenca 1.2.1 "Statuti dhe organigrama 2025", neni 10/2;</i> <i>Evidenca shtesë "Shënime New York", takimet me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe	Sipas rregullores për NJSBC-në, një nga anëtarët e saj është ekspert i jashtëm, i caktuar me vendim të rektorit. Vlerësimi i

sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	brendshëm bazohet ndër të tjera, dhe në vlerësimet e ekspertëve, që, sipas të dhënave institucionale kanë kontribuar edhe në fazën e hartimit apo rishikimit të programeve të studimit në raport me kërkesat e tregut të punës. Në këtë kuadër, <i>GVJ sugjeron që, për hartimin e raportit të vlerësimit, të angazhohet dhe një përfaqësues i jashtëm.</i> Referencë: <i>Evidenca 6.7 “Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”, neni 4;</i> <i>Evidenca 6.5 “Vendim Rektorati nr. 99 Ekspert i Jashtëm”;</i> <i>Evidenca 6.2.3 “Raporti vjetor NJSBC 2023-2024”.</i>			
Konkluzione	<i>Zbatimi i politikave dhe procedurave të vlerësimit të cilësisë në UNYT mundëson përfshirjen e një sërë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm si dhe aksesimin e kontributeve të tyre në vlerësimin e cilësisë.</i> <i>Aktet e brendshme rregullatore të UNYT përcaktojnë kompetenca dhe përgjegjësi konkrete për të gjitha palët e angazhuara në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të këtyre kompetencave.</i> <i>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit të programit të studimit respekton parimin e barazisë dhe integritetit akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie.</i> <i>GVJ sugjeron angazhimin e një përfaqësuesi të jashtëm gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaritë e monitorimit që realizohen në kuadrin e procesit të vlerësimit të cilësisë respektojnë procedurat si dhe parimet e parashikuara në strategjitë zhvillimore, manualin e cilësisë dhe aktet e tjera rregullatore. Bazuar në parimin e transparencës, ato u bëhen të njohura strukturave drejtuese nëpërmjet sistemit të brendshëm të komunikimit. Departamenti reflekton konkluzionet e raporteve të vlerësimit si dhe merr masa për përmirësim në kuadrin e përgjegjësisë së tij. Studentët informohen nga pedagogët në lidhje me aspekte të mbarëvajtjes së programit të studimit. Nga takimi me studentët rezultoi se ata ishin të informuar për ekzistencën e strukturave të brendshme të sigurimit të cilësisë. Referencë: <i>Evidenca 1.12.1 "Strategjia e Universitetit 2026-2030", objektivi 1;</i> <i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë", neni 5/2;</i> <i>Evidenca 6.1 "Manual i Sigurimit të Cilësisë";</i> <i>Evidenca shitesë "Shënime New York", takimi me studentët.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni realizon procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit iu komunikohen strukturave përkatëse nëpërmjet procedurave që respektojnë parimet e etikës akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale. Për këtë qëllim, në nivel institucional është ngritur dhe funksionon NJSBC, si strukturë që mundëson mbledhjen e rezultateve të vlerësimit të programit mësimor. Pjesë e këtyre instrumenteve janë edhe pyetësorët e studentëve si dhe vlerësimet për personelin akademik. Shpërndarja e pyetësorëve bëhet fizikisht ose <i>online</i>. Rezultatet e këtyre të fundit bëhen të njohura duke respektuar etikën akademike dhe ruajtjen e të dhënave personale. Referencë:




	<i>Evidenca 6.1 "Manual i Sigurimit të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.9.2 "Vlerësimet e pedagogëve nga studentët 2024-2025";</i> https://www.unyt.edu.al/page/quality-assurance.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Të dhënat mbi rezultatet e vlerësimit, pas komunikimit dhe bërjes publike, u nështrohen procesit të diskutimeve dhe reflektimeve nga aktorët e brendshëm në nivel institucional. Në raportet e vlerësimit të brendshëm pasqyrohen edhe mangësitë e problematikat që evidentohen nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë. Problematikat iu bëhen të njohura pedagogëve dhe strukturave të tjera, me qëllim reflektimin për përmirësimin e mangësive të evidentuara. Të gjitha strukturat, pasi njihen me rezultatet e vlerësimit, duhet të marrin masa që synojnë ndërhyrje konkrete për riparimin e mangësive të konstatuara. Këto masa pasqyrohen edhe në planet e veprimit, të cilat hartohen në mënyrë periodike në varësi të nevojave për ndërhyrje dhe përmirësim. Referencë: <i>Evidenca 6.18 "Strategjia e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit";</i> <i>Evidenca 6.7 "Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.3 "Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë";</i> <i>Evidenca 6.1 "Manual i Sigurimit të Cilësisë".</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në përputhje me rregullimet e bëra në aktet e brendshme rregullatore, institucioni mundëson efektivitetin e veprimtarive në kuadër të vlerësimit dhe përmirësimin të cilësisë së programit të integruar të studimit Master i Shkencave në "Drejtësi". Me qëllim vlerësimin e ndikimit të veprimtarive të realizuara në kuadrin e cilësisë, UNYT përfshin në këtë proces një numër të gjerë të strukturave të tij në nivel institucional, si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, NJSBC, etj. Një sërë strukturash të tjera si departamentet, drejtuesi i departamentit, dekani, Senati, etj., japin gjithashtu kontributin e tyre në

	vlerësimin e efektivitetit të veprimtarive të realizuara në kuadër të vlerësimit të cilësisë. Referencë: <i>Evidenca 6.3 “Rregullore për Komisionin e Përhershëm të Sigurimit dhe Standardeve të Cilësisë”;</i> <i>Evidenca 6.7 “Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”;</i> <i>Evidenca 6.1 “Manual i Sigurimit të Cilësisë”;</i> <i>Evidenca 6.21 “Raport mbi drejtësinë e vlerësimit, transparencën, krahasueshmërinë dhe auditueshmërinë”.</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni synon informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe të studentëve për rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Për të përmbushur këtë synim, institucioni ka organizuar veprimtari periodike me personelin dhe me studentët, të natyrave të ndryshme, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për procesin e vlerësimit dhe akreditimit të programeve të studimit. Veprimtaritë e organizuara janë të shfaqura edhe në faqen zyrtare të universitetit nën zërin “<i>Training and events</i>”. Referencë: <i>Evidenca 6.7 “Rregullore për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”, neni 11;</i> <i>Evidenca 6.17 “Trajnim NJSBC”;</i> <i>Evidenca 6.15.1 “Sondazhi Kombëtar i Studentëve 2025”;</i> https://www.unyt.edu.al/page/quality-assurance.
Konkluzione	<i>Veprimtaritë e realizuara në kuadrin e procesit të vlerësimit të cilësisë bëhen të njohura për të gjithë subjektet e interesuar nëpërmjet sistemit të brendshëm të komunikimit, bazuar në parimin e transparencës.</i> <i>Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit realizohet nëpërmjet procedurave që respektojnë parimet e etikës akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i> <i>Me qëllim vlerësimin e ndikimit të veprimtarive të realizuara në kuadrin e cilësisë, UNYT përfshin në këtë proces një numër të gjerë të strukturave të tij në nivel institucional.</i>

	<i>Institucioni zbaton procedura që mundësojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe të studentëve për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të Programit të integruar të studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në: “Drejtësi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:


1. Programi kombinon teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën duke mundësuar përvetësimin e dijeve bashkëkohore, nxitjen e mendimit krijues dhe kritik te studentët, në përputhje me qëllimin e programit;
2. Institucioni ofron gjerësisht mbështetje financiare për studentët;
3. Institucioni mundëson përmbushjen e objektivave të programit objekt vlerësimi përmes angazhimit optimal të burimeve njerëzore, personelit akademik edhe atij ndihmës akademik dhe administrativ, si në drejtim të procesit akademik, aftësimit praktik të studentëve, por edhe të krijimit të kushteve optimale gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit të studimit;
4. Institucioni zotëron infrastrukturë bashkëkohore, me mjedise mësimore të përshtatshme dhe logjistikë të mirëpajisur për ushtrimin e veprimtarive praktike, garanton mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe përgatitjen praktike të studentëve në përputhje me standardet e cilësisë;
5. Në strukturën institucionale vepron një mekanizëm i brendshëm funksional i vlerësimit të cilësisë, i cili bazohet në strategji konkrete, mekanizma të qëndrueshëm dhe instrumente matëse për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit;

b. Pika të dobëta:

1. Jo të gjithë titullarët e lëndëve janë të kategorisë “*Profesor*”, sic parashikon edhe pika 3 e nenit 59 të ligjit nr. 80/2015; (*Standardi III.1 kriteri 4*)
2. Ka mungesë të literaturës së përditësuar të titujve fizikë në bibliotekë, që i vlejnë programit të studimit (*Standardi II. 4 kriteri 5*).
3. Konstatohet se, në këtë program studimi, angazhohet staf akademik që nuk e ka të paktën grandën shkencore “Doktor i shkencave”, duke mos plotësuar kushtin ligjor për të patur së paku kualifikimin e ciklit pasardhës; (*Standardi IV.1 kriteri 1*)
4. Marrëveshjet e bashkëpunimit janë të kufizuara, çka ndikon në moskryerjen e praktikave profesionale në institucione që realizojnë veprimtari të rëndësishme në sistemin e drejtësisë, rrjedhimisht edhe në përmbushjen e objektivave mësimorë të programit objekt vlerësimi; (*Standardi IV.2 kriteri 5*)

Rekomandime

1. Institucioni të marri masa për të mundësuar si titullarë lëndësh në këtë program studimi, personel akademik të kategorisë “*Profesor*”, në zbatim të pikës 3 neni 59, të ligjit Nr. 80/2015;
2. Të rishikohet plani mësimor, me qëllim që lëndë të tilla si, Procedurë Civile apo Procedurë Penale të trajtohen si lëndë të pandara në pjesë;
3. UNYT dhe njësia bazë duhet të hartojnë një plan veprimi (me buxhetin përkatës) për pasurimin dhe përditësimin e burimeve akademike të disponueshëm për studentët në bibliotekën fizike, me qëllim që të reflektohet debati akademik bashkëkohor. Në këtë kontekst, të pasurohet literatura për sa është e mundur, me artikuj shencorë të botuara në revista shkencore juridike me ISBN;
4. Institucioni duhet të marrë masat e duhura në mënyrë që të plotësojë kriterin ligjor për të pasur numrin e nevojshëm të personelit akademik efektiv të paktën me gradë shkencore, gjë e cila mundëson harmonizimin e ngarkesës në mësimdhënie me atë të kërkimit shkencor;
5. Institucioni duhet të lidhë marrëveshje me institucione dhe organe të specializuara të sistemit të drejtësisë, në përputhje me objektivat e programit të integruar të studimeve në drejtësi;
6. Institucioni duhet të sigurojë që të dhënat dhe informacionet, të cilat kanë të bëjnë me programin e studimit, strukturën akademike, përmbajtjen e lëndëve, metodat e mësimdhënies dhe kriteret e vlerësimit, personelin akademik, shërbimet për studentët si dhe aktivitetet e ndryshme të publikohen në faqen zyrtare online të UNYT edhe në gjuhën shqipe;



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Integrated Second Level Program "Law"

a. Strengths and affirmations:

1. The program combines theory, scientific research, and practice, enabling the acquisition of contemporary knowledge, promoting creative and critical thinking among students following the program's objective;
2. The institution broadly provides financial support to students;
3. The institution facilitates the achievement of the goals of the evaluated program by effectively utilizing human resources, as well as academic and administrative support staff. This engagement is crucial not only for the academic process and practical training of students but also for establishing favorable conditions throughout the entire duration of the study program;
4. The institution features contemporary infrastructure, providing suitable learning environments and well-equipped logistics for practical activities, ensuring the seamless operation of the educational process and the effective preparation of students in line with quality standards;
5. The institutional structure includes a mechanism for internal functional quality assessment, which is grounded in defined strategies, sustainable methods, and measurement tools for evaluating and ensuring the quality of the study program;

b. Weaknesses:

1. Not all course holders hold the academic title of "Professor," as required by Article 59, paragraph 3, of Law No. 80/2015; (*Standards III.1 criterion 4*)
2. There is a lack of up-to-date physical literature in the library that is relevant to the study program; (*Standard II. 4 criterion 5*)
3. It has been observed that this study program employs academic staff who do not hold at least a doctoral degree, thereby failing to meet the legal requirement that staff possess a qualification from the next academic degree; (*Standard IV.1 criterion 5*).
4. The limitations of cooperation agreements affect the completion of professional internships in key institutions within the justice system, ultimately failing to meet the learning objectives of the program under review; (*Standard IV.2 criterion 5*).

Recommendations



1. The institution should take measures to appoint academic staff with the title of “Professor” as course holders in this study program, in accordance with Article 59, paragraph 3, of Law No. 80/2015.
2. The curriculum should be reviewed so that courses such as *Civil Procedure* and *Criminal Procedure* are treated as unified courses rather than divided into parts.
3. UNYT and its base unit should prepare an action plan (with an appropriate budget) to enrich and update the academic resources available to students in the physical library, to reflect contemporary academic debates. In this context, the literature should be supplemented, where possible, with scientific articles published in legal academic journals with an ISBN.
4. The institution needs to undertake the required steps to satisfy the legal criterion of having a sufficient number of competent academic staff with at least a scientific degree, which allows for the coordination of teaching loads alongside scientific research efforts.
5. The institution must establish partnerships with specialized agencies and sectors of the justice system, in accordance with the objectives set forth by the integrated law studies program.
6. The institution must guarantee that all data and information about the study program, academic structure, course content, teaching methods, assessment criteria, academic staff, student services, and various activities are published on UNYT's official online website, including in the Albanian language.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X